

HOMER
ILIADA

BOTIMET TOENA

HOMER ILIADA ΙΛΙΑΣ



Skenë beteje grekë-trojanë, Basoreliev i lashtë.

Përktheu nga greqishtja dhe përgatiti
LLAMBRO RUCI

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2019

Përkthimi mjeshtëror dhe përgatitja për shtyp e Iliadës, pajisja me shënimet sqaruese për emrat e ngjarjet, kopertinat dhe ilustrimet u kryen nga Llambro Ruci, por nuk arriti ta shohë të botuar pasi u nda nga jeta në korrik 2018.

Për të nderuar kujtimin dhe veprën e tij familja mundësoi financiarisht dhe u kujdes për ecurinë e botimit të Iliadës.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-271-45-7

© i përkthimit 2019 Llambro Ruci

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

HOMERI DHE HIMARA
 HYRJE NË BOTËN DHE RRUGËTIMET HOMERIKE
 Në vend të parathënies...

Kur isha fëmijë shkolle në Dhërmi të Himarës dhe belbëzoja vargje, kur bëja bé me betimet pagane himarjote për diellin, zjarrin, vatrën mes shtëpisë, kur strukësia i ngjethur nga rrufetë dhe bubullimat e pafundme dimrit përballë në Akrokeraunet shtrëngatore (“*Shkëmbinjtë akrokeraunas/ shpesh të famshëm për shkatërrimin e anijevë*”, si thoshte Horaci), ku Zeusi “ndëshkonte” mosmikpritësit dhe besëshkelësit, nuk mund të dija se, sipas legjendës, në këto brigje kishte shkëlur në lashtësi Odisea i famshëm i **Omirit** (Homerit), stërgjyshit të poezisë europiane.

Më vonë, kur lexova dhe kuptova botën homerike, te mjegulla e përhershme në qafën dhe kthesat e Llogarasë, si tis i mbetur i shpërthimeve të dikurshme vullkanike, që ngjallet dhe përhumbet shpejt shkrepave të Çikës, gjeja nyjën që lidhte këto brigje të rrufeve me përfytyrimin poetik të Homerit tek “Odisea” (XI, 14-9) për kimerët (Κιμμέριοι, *it.* Cimmerii) dhe peizazhin e tyre:

“Atje ishte vendi dhe qyteti i kimerëve,
 që i mbulonin re dhe një errësi e trashë.
 Kurrë me rrezet e tij nuk i ka parë dielli,
 as kur në qiellin me dritë yjesh lind,
 as kur prapa drejt tokës kthehet nga qiejt,
 veç vdekatarët e mjerë i mbulon një natë kobzezë”.

Pikërisht këtu në vendin e himarjotëve, shkruan Spiro Rusha, përgjatë bregdetit jomikpritës keraunian, Pukëvilit i doli “... përballë Himara (Chimara), që i përkiste Chimera antike, emër i cili tashmë mbahej nga distrikti i himarjotëve të tmerrshëm... Akrokeraunet, ose më saktë malet Keraune janë emërtuar kështu që në lashtësi, nga termi grek *keraunos*, që do të thotë bubullimë, për arsye të lartësisë dhe veçanërisht për shkak të ekspozimit të tyre ndaj detit, të ndriçuar

shpesh me dritën e vetëtimave. ... Keraune (Ceraunia) është vendi i cili, sipas disa studiuesve, përmendet nga Circea në udhëzimet e saj drejtuar Uliksit... Nëse Homeri do të kishte zgjedhur malet e Himarës për skenën e veprimeve infernale, që zhvilloheshin mes mjegullës së dëmshme, me të cilën ato mbuloheshin asaj dite, gjërat duhet të kishin marrë rrjedhë krejt tjetër gjatë periudhës tri mijëvjeçare...”. Përballë “Fanos, *Othonos* i antikitetit, që mendohet të jetë rezidenca e Kalipsos, i njohur në Odisenë e Homerit dhe Telemakut të Fenelonit”...

Ja dhe përfytyrimi i Homerit për Himarën-Kimerë (*Iliada*, VI, v. 179-182):

... Kimerë e frikshme...

pyjellë njerëzore nuk ishte ajo, por soj hyjnor,

dragua nga prapa, luan përpara, në mes dhi.

Ishin të brendshmet zjarr dhe flakë fryma e saj.

Gavril Dara i Riu tek e famshmja “Kënga e sprapsme e Balës” e përshkruan mrekullisht stihinë-Himarë antiturke:

Kështu me vehte mendoja, 55

Kur një krismë me përmendi...

- Do jetë era në ato të dushqe

A lugati endacak?

Por këtu s’qaset... as ujku,

Që i nginjur diku struket, 60

As dhe drieri frikacak,

Që këcen i shqetësuar...

Këtu n’terrët mos jan’ futur

Pararojet e armiqvet,

Që ditën gjithnjë kan’ frikë? 65

Jo, jo kurr’, për ushtën time

N’terrët Arbri s’do të bjerë,

Se dhe copëtuar e shtypur

Me drit’ botën do e mbulojë!

Ashtu si kulshedrat natën¹ 70

¹ v. 70-82. Kupto: Përbindëshi (stihia) i Himarës (sipas autorit, një mal vullkanik në Shqipërinë Jugore) u qëndron i vendosur kulshedravet, që i vërviten duke i hedhur përsipër shi e breshër e gjëmë. Qëndrimi i vendosur i stihisë së Himarës kundër kulshedrave këtu krahasohet me qëndrimin e vendosur të Shqipërisë kundër armiqve turq. v. 77. I vjen metë = i vjen mangët, i pakësohet.

Kthyer stihis' së Himarës,
 I vërtiten duke i shtënë
 Shi me breshër e me gjëmë;
 E ajo ngrihet e i qëllon
 Me shkretimë e bubullimë; 75
 E kur k'putur e plagosur
 I vjen met' fryma e fuqia,
 Me syt' keq të zgurdulluar,
 E pëlçet me këmbë malin,
 E derdh zjarrin, porsi lumë 80
 Dhe e ndezur plot shkëndija
 E përpirë bie në ferr.

Kjo mbujtje poetike me ndjesinë homerike të heronjve dhe fenomeneve, që shkretinin tej në Akrokeraune, më shtynë fillimisht të merresha me *Odisenë* dhe më pas me *Iliadën*. Një ndërmarrje e vështirë që kërkonte vullnet, njohuri dhe përjasje me përvoja të tjera, që citohen në literaturën e botimit. Dhe e nisa kështu për dy arsye: se *Odisea* është një endje poetike nëpër pellgun mesdhetar me etjen e aventurës dhe zbulimit të botëve të reja, të panjohura të Perëndimit, ku u vërtitën heronjtë e lavdishëm të Trojës, pasi hyjnitë i mbuluan me lavdi e plaçkë, i ndëshkuan lloj-lloj për dobësitë e tyre njerëzore. Dhe legjendat e djepit mesdhetar këta heronj, por edhe fenomene të tjera para dhe pas Trojës, i përplaste nëpër Akrokeraune si përplasnin dallgët një barkë në furtunë dhe mbetjet a të shpëtuarit dëshmojnë për tragjedinë.

Në botimin *Himara në stubitë e shekujve* nga Spiro Rusha, ceken të dhëna të vyera të lidhjes së krahinës me mitologjinë dhe legjendat e lashta të Mesdheut. Kështu ai përmend se Apollodori thotë se “[Odhiseu] pasi bëri fli për nder të Hades, Persefonës dhe Theirezisë, duke kaluar më këmbë nëpër Epir, arriti te thesprotët dhe sipas orakullit të Theirezisë zbuti zemërimin e Poseidonit me flijime”.

Sipas Homerit Odisea u nis nga ishulli Ajaja ku banonte hyjnesha Circe dhe sipas porosive të saj lundruan që nga perëndimi drejt lindjes dhe arritën “aty ku është krahina dhe qyteti i burrave himarjotë” (“Odisea” botuar në Lipsia, 1860, f. 166); populli aty shton më poshtë, jeton pa i parë rrezet e diellit për shkak të reve të mjegullës, që e mbulon tërë krahinën. Homeri nuk e shpjegon shkakun e këtyre reve dhe mjegullës së vazhdueshme në qiellin e Himarës, por F.C.H. Pukëvili, i cili e ka vizituar tërë malësinë e Akrokeraunëve, kur kryente funksionet e konsullit të Francës në Janinë pranë Ali Pashë Tepelenës, na thotë se janë rezultat të vullkaneve të shumta. Fenomenet e tyre (vjellën e tymit të mjegullës dhe të llavës) ishin zhdukur sepse vullkanet kishin pushuar së vepruari, por Pukëvili e mbështet

tezën e tij në ekzistencën e gjurmëve të tyre, të cilat ai i ka parë vetë gjatë vizitave që ka bërë në këtë krahinë (“Voyage dans la Grece”, f. 250-251).

Sipas Pukëvilit, Homeri ka dashur të përcaktojë Akrokeraunët kur hyjnesha Circe me selinë e saj në ishullin Ajaja, duke e udhëzuar për rrugën detare që duhej të ndiqte, i tregoi plazhin e zbarkimit, ku do të gjente hyrjen e Tartarit (Aornin), të cilin duhej ta vizitonte për të pyetur hijen e falltarit Tiresia, për t’i thënë nëse do të mund të arrinte në ishullin e Itakës apo jo. Atëherë kjo grykë e Tartarit (Aorn), nuk do të jetë ajo që Straboni e vendos në buzën e lumit Akeront të Thesprotise, por ajo që gjendej në Akrokeraunët. “Kur Plini tregon një qytet të Kimerasve të quajtur edhe në ditët e sotme Himarë, emër që do të jetë ruajtur qysh nga një antikitet shumë i largët. Pra, prioriteti i Aornit, probabilitsh i përket Akrokeraunëve, ku princi i poetëve e bën të shkarkojë heroin e saj që u nis nga ishulli i Circes, para se të drejtohet për te mbreti paqësor i Feakëve” (Pukëvili, “Voyage dans la Grece”, f. 250). Prioriteti i Aornit të Akrokeraunëve mbështetet edhe nga dietari i shquar athinas, Apollodori, i cili shkruan në veprën e tij “Biblioteca”, se Odisea pasi bëri fli për nder të Hadit, Persefonës dhe Theiresisë, duke kaluar më këmbë nëpër Epir, arriti te Thesprotët dhe sipas orakullit të Theirezisë, zbuti zemërimin e Poseidonit me flijime (sipas “Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë”, f. 76). Nga citati i mësipërm del se në Thesproti ka shkuar pasi bëri flijimet, që do të thotë se ato i bëri jo në Thesproti, ku vendosi hyrjen e Tartarit (Aornin) Straboni, por në një tjetër vend përpara se të shkonte në Thesproti. Dhe kuptohet se ky vend ka qenë në Akrokeraunet, në Palestë, afër tempullit të Furieve, hyjneshave të mallkimit e të gjakmarrjes: “Hie furit et/ saepe palestinas jurat adess deus” (Ovid. Factorum 4, sipas Pukëvilit në “Voyage dans la Grece” f. 250).

... Kthimi i grekëve për në atdhe pas rënies së Trojës dhe dyndja e fiseve të dorëve në Peloponez, në Kretë dhe në ishujt e tjerë të Egjeut, janë dy ngjarjet, që krijuan një gjendje trazirash e përleshjesh të armatosura midis popujve të ndryshëm të Mesdheut Lindor. Një pjesë e forcave luftarake greke humbën drejtimin gjatë lundrimit, njësoj si Odisea, për shkak të stuhive, të cilat i shtynë drejt territoreve të huaja dhe i detyruan të ngulen në vendbanime të reja. Gjatë kësaj periudhe një grup pellazgësh (ose pulasta) të Palestinës, pas disfatës që pësuan nga izraelitët e Davidit, për t’i shpëtuar zgjedhës së pushtimit, zbarkuan në malet Akrokeraune, në plazhin e Palasës së sotme.

Ndjenjat e autonomisë së banorëve të Himarës u manifestuan në mënyrë të qartë edhe gjatë luftës civile midis Jul Qezarit dhe Pompeut, i cili ishte vendosur me forcat e tij në Iliri dhe në Epir, ndërsa me flotën e tij ishte bërë zotërues i detit Adriatik dhe detit Jon, por në krahinën e Himarës nuk kishte vënë dot këmbë. Edhe Jul Qezari nuk e bën zbarkimin me forcat e tij në Palestë të Himarës me anë

të dhunës, por u mor vesh me drejtuesit e krahinës. (A. Baldacci, “Studi special i albanesi”, vol. III, p. 225.)

Pa marrëveshjen me vendasit nuk vlente aspak gjenia e Qezarit, midis një kaosi malesh shkëmbore, që puqeshin me brigjet e detit të pabesë, si ato që shtrihen që nga Kepi i Gjuhëzës deri në Onhesm (Sarandë), e që karakterizojnë Himarën në shikimin e saj të llahtarshëm, sidomos në vjeshtë dhe në dimër. (A. Baldacci, vep. cit. f. 228.)

Kur Homeri flet për arritjen e Odisesë në Himarë, përmend arritjen e tij “në kufijtë e oqeanit, aty ku ndodhet krahina dhe qyteti i burrave kimeras”. Që këtej del se emri i Himarës si krahinë është parësor në krahasim me qytetin, i cili si krijesë më e vonshme nga vetë krahina ka marrë edhe emrin e saj. Mbas çështjes së emrit Himarë, si emër parësor i krahinës, i cili është bërë edhe emër i qytetit si qendër e të gjitha fiseve të himarjotëve, lind pyetja e etimologjisë së emrit Himarë (ose Kimerë).

Në “Dokumente për Historinë e Shqipërisë” - pjesa e dytë, 1499-1506, Himara përmendet me emrat: Zimara, f. 196; Zimarjoti, f. 281 dhe në veprën e Nilo Borgia-s “I monaci brasiliani in Albania...”, botim i vitit 1935, f. 162 emërtohet Chimara. Si shihet në këto emërtime, figuron togfjalëshi “mar”. Ndërkaq, sipas Max Myler-it, emri i perëndisë helene ARIS dhe i asaj latine MARS e kanë origjinën nga sanskritishtja MARU, perëndia e stuhive, ajo që shkatërron, që shpartallon. Në qoftë se e pranojmë këtë shpjegim etimologjik, atëherë mund të arrijmë në përfundimin se edhe etimologjia e emrit të Himarës e ka burimin në emrin sanskritisht të perëndisë së stuhive, të shkatërrimeve që janë pasojë e luftërave. Këtë përfundim e mbështesim në atë se në emrat e Himarës që kemi përmendur më sipër, është pjesë përbërëse rrënja e fjalës sanskritishtje “mar”. Edhe rrënja e emrit “Hi”, e Himarës është sipas Stuart Manit, e trashëguar nga indoeuropianishtja, njësoj si fjalët: hënë, hije, hyj dhe hy etj. (S. Man, “Shqipja si gjuhë indoeuropiane” - Konferenca e parë e studimeve albanologjike, f. 135). Pra emri Himarë është identik me emrin e perëndisë pagane të luftës, ARIS në greqishten dhe MARS në latinishten. Për këtë shpjegim na vjen në ndihmë dhe fakti se emri i ditës së dytë të javës që në mbarë shqipen është e martë, në të folurën e fshatit Qeparo edhe të fshatrave të tjera të Himarës, deri në vitet '40 të shekullit XX ka qenë e marë dhe nga shumë të moshuarit edhe sot vazhdon të thuhet e marë. Nga pikëpamja e lashtësisë Antonio Baldacci e çon përpara epokës homerike. Ai këmbëngul se emrat e njëjtë të Himarës dhe të Panormit të Akrokeronëve me ata të Sicilisë nuk janë rastësi, por u përket arkeologëve për të zgjidhur problemin nëse Himara ngjitet deri në epokën kretomikenase. (A. Baldacci, vep. cit. f. 234.)

Gjeto Kola ndër të tjera shkruan: “PALERMO - asht fjalë helenike qi d. m. th. shqip “Portë e vjetër”. Emni i vërtetë i ktij asht Kastri pse përmendet nëpër gojëdhana e kangë popullore të Shqiptarëve t’Italis, e të Greqis’ e prej popullit të Himarës. Ky qytet pat kenë në za në kohë të vjetra si Himara, Onesmi, Oriko etj. të cillët u rrafshuen prej Luc Pal Emilit, pris i ushtrinavet romake vjetin 163 mbas Krishtit, i cilli zaptoj kto vende e kshtu u shqym qytetnimi e perparimi i pellazgve. Në ket rasë prishi ma se 70 qytete e mori ma se 300.000 vajza e djelm rob, e i dergoj n’ Itali per të shtuem mënderen e frigen neper vise t’ona. Banorët e Kastris u shperndan do në Greqi, Qerfoz (Korfuz), e tjerët morën malet e Shqipnis. Mbas pak kohet u rivendosen...

Ali Pasha Tepelena, si thame ma parë, ngrahi kështjellin në rrenime të Qytetit Kastrija.

Historija thotë edhe qi kur u ndez Troja mbasi hiku Enea me barkë, erdh e u ndal në ket lima(n). Pozita asht e shqelqyeshme; porti ka formen e një patkonit kali.

Ktu qindruen himarjotët ne kohë të Turqis, por si i muji u fut dhe rrenoj themelisht qytetin Kastri; luftarët i burgosi, e banorët i dboj malevet të cillët sajuen Qeparon, Borshin, Kuçin, Pilurin, Vuno, etj. Flota tregtare e luftare gjen në ket lima një mprojtje të sigurët ndër dallga të mdha”.

Është e habitshme, por edhe në ballë të kalasë që Ali Pashë Tepelena ndërtoi në Panormo (Palermo) të Himarës për Vasiliqinë, sipas legjendës, në pllakën e mermertë të gdhendur në greqisht, ishte shkruar Himni i Aliut. Pavarësisht nga autori i kësaj poezie epigramatike, Vilaras apo Psalidhas, kuptimi është jashtëzakonisht domethënës. Autori i saj, një intelektual grek i përmasave të Zosimeas, lartëson figurën e pashait nga miti në histori, nga Faethonti, biri i Diellit te Shqiponja e Epirit, Pirroja, nga Athinaja, bijë e pamposhtur e Zeusit dhe hyjneshë e diturisë, tek Aresi hyu i luftës. Aliu, kjo figurë legjendare në sytë e popullit dhe të muzës së poetëve të Janinës, ndërliidhet bukur me kalanë e pathyer...

*Ktheni ploret pa frikë, o detarë të huaj
në detin mes Panormos mërinë e erës shuaj,
dhe këtë që tani shibni në ballin tim si yll
është trofe fitoreje, kala që shkrepstin,
më ngritën me zell nuse himarjote,
armike ndaj armiqve dhe ndaj miqve shoqe.
Më njohu Faetonti, më kishte Pirroja nakar,
më mban heroi Tepelenas Aliu i Parë.*

*Në vendet e Epirit i plotfuqishëm Zot
dhe me shpatë në dorë gjeneral i pashoq,
nën urdhër ushtarë ka pesëdhjetë mijë
pa gjumë dhe pa frikë kundër armikut të tij.
Në Janinë prehet luani i trimëruar,
pjellë e Athinasë, nga Aresi mëkuar.
Më 5 shkurt 1814*

Proverbiale dhe homerike është lidhja e himarjotit me vendlindjen, me atdheun, pikërisht ai *nostos*-i i famshëm (*kthimi*) i Odisesë, udhësit të paepur nëpër botën e lashtë të Mesdheut. Ja ç’thotë Pukëvili (*Udhëtim në Greqi*, Paris, 1820): “Këto vende për ditë kanë për himarjotët joshje të reja. Duan buçimën e ujëvarave, që bien mes maleve të tyre. Gëzohen duke dëgjuar gjëmimin e detit, që shpërthen në anëdetet e tyre. Me ngazëllim ndjekin fërshëllimën e erërave dhe të gjithë e dashurojnë dhe e bekojnë vendin e egër, që u qëlloi me gjithë varfërinë e tij. Kështu banori i këtyre maleve është më tepër patriot nga nisioti, adhuron me fanatizëm vendin, që e lindi. Qoftë në mërgon, qoftë në pëson fatkeqësi apo lumturon, nuk humb kurrë trajtën e ëmbël të krahinës së tij. Një instinkt i veçantë ia kujton kurdoherë. Dhe kurdoherë kujtimet e rinisë, e detyrojnë të kthehet pas në strehën e prindërve të vet”.

Marin Barleti, te vepra e tij monumentale “Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut”, shkruan se Topiajt “... ishin të njohur si princër edhe për sundimin e Himerës së Ulksit. Ky është një vend malor kundrejt Korkyrës, ku banon një popull i pamposhtur dhe trim, që të mos them luftarak, të cilin ne e quajmë zakonisht himarjotë. Ata janë të siguar vetëm me mbrojtjen natyrore të vendit, aty s’ka bërë gjë dora apo mjeshtëria e njeriut. Ata i kanë përbuzur gjithmonë me sukses turqit e harbuar pas nënshtrimit të Epirit me vdekjen e Skënderbeut dhe kanë jetuar gjer në këtë kohë pa e njohur sundimin e huaj, me njëfarë lirie të pashoqe të natyrës”.

Ndërsa Joan Kamilli, një misionar i Propagandës Fide të Romës, “nga Drimadesi (Dhërmiu), më 13 qershor 1668”, në një letër shkruan për vendasit: “Naturisht janë fisnikë (sojllinj), duanë luftënë dhe, më tepër se me nga çdo gjë tjetër, zbavitënë me armë, e janë armiq, pothua, me gjithë botënë. Jan’ armiqë me Latinët, jan’ armiqë me Tyrqitë, janë dhe armiqë nërmiet tyre, kaqë sa një fshat vritetë me tjetrin, si të Krishterëtë që goditenë me Tyrqitë fqinjë. Dhe s’ka anë tjetërë për t’i qetuarë veçse një shumë’ e madhe të hollash a krahu i Perëndisë.

... Njerëzitë janë shumë fisnikë dhe fort të zotëritë për çdo punë. Në mos fare, janë mjaft të mirë; dhe sa për tani janë në barbari e në pagdhendësi të madhe se s' kanë as të parë, as qeveri, as no njëfarë diturie dhe janë në varfëri të thellë. Në vetija janë më të tepëret pa dhelpëri, të besësë, dhe vetijat e pështira janë të paka nër ta, dhe imzot më ka thënë shumë herë që, në mes të një qint vetave q'u nxjerr fajetë (kur rrëfehen), mezi gjen dy a tre që të kenë bërë faj vdekjeje; nga ky shkak më tepërë pëlqen një shpirt të këtyre njerëzve, se një qint të nonjë kombi tjetërë” (Revista “Kalendari Kombiar” e Lumo Skëndos, f. 46-52, Sofje, 1901).

Ndërsa Bajroni në poemën e mirënjohur të Çajld Haroldit (*Kënga e dytë*), me penelata të ndezura portretizon malet e Himarës dhe himarjotët:

*Të ngrysur çohen lart përpara syve,
Si amfiteatër vullkanik natyre,
Së majti djathtas, alpet e Himarës...
Të bijt' e Himarës që s'falin as mikun,
Si mundet ta lënë të gjallë armikun?
Si s'markan dot gjak me pushkët besnike,
Ka shenj' më të bukur se zemra armike?*

Në “Gazetën Shqiptare” (*Milosao*), 13 dhjetor 2015, në shkrimin “Në Himarë bashkëjetoi greqishtja e shqipja... por ka gjurmë toponimesh edhe arabe etj.!” , studiuesi i njohur Dhori Q. Qirjazi, ndër të tjera sjell një fakt interesant:

“Rreth 2500 vjet më parë, në një mbishkrim, që i drejtohej Orakullit të famshëm të Dodonës, thuhej:

2012A. α' μισό 4ου αι.

Dakaris, Christidis, Vokotopoulou 1993, 59-60 ap. 7. SEG 43, 1993, ap. 338.

περί τῆς οικῆσιος τῆς
ἐν Χεμαρίων πότερον
αὐτεῖ οικ[έ]ωντι;

ΠΕΡΙ ΤΗΣ ΟΙΚΗΣΙΟΥ ΤΗΣ
ΕΝ ΧΕΜΑΡΙΩΝ ΠΟΤΕΡΟΝ
ΑΥΤΕΙ ΟΙΚΕΩΝΤΙ

(*Lidhur me vendosjen e banorëve të Himarës, [ata shtrojnë pyetjen] nëse dubet (apo munden) të vendosen këtu.*)

Nga teksti i mbishkrimit nuk kuptojmë se ç'vend kanë zgjedhur këta himarjotë të stërlashtë për t'u ngulitur, as edhe arsyt pse kanë vendosur të shkojnë gjetkë. Për nevojat e punimit tonë, ka rëndësi fakti se ata shkojnë diku tjetër, rrahin udhët e detit a të sterësë, pra ngrënë ura të motmoçme, dhe se mbishkrimi është shkruar në dialektin dorik të greqishtes së vjetër”.

Ky tis homerik i Himarës dhe jehona e largët e fëmijërisë buzë Akrokerauneve me ndeshjet e hyjnive dhe përbindëshat e shkrepumave, ishin shtysë për të risjellë në shqip me një tingëllim dhe gurgullimë jonike në shqipen e sotme *Iliadën* e pavdekshme të Homerit...

Duke punuar me *Iliadën*, u përvijua një mënyrë përkthimi, që i afrohet origjinalit në vargje, emërtime dhe konstruktin figurativ të poemës, apo i fjalëpërfjalshëm brenda mundësisë së leximit, në mënyrë që të ruhet aroma e origjinalit, si dhe të përputhet fjalësi i emrave të përkthimit me atë homerik.

Ky përkthim ka disa risi.

Ndërsa te botimi shqip i mëhershëm (para gjysmëshekulli), numri i vargjeve nuk i korrespondon origjinalit (p.sh.: Kënga I, Homeri: 611, përkthimi i mëparshëm shqip: 770; Kënga XV, Homeri 745: përkthimi i mëparshëm shqip: 925 etj.), te përkthimi im vargjet përputhen me origjinalin homerik, duke bërë të mundur edhe krahasimin e tij me botime të përkthimit në gjuhët e mëdha të botës.

Në përkthimin e mësipërm është përdorur vargu i lirë, duke ruajtur trajtën dhe ekuivalentin, me sa është e mundur, të leksikut të origjinalit, pa i shtuar apo hequr fjalë dhe shprehje homerike, dhe kësaj të shijohet në një mënyrë tjetër bota e famshme e antikitetit me heronjtë, ritet fetare, zakonet, fushëbetejat dhe dyluftimet mes heronjve etj., si dhe bota e perëndive të Olimp, që ndërlidhet me veprimet dhe bëmat e njerëzve në tokë. Në të kam ndjekur shembullin e përkthimeve moderne, që synojnë qasjen besnike ndaj veprës së Homerit (*në dallim nga punimet e kohëve të shkuara*), duke përdorur si model përkthimet e *Iliadës* të viteve të fundit nga Kostas Dukas, Rosa Calzecchi Onesti dhe nga Giovane Cerri (*shih literaturën*).



Llabro Ruci në Delf, tek Apolloni, 1987.

Përkthimi shoqërohet nga një shtojcë, e cila bën të mundur që poema të kuptohet nga një rreth i gjerë lexuesish, jo vetëm nga studiuesit e letërsisë antike greke dhe romake: Nga disa studime shoqëruese personalitetesh të shquara të fushës; nga një aparat i hollësishëm me një numër shumë të madh prej rreth 1900 shënimesh, ku ka interpretime vargësh, vendesh, por edhe të instituteve të drejtësisë, hakmarrjes, mikpritjes, dyluftimit etj., një botë homerike e interpretuar që nga komentuesit e lashtë gjer te studiuesit e sotëm, një enciklopedi e vërtetë; nga “Fjalori i emrave”, në tri gjuhë: shqip, greqisht, italisht, me referencat e këngëve dhe vargjeve përkatëse.

Pra, është një përkthim me varg të lirë, i shoqëruar nga një aparat shpjegues, *për herë të parë në shqip*, si një instrument për të lehtësuar leximin dhe për të kuptuar më mirë epokën, traditën, heronjtë, fenë e grekëve të lashtë, për lexuesin e thjeshtë dhe studiuesin e letërsisë së antikitetit.¹

Fund nëntori, 2015

¹ **Literatura:**

- *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, Tiranë 2002;
- Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, Tiranë 1967;
- Pukëvil, *Në oborrin e Vezirit të Janinës*, Tiranë, 1999;
- Gjeto Kola, *Himara*, (“Hylli i Dritës”, 1939 (Nr. 3-7, 8-10, 11-12)-1940 (1-2));
- Kostas Haxhiantoni, *Himara këshjella e pathyer...*, Athinë, shkurt 2002;
- Gavril Dara (i Riu), *Kënga e sprapsme e Balës*. Kthyer në gjuhë të sotme dhe përgatitur nga Sh. Demiraj, Drejtoria e botimeve shkollore, Tiranë, 1965, f. 51.



Andromaka duke mbrojtur të birin Astianakt.

Pikturë nga një vazo antike.

HOMER
ILIADA
ΙΛΙΑΣ



Betejë homerike, vazo antike v. 530 p.e.s.

Lavdies, mirënjohje për jetën që ka vënë në themelet e punëve të mia.



Libri i parë, A

Murtaja dhe mëria

Këndo, hyjneshë,¹ mërinë e Akil Pelidit,
rrënimtaren,² që brenga pa fund u shkaktoi akejve

¹ Ndarja e *Iliadës* dhe e *Odisë* në njëzet e katër libra apo këngë, që është bërë duke përdorur germat e alfabetit jonik, për të shënuar secilin prej tyre, është vepër e gramatikanëve aleksandrinas. Titujt e vënë në krye për çdo libër, tregojnë se si për shumë shekuj janë emëruar pjesë të ndryshme të poemës. Ato janë pajisur nga shënimet, si dhe nga Eustazio-ja, por duhet të kenë zënë fill nga praktika e recitimeve rapsodike, ngaqë dëshmohen qysh në epokën klasike (*“Bëma e Diomedit”*, Herodoti, a, 116 etj.).

Vargu 1. Si në tekste të tjera arkaike, *Iliada* hapet me një hyrje ku thirret hyjnesha frymëzuese e këngës dhe rrëfëhet, shkurt, tema e kompozimit. *Hyjnesbë*: është Muza, që i dikton poetit ato që duhet të thotë. Le të ndërmendim dhe vargun e parë të *Odisë*. Sipas konceptit të kohës, vepra e aedit frymëzohet nga hyu dhe kjo thirrje ishte lutja e një besniku, i cili e di se sa i vështirë, por edhe sa i rëndësishëm, është funksioni i saj. Madje gjersa ishte Muza, që fliste me gojën e poetit, aedi mund të përshkruante dhe skena, që luheshin në Olimp, se të mos harrojmë, që sa thoshte, ishin për atë vetë dhe për dëgjuesin, të vërteta, pa shkaktuar habi se nga i mësoi.

Muzat gjetkë emërohen në shumë (*Iliada* II, 484 etj.). Bija të Zeusit dhe të Mnenosinës (*“Memoria”*, *Kujtesa*), Muzat janë hyjnesha të muzikës, të këngës dhe të valles. Janë ato që mbikëqyrin veprimtarinë poetike, duke i dhënë apo duke i mohuar aedit aftësinë për të endur fillin e një kënge të caktuar. Ky solidaritet i ngushtë mes bijave të kujtesës dhe fjalës poetike, është i rikthyeshëm te karakteristikat e vetë këngës epike, thelbësisht gojore (e improvizuar në fazën më antike, pastaj në një fazë pasardhëse, recituar përmendësh), që kërkonte një mësim të gjatë të kujtesës, një mnemoteknikë të vërtetë e të veçantë pak a shumë të ndërgjegjshme.

² 2. *Rrënimtaren*: Në origjinal mëria e Akilit karakterizohet e *mallkuar*. *Akili*: bir i Peleut dhe nip i Eakut. E mbajmë mend nga *Odisea*, sidomos nga përgjigja që i dha Odisë, të cilin e quajti të lumtur për nderimin që gëzonte sa jetonte, dhe për pushtetin që gëzonte në Had: Vdekja nuk ka ngushëllim!

dhe në Had rrokullisi shumë shpirtra burrërorë
heronjsh, ata i bëri pre të qenve¹
dhe gjithë orlave,² vullneti i Zeusit po kryhej,³ 5
qysh në fillim kur u grindën dhe u ndanë,
Atridi, prijës i burrave dhe Akil hyjnor.⁴
Dhe nga hyjnitë kush ndezi armiqësinë mes tyre?
Biri i Zeusit dhe i Letosë,⁵ i zemëruar me mbretin,
dhe një murtajë të keqe⁶ solli në ushtri e korrtë popujt 10
se nuk nderoi Krisin, priftin,⁷
Atridi, që erdhi në anijet e shpejta⁸ të akejve

Do të preferoja të punoja i gjallë në arën e ndonjë varfanjaku, sesa të mbretëroj në Had mbi të vdekurit. Këto fjalë tregojnë se sa ishte i lidhur hero i me jetën. Dhe tek *Iliada* do të shohim të njëjtën dashuri të Akilit për jetën. Ndërkaq do ta flijonte i gatshëm për të marrë hak për vdekjen e mikut të tij më të dashur, Patroklit. Brengën për jetën Akili e ruan edhe brenda në Had.

Naim Frashëri, përkthimin e Këngës I të poemës: “Iliadhë e Omirit” (1896), botuar në Bukuresht, e fillon: “O vashë! Këndo mëninë/ E Aqileht Kordhëtarit...” Si shihet, Naimi përdor trajtën e gërgërishtes: *mëninë* (mërinë), që i përngjan origjinalit homerik: *minin* (Μῆνιν).

¹ 4-5. Jo gjithmonë pas për të varrosur të vdekurit. Mungesa e varrimit konsiderohej nga të lashtët si një fyerje e rëndë për të vdekurin dhe një pengesë për zbritjen e shpirtit të të ndjerit në Had.

² 5. *Orli*, shpend grabitqar, i madh, mishngrënës; shqiponjë a hutë.

³ 5. *Vullneti i Zeusit*: Është premtimi i Zeusit bërë Tetit për të favorizuar në betejë trojanët, duke shkaktuar vdekjen e shumë akejve dhe duke “shpërblyer” kësajsoj Akilin për fyerjen pësuar nga Agamemnoni.

⁴ 7. *Atridi, prijës i burrave*: Agamemnoni karakterizohet shpesh *prijës i burrave*, prijës i ushtrisë, kishte marrë komandën e fushatës, ngaqë mbretëronte në shtetin më të fuqishëm të kohës, në *Mikenën me shumë ar* (shih v. 276 etj.). Kur poeti flet për Atridin, nënkupton atë, jo të vëllanë, Menelaun.

Dhe Akil hyjnor, në origjinal *d(h)ios*, që e ka prejardhjen nga Zeusi. Ky karakterizim u jepet mbretërve, heronjve, grave të famshme, se konsideroheshin të lindur nga hyjnitë, krenoheshin se rridhnin nga Zeusi. Poeti përveç *hyjnilindur* (v. 337 e gjetkë), i quan dhe *hyjnimëkuar*, ushqyer nga hyjnitë (176 e gjetkë).

⁵ 9. *Biri i Zeusit dhe i Letosë* është Apolloni.

⁶ 10. *Dhe një murtajë të keqe solli*, sëmundja shfarosëse, që dërgon Apolloni, përputhet dhe me karakterizimin e hyut, Apollon Smintheas (*Smintear*, hyu i minjve). Në Troadë e gjetkë, adhuronin Apollonin si hyun që largonte sëmundjet. Dimë se murtaja përhapet nga minjtë dhe Apollon Smintheas ishte hyu, që kishte fuqinë të shkaktonte dhe të dëbonte murtajen. Apolloni mbante epitetin harkargjendë, se ishte hyu i harkut dhe i shigjetës, si paraqitet edhe në artet figurative; lidhur me këtë privilegj, ishte aftësia e hyut për të qëlluar persona të veçantë apo popuj të tërë me sëmundje të vetëtimta apo me epidemi, të ndjera në imagjinatën e grekëve si efekt i shigjetave të tij hyjnore.

⁷ 11. *Prifti*: Krisi ishte prift i Apollonit.

⁸ 12. *E shpejta*, mbiemër i qëndrueshëm tradicional i anijeve, element stolisës i tyre. Përdoret jo vetëm në kuptimin konkret, por edhe që të mos kalojmë pa vënë re dhe t’u gëzohemi anijeve, të cilat kanë plot nëntë vjet, që rrinë tërhequr në tokë.

për të liruar të bijën, duke sjellë shpërblesë të pafund;¹
 në dorë mbante kurorat e Apollon largshigjetarit
 mbështjellë në skeptrin e artë dhe luste gjithë akejtë, 15
 por mbi të gjithë dy Atridët, prijësit e popujve:
 “Atridë dhe ju akej të tjerë këmborefortë,²
 ju dhënçin hyjnitë, që kanë shtëpitë e Olimpfit,
 të shembni qytetin e Priamit, të arrini shëndoshë në atdhe;
 por lironi bijën time të adhuruar dhe shpërblesën pranoni 20
 duke përndëruar të birin e Diosit,³ Apollon largshigjetarin”.⁴
 Atëherë të gjithë akejtë e tjerë thirrën e thanë
 të respektojnë priftin, të pranohet shpërblea e ndritshme;
 vetëm Agamemnonit në zemër kjo s’i pëlqeu, Atridit,
 dhe e dëboi me të keqe, e fjalë të rënda i tha: 25

¹ 14. Në dorë mbante kurorat e Apollon largshigjetarit: Në origjinal kemi fjalën stemata (στέματα), ishin cepat e lirshëm të një kordeleje prej leshi, me vlerë fetare, mbështjellë në majë të skeptrit, që mbante prifti. Krisi është këtu edhe lutës edhe prift, prandaj ia vlen ta nderojnë dyfish. Ka shumë mundësi, që këto kordele të ishin në realitet të Apollonit, dmth. të stolisnin shtatorën e tij brenda në tempull, dhe Krisi t’i ketë sjellë me vete si dëshmi të lidhjes së tij me hyun. Këto fasha ishin kordele prej leshi, që shërbenin si zbulurime të shenjta në ritualet e hyjnive të ndryshme: mund të ishin veshur nga prifti shërbyes, apo të ishin nga shtatorja e hyut, a të mbështullnin bisqet që mbanin në dorë pjesëmarrësit në rit. Krisi dëshiron t’u drejtojë lutjen e tij akejve duke u paraqitur në cilësinë dhe madhësitinë e priftit të Apollos: për këtë shkon në kampin armik me skeptrin të mbështjellë nga kordelet e shenjta.

Apolloja është quajtur *ἐκηβόλος*, *shigjetar* (me epitete ekuivalente *ἐκατηβελέτης* te v. 75; *ἐκάεργον* te 147; *ἐκατηβόλος* 370; *ἐκάτος* te v. 384; *ἀργυροτόκος*, *harkergjend* te v. 37), se ishte hyu i harkut dhe i shigjetës, me të cilët është pasqyruar në artet figurative. Lidhur me të, privilegji i hyut ishte aftësia për të qëlluar persona të veçantë, apo popuj të tërë me sëmundje zhuritëse apo epidemi, të ndiera në imagjinatën e grekëve si efekt i shigjetave të tij hyjnore.

Kriseida dhe Briseida quhen nga Homeri vajzat nga emrat e etërve të tyre, Krisi dhe Brisi. Si thonë poetët të tjerë, emrat e vërtetë të tyre ishin Ipodamea dhe Astinomi.

Naimi v. 12-13 e përkthen: “Nd’ anijat të ahajinjet/ Kishte sjellë dhe kanisqe”. Pra, *shpërblesën e pafund* e quan *kanisqe*.

² 17. Krisi i drejtohet kuvendit (asamblesë), që merr gjithë vendimet e rëndësishme, ndan plaçkën e luftës, siç është thënë shpesh dhe mund të thirret nga cilido prej krerëve (në v. 54 nga Akili); Agamemnoni, që është një i parë mes të barabartëve (titulli i “mbretit”, që nga ana tjetër e mbajnë dhe të tjerët, nuk duhet të na gënjejë), mund të shpërdorojë pozitën e tij dhe nga epshmëria e asamblesë, për të detyruar vullnetin e tij, si këtu, apo për të kryer një padrejtësi në dëm të një prijësi tjetër, si do të bëjë pas pak. Por bëhet fjalë për shpërdorim dhe padrejtësi, si do të dëshmojë pjesa tjetër e *Iliadës*.

Këmborefortë: epitit i akejve, që përsëritet shpesh e shpesh tek *Iliada*. Kollçik, kallca, këmbore; në Epokën Klasike dhe në Mesjetë, ishte pjesë e armaturës, që mbronte pjesën e përparme të këmbës, nga gjuri gjer në fund të saj.

Naimi përkthen kësisoj: “Ahajinj, o pulpmirë”, pra akej këmborefortë.

³ 21. *Dios*: Zeusi. *Kronidë*: i biri i Kronit (Kronos), Zeusi.

⁴ 21. *Apollon largshigjetarin*: Apolloni është hyu shigjetar, i cili duke goditur nga larg qëllon shenjën. Me karakterizimin *largshigjetar*, i cili shoqëron dendur emrin e hyut, që këtu duhet të jetë ngarkuar me peshë kuptimore, poeti parapërgatit skenën e vargut 44 e në vijim, ku do të shohim *largshigjetarin* Apollon në veprim. Apolloni është mbrojtësi më i rëndësishëm i Trojës (shih V, 436; XVI, 698 etj.).

“Plak, mos të takofsha prapë, pranë anijeve zgavroshe,
 a të vonohesh këtu tani, apo të kthehesh prapë
 dhe mos s’ të shërben skeptri dhe kurorat e hyut.¹
 Atë unë s’do ta liroj; më parë pleqëria do ta gjejë
 në Argos² në shtëpinë time, larg atdheut, 30
 të end në avlëmend dhe shoqe shtrati ta kem.
 Mos më zemëro, ik menjëherë, në do të mos ta pësosh”.
 Kështu tha dhe u tremb plaku e fjalës së tij iu bind;
 i heshtur shkoi nëpër rrerën e detit shumëdallgësh;
 dhe kur u gjend larg, shumë e luti plaku 35
 mbretin Apollon, që e lindi flokëbukura Leto:
 “Dëgjomë Harkargjend, mbrojtës i Krisës³
 dhe i Killës hyjnore, zot në Tenedo,⁴
 Smintë,⁵ nëse të ndërtova tempull të të gëzohet zemra,

¹ 28. ... *mos s’ të shërben skeptri dhe kurorat e hyut*: këto fjalë janë fyerje e madhe në fetarinë e Apollonit. Ndaj dhe kundërshtia klerikale e hyut është e egër, si shihet më poshtë. Agamemnoni njëherësh tregon pavarësi mendimi dhe besim në fuqitë njerëzore. Naimi këtë varg e përkthen: “Se pastaj s’ të bëjnë punë/ As stapi yt i florinjte,/ As kuror’ e Apollonit!”.

² 30. *Në Argos*: me emrin Argos, poeti nënkupton herë shtetin e Agamemnonit në Argolidë, si këtu, herë qytetin Argos, që mban gjer tani të njëjtin emër (IV, 52), herë Greqinë Jugore, veçanërisht Peloponezin, në dallim me atë veriore (VI, 152), herë të gjithë Greqinë (IX, 246, shih I, 382, dhe gjetkë: Argej).

³ 37. *Krisë*: qytet afër Trojës ku Krisi ishte prift i Apollonit. Një qytet me emrin Krisë me një tempull Apoll Smint(h)eut, gjendej në bregun perëndimor të Troadës, afër qytetit të vonët të Hamaxitos.

⁴ 38. *Killës hyjnore*: e shenjtë, qytet i Troadës (afër Trojës). Gjeografi Strabon (13, 1, 62 etj.) theksonte se ende në ditët e tij ekzistonte një vend i quajtur kështu, në gjirin Adramyttion, ku ngrihej një tempull i Apollon Kileut. Po, sipas Strabonit, ajo nuk ishte mjaft afër detit për t’u identifikuar me Krisën homerike; duhet të ketë qenë pranë detit (shih v. 430 etj.), në fushëtirën Adramyttion, jo larg nga Killa dhe nga Teba, ngaqë Kriseida u zu robinjë në Tebë (shih v. 364-369).

Si karakterizim qytetesh nënkupton: që e mbrojnë hyjnitë. Në fund të fundit të gjitha qytetet mund të karakterizohen të shenja, sepse ia kushtojnë ndërtimin e tyre ndonjë heroi, pasardhës hyu dhe kanë një hy mbrojtës.

Tenedos: një ishull i vogël i Egjeut, në jug-perëndim të Trojës. Ruan gjer tani emrin e tij. Nga këto vargje kuptojmë se në rajonin e Trojës duhej të ekzistonte adhurimi i veçantë i Apollonit.

⁵ 39. *Smint(h)é*: epitet i Apollonit si shkatërrues i minjve fusharakë.

Këtë mbiemër (Smintheys, Sminthios) Apolloni, sipas Aristarkut, e mori nga *Smintis* - qytet trojan, ku ekzistonte një tempull i hyut; sipas Eolikut emri rrjedh nga: *σμίθος* (smíntos), mi fusharak, sepse si ky ashtu dhe kafshë të tjera tokësore, ishin simbole shortarie; sipas të tjerëve (Apion, Eustatios) ka kuptimin e *μιοκτόνος* (mioktónos), vrasës minjsh, dmth. çliroi vendin nga ca plagë të frikshme të minjve fusharakë, që zhduknin prodhimet.

Nëse të ndërtova... nëse të doja ... më kryej: një shprehje tipike lutjeje: nëse ndonjëherë të kam kënaqur, ndihmomë tani.

nëse ndonjëherë të dogja kofshë të majme¹ 40
 demash a dhish, këtë dëshirë më kryej:
 Shigjetat e tua danajve t'u shpaguajnë lotët e mi".
 Kështu foli duke u falur dhe e dëgjoji Feb Apolloni
 e zbriti nga majat e Olimpiti i inatosur në zemër,
 me hark në supe e kukur të mbërthyer lart e poshtë. 45
 Krisën atëherë shigjetat mbi supet e të inatosurit
 kur u nis; dhe zbriste me natën përngjarë.
 Qëndroi pastaj larg anijeve dhe lëshoi një shigjetë,
 e frikshme ishte ushtrima e harkut të argjendtë;
 mushkat shigjetoi në fillim dhe qentë e shpejtë, 50
 pastaj mbi ta duke hedhur shigjeta të hidhura
 i shënonte; e paprerë zjarre të vdekurish digjeshin, dendur.
 Nëntë ditë hyu fluturonte shigjetat mbi ushtri;
 dhe të dhjetën popullin² në kuvend thirri Akili,
 siç ia shtiu në mend hyjneshë Hera, llërëbardha,³ 55
 që pikëllohej duke parë se si vdisnin danajtë.
 Dhe kur ata u thirrën e u mblodhën grumbull të gjithë,
 mes tyre u ngrit Akili këmbëshpejtë⁴ dhe u tha:
 "Atrid, tashmë ne të sprapsur, besoj,
 pas do të kthehemi, nga vdekja në shpëtofsim, 60

¹ 40. Nëse ndonjëherë kofshë të majme të dogja: kur bënin fli, kishin zakon të digjin në altarën e hyut kofshët e kafshës së therur, pasi i lyejnë me shtresë të dyfishtë dhjami, që të digjeshin më shpejt. Përsipër vinin copa të tjera mishi nga kafsha e prerë, që të krijohet përshtypja se po ofrohej e gjithë kafsha. Në kohën kur digjej, spërkatëj me verë, libacion i hyut. Të përbrendshmet dhe copat e tjera të mishit, ndaheshin mes besnikëve.

² 54. *Populli* (λαός) në original: ushtarët, luftëtarët, burrat.

³ 55. *Llërëbardha*: në origjinal λευκόλενος, apo krahëbardha, epitete zburues, që pasqyrojnë bukurinë e hyjneshës. Poeti e përdor dhe për gra të vdekshme, Helenën (III, 121), Andromakën (VI, 371) e gjetkë. Herën do ta shohim kurdoherë mbrojtëse të grekëve. Mitologjikisht sjellja e saj justifikohet me fyerjen, që i ka bërë Pari me gjykimin ("Gjyqin e bukurisë") e tij (XXIV, 25 etj.).

Në luftën e Trojës, Hera, bashkë me Athinën dhe Poseidonin, marrin pjesë në anën e grekëve dhe janë kundërshtarë të trojanëve; në të kundërt, Apollin, Afërdita dhe Aresi mbrojnë trojanët.

⁴ 58. *Këmbëshpejtë*: mbiemër tradicional, i qëndrueshëm, zburues, që pasqyrojnë një veti të Akilit (shih: *me këmbët me krabë*, v. 121 e gjetkë). Epitetet që aludon në përgjithësi për aftësinë, shumë të rëndësishme për një luftëtar, për të ndjekur armikun dhe anasjelltas, për t'i ikur atij gjatë betejës. Nga ana e kritikës moderne është shtruar një hipotezë që çiftëzimi i qëndrueshëm i këtyre epitetit me emrin e Akilit, e ka origjinën nga ndonjë rrëfim antik, që s'na ka arritur, ku kjo cilësi e Akilit, kishte një peshë përcaktuese në zhvillimin e ndonjë ngjarjeje. Është gjithashtu e mundshme që të vihet në raport me një episod të vetë *Iliadës*, ku shpejtësia e Akilit është theksuar me ngulmim të parreshtur, domethënë me ndjekjen e trefisht të Hektorit rreth murit të Trojës (XXII, 136 etj.). Ky problem i pranishëm edhe në kritikën antike, shkaktoi në ndonjë rast hamendje të çuditshme.

gjersa murtaja dhe lufta bashkë i rrënojnë akejtë.

Pra, le të pyesim ndonjë falltar apo një prift,¹

a një ëndërrshpjegonjës,² - dhe ëndrra vjen nga Zeusi, -

të na thotë pse u zemërua aq shumë Feb Apolloni;³

mos është hatërbetur nga ndonjë mblatë a hekatombë,⁴ 65

apo aromë qengjash dhe dhish të pjekura të zgjedhura

dëshiron baraspeshë që mynxyrën të largojë prej nesh”.

Këto foli dhe u ul; dhe mes tyre u ngrit

Kalkant Testoridi,⁵ mes falltarëve i parë,

që gjithë të ardhmen njihje, të sotmen, të kaluarën 70

dhe u priu anijeve akeje gjer në Ilion

me shpirtin profetik dhuruar nga Feb Apolloni.

Atyre dëshirëmirë ai u foli dhe u tha:

“Më grish të shpjegoj Pelid, nga Zeusi i dashur,⁶

zemëratën e Apollonit mbretit largshigjetar; 75

Një gramatikan i shek. I të e.s., Ptolome Cheno, rrëfen dy mite, që mund të merret me mend se kanë lindur me qëllim që të shpjegojnë shpejtësinë e Akilit: 1) që Kironi, të cilit ai i ishte besuar, i kishte vënë thembrën e Damysos, më i shpejti i Gjigantëve; 2) që Teti e kishte pajisur me krahët e Arkes, një hyjni, që e syrgjynosi Zeusi në Tartar, ngaqë kishte luftuar përkrah Titanëve gjatë luftës mes tyre dhe hyjnive olimpikë.

¹ 62. *Falltar a prift*: punë e falltarëve ishte t’u interpretonin njerëzve shenjat e hyjnive, që zbulonin të ardhmen: gjëmime, fluturime zogjsh etj. Në Këngën e 17-të të *Odisesë* (v. 383) përmenden midis *demiurgëve*, dmth. mes atyre, që ofrojnë disa shërbime publike.

Prifti ka një kuptim më të gjerë sesa falltari. Prifti ishte përgjegjës për të gjitha ceremonitë kushtuar hyjnive, flijimet etj. dhe supozohej se njihje dëshirat e hyut, që i shërbente (shih v. 65).

² 63. *Ëndërrshpjegonjës*: që interpreton ëndrrat, të cilat i dërgojnë hyjnitë - këtu i referohet vetëm Zeusit - dhe shumë herë ishin tregues për të ardhmen për ata që dinin t’i interpretonin.

Këtë ta kujtojmë më poshtë (*Iliada* II, 1-6), ku Zeusi dërgon ëndrrën mashtruese dhe shkatërruese tek Agamemnoni. Akili këtu nuk e ndien, sigurisht, se ëndrra mashtruese vjen nga Zeusi, që më pas, përgënjeshtrohet nga realiteti.

Naimi vargun 62-63 e përkthen: “Shtjes’ a faltarë të gjejmë,/ A nonj’ ëndërrërrëfenjës,/ (Se dh’ ëndërra vjen nga Hyji),/ Të pyesim e të na thotë.”

³ 64. Akili është i sigurt se Apolloja është shkaku i sëmundjes, sepse atij i atribuoheshin epidemitë me vdekje të papritura.

⁴ 65. *Ndonjë hekatombë*: fjalë për fjalë: “Fli prej njëqind qesh’, përgjithësisht fli e pasur edhe me kafshë të tjera, veç qeve” (shih v. 309 dhe gjetkë). Në v. 99, 431 etj. karakterizohet e *shenjtë*, hyjnore, se i përket botës së hyjnive.

⁵ 69. *Testorid*: i biri i Testorit, kështu Homeri quan dhe Alkmaonin, të cilin e vrau Sarpedoni (XII, 394). Mbase Alkmaoni është vëlla i falltarit Kalkant. Testori ishte bir i Apollonit apo Idmonit me Laotoin.

Kalka Testorid: Kalkanti, i biri i Testorit, është falltari i ushtrisë greke.

⁶ 74. ... *nga Zeusi i dashur*: διφίλος, që e do Zeusi, është një mbiemër tradicional, që u kushtohet shumë heronjve, si Fenikës (I, 168), Hektorit (X, 49), Odisesë (XI, 419), dhe të tjerëve. Shih shënimin: *hyjnor*, I, 7.

unë do të flas, por ti mendohu dhe m'u beto¹
 vërtet të më ndihësh i gatshëm me fjalë e me dorë,
 se më ngjan do të ndez inatin e një burri, që mbi të gjithë
 argejtë sundon dhe akejtë i ka nën dëgjësë;
 se më i fortë mbreti i mëritur me një burrë më të dobët, 80
 se dhe po të gëlltit zemërimin atë ditë,
 atëherë më pas gjersa të marrë hak inatin mban
 në gjoks; mendohu nëse do të më shpëtosh".
 Dhe Akil këmbëshpejti iu përgjigj e i tha:
 "Ki kurajë e thuaj profecinë hyjnore që të di mendja, 85
 se për Apollonin² i dashur nga Zeusi, që Kalkant
 uratat t'i dëgjon, ti danajve shfaqu profecitë hyjnore,
 dhe gjersa unë të rroj dhe të hap sytë mbi tokë, askush,
 mbi ty s'do të ngre dorë të rëndë pranë anijeve
 nga gjithë danajtë, as dhe po të përmendësh Agamemnonin, 90
 që tani shumë lëvdohet se qenka më i forti i akejve".³
 Dhe falltari i paqortueshëm⁴ mori guxim e tha:
 "As për blatë s'është hatërmbetur, as për hekatombë,

¹ 77. Kalkanti për të thënë mendimin e tij, kërkon përkrahjen e Akilit, gjë që do të thotë se ia kishte frikën Agamemnonit.

² 86. Akili betohet për Apollonin (hyun e falltarisë, por edhe të Krisit, i cili kishte dërguar murtajen tek akejtë) se do ta ndihmojë.

³ 91. ... *lëvdohet se është i pari i akejve*: këto fjalë nuk janë qortim për Agamemnonin, është kryekomandanti, mbreti më i madh (shih v. 6 etj.). Që Akili t'i thotë falltarit: mos u tremb, do të të rri pranë edhe sikur të duhet të përballoj kryeprijësin, është diçka e natyrshme. Por paralelisht poeti përgatit përplasjen Akil-Agamemnon.

Akili duke thënë këtë frazë ("... sot lëvdohet se është i pari i akejve") për Agamemnonin, njëherësh vë në dyshim kreun (udhëheqjen, komandën) e tij. Kjo do të thotë se përpara se Agamemnoni të vendosë për të marrë Briseidën nga Akili, dasia mes tyre ka filluar. E nisi Akili me qëndrimin dhe fjalët e tij. Veprimi i mëpasmë i Agamemnonit që të mëtojë vajzën nga Akili, mund të jetë përgjigja e mbretit dhe e prijësit të grekëve, që ta sjellë në rregull. Madje dhe veprimi i Kalkantit, që të kërkojë përkrahjen e Akilit për të folur, i rrëfeu Akilit se ajo që do të thotë, do të ishte diçka e keqe për Agamemnonin. Dhe e përkrah menjëherë, e ndërkohë akuzon Agamemnonin, dhe pret përuljen e prijësit.

⁴ 92. ... *i paqortueshëm*: fisnik, i patëmetë, i përkryer, i shquar, i papërgënjeshtuar. Mbiemër epik, që paraqet një lavdërim të përgjithshëm dhe i referohet më shumë pozicionit shoqëror të heroit: le të kujtojmë Egjistin e paqortueshëm (fisnik) në Këngën 1 të *Odiseësë* (v. 39), ku përjashtohet çdo ngjyrim moral.

por është prifti shkak, që Agamemnoni s'e nderoi;¹
dhe as i liroi të bijën, as e pranoi shpërblesën, 95
ja pse na pikëlloi e do të na pikëllojë Largshigjetari.
Dhe më parë murtajën e frikshme s'do të largojë nga danajtë,
pa i kthyer më parë të atit vajzën syndritur,²
pa shpërblesë, të pablerë³ e pa dërguar një hekatombë të shenjtë
në Krisë; atëherë mund ta zbutim e mbase falja bëhet?. 100
Këto tha dhe u ul; e u ngrit mes tyre
heroi Atrid, sundimtar i shumë popujve,⁴ Agamemnoni,
i helmuar; dhe vreri i frikshëm të brendshmet e zeza⁵
i përmbytëte të gjitha e i shkëlqenin sytë pors i flakë.
Me një shikim kuptimkeq shpejt Kalkantit i thirri: 105
“Falltar i të keqes⁶, jo, kurrë s'më the një ogur të bardhë,
mendja jote dëshiron të liga gjithnjë të parashohë;
fjalë të mirë kurrë nuk ke folur as ke kryer.

¹ 94. *Atridi e përbufzi*: që nuk e nderoi si duhej, e ka fyer. Shih dhe v. 244.

² 98. ἑλιώπιδα κόρυνη: vajza me sy të ndritshëm, ky është i vetmi rast te Homeri, që epitetin ἑλιώψ e referon një κόρυνη, vajze. Në të gjitha rrethanat e tjera shfaqet në formulën ἑλιώπες Ἀχαιοί (shih p.sh.: v. 389). Kritikë antikë dhe modernë janë ndarë lidhur me kuptimin e shprehjes: shumë kuptojnë ἑλιώψ = “me sy të lëvizshëm”, “me vështrim të gjallë, të ndezur”; sipas të tjerëve, përkundrazi kupton “me sy të zehtë”.

3 99. ... pa shpërblesë, të pablerë: Krisi kishte ardhur me dhurata të pasura, që të shkëmbente lirinë e të bijës. Tani Kriseida duhej t'i kthehej të atit pa qenë nevoja për shpërblesë.

⁴ 102. ... *sundimtar i shumë popujve*: karakterizim i Agamemnonit, shih *prijës i burrave* (v. 7), *prijës i heronjve*, i ushtrisë: Agamemnoni me një sundim të gjerë.

⁵ 103. ... *të brendshmet e zeza*: mund të supozonim se të brendshmet janë të zeza nga zemërimi, shih: u nxi zemra ime. Por, meqë herë të tjera *të brendshmet e zeza* mbushen me vrull, me forcë, me kurajë, është më e saktë të themi që të brendshmet janë të zeza, se gjenden në brendësi të trupit, pra kemi të bëjmë me një mbiemër tipik, që nuk i referohet rastit të veçantë me të cilin ndeshemi.

Dhe një shpjegim tjetër: *φρένας* (frenes, *it.* precordi), shkolla hipokratike quan kësisoj diafragmën, por ngjan që te Homeri ky term, i përdorur në njëjës a shumë, i korrespondon në përgjithësi gjithë sa gjendet rreth zemrës, në gjoks, shih p.sh. te VIII, 413; XVI, 481, 504; *Odisea* IX, 301. Imagjiohej që *φρένας* ishin ideja e emocioneve, dashuri, zemërim, kurajë dhe e mendimit dhe zgjuarsisë.

⁶ 106-108. Agamemnoni si duket i referohet një profecie tjetër, dhënë nga Kalkanti në Greqi, para fillimit të luftës, sipas së cilës flota do të nisej për në Trojë vetëm kur t'i sakrifikohej Artemidës një nga vajzat e Agamemnonit, *Ifigenia*.

Homeri s'përmend drejtpërdrejt flijimin e *Ifigenisë*, ndofta se bëhet fjalë për fli njerëzore, një ngjarje e dhimbshme, që rëndon grekët e sidomos Agamemnonin. Por, sidoqoftë, e dinte poeti, e dinin dhe dëgjuesit e tij, dhe e thërret kur ia do nevoja, si këtu ku dëshiron ta paraqesë Kalkantin, apo shpërthimin e zemërimit të Agamemnonit kundër tij. Ky mit nuk është cekur gjetkë tek *Iliada*; përkundër është trajtuar nga Hesiodi, si dhe është rimarrë nga tragjikët, që i kushtuan drama të ndryshme, mjafton të citojmë: *Ifigenia në Aulidë* dhe *Ifigenia në Tauridë* nga Euripidi.

Dhe tani mes danajve profetizon duke thënë
 se për këtë shkak Largshigetari u dërgon fatkeqësi, 110
 ngaqë shpërblesën e pasur të bijës së Krisit
 s'doja të pranoja; po, unë dëshiroj më mirë vajzën
 në shtëpi të kem, që e çmoj vërtet mbi Klitemnestrën,
 gruan time të ligjshme, se më poshtë saj nuk është
 as në trup e në pamje, as në mendje e në punë. 115
 Veç nëse kjo gjë nevojitet, prapa do ta kthej,
 popullin shëndoshë e mirë e dua, kurrë të mos shfaroset.
 Por përgatitmëni shpejt një dhuratë tjetër, se unë vetëm
 nga argejtë pa pjesë s'duhet të mbetem, s'është e hijshme,
 se të gjithë e shihni që dhurata ime gjetkë shkon".¹ 120
 Ia ktheu këmbëshpejti Pelid baras me hyjnitë:
 "Atridi lavdimadh, më kamjedashësi nga të gjithë,
 shpirtmëdhenjtë akej si të të japin dhuratë?
 Mos dihet vallë se ka diku plaçkë² të pasur të përbashkët?
 Gjithë sa nga qytetet që pushtuam u ndanë 125
 dhe t'i bëjnë prapë grumbull popujt s'është e drejtë.
 Por ti tani atë për hir të hyut liroje dhe akejtë
 trefish e katërfish do të ta shpërblejmë nëse dikur Zeusi
 e jep të pushtojmë qytetin e Trojës me mure të fuqishme".
 Dhe i fuqishmi Agamemnon atij iu përgjigj e tha: 130
 "Por kështu, dhe pse qenke trim, Akil pamjehyjnori,
 dredhisht s'do t'ia dalësh mbanë, lehtë s'do të më bindësh.
 Vërtet dashke që ti të kesh dhuratën tënde e mua
 të më mungojë dhe më nxit atë ta kthej pas.
 Por nëse më japin një dhuratë akejtë shpirtmëdhenj 135
 sipas shijes sime, pjesë e barasvlershme, mirë do të jetë,
 e po s'më dhanë, do të vij me dorën time
 të marr ose tënden, a dhuratën e Ajaksit apo atë të Odisesë³

¹ 120. Nga kjo pikë e tutje, shihet se *kjo kundërshti* ka prejardhje të largët, përtej rastit të tanishëm, dhe vështirë të ndërtohet. Dhurata për të cilën diskutohet është vlerësimi, që secili merr për aksionet, që ka kryer, dhe e bëjnë secilin me "nderin" personal. Agamemnoni, kreu ushtarak i zgjedhur, merr më shumë se të tjerët, por nëse një Akil, konsiderohet më i fortë se ai, nuk ekziston ligj, që e detyron të bindet.

² 125. Akili do të kujtojë më pas se vetë ai me njerëzit e tij ka shkatërruar dymbëdhjetë qytete; në rrjedhën e poemës, prej tyre emërohen Teba, Lirnesoja, Lesboja, Skiroja, Tenedi, Pedasi. Plaçka e luftës, marrë nga këto qytete, përbëhej nga tripodë, kazanë, ar, bronz, hekur, kuaj, mushka, kope, qe dhe gra të bëra skllave (IX, 122-130; XIX, 243-248; XXIII, 259-261, 549-550).

³ 138. ... *do të vij me dorën time/ të marr ose dhuratën tënde a të Ajaksit apo atë të Odisesë* i thotë Agamemnoni se po të japë dhuratën e tij (Kriseidën), do të marrë ose të Akilit, ose të Ajaksit ose të Odisesë (madje, që të shohë dhe reagimin e dy mbretërve të tjerë).

do të marr; e te kush të vij më ngjan zemërimin do t'i cingërit.
 Por të gjitha këto bashkë do t'i mendojmë pastaj: 140
 Tani një anije të zezë¹ të shtyjme në detin hyjnor,
 dhe rremtarë të zgjedhur të mbledhim, e një hekatombë
 brenda të vëmë dhe në të faqebukurën² Kriseidë
 të hipim dhe prijës një nga krerët këshilltarë,
 Ajaksi, Idomeneu apo Odise hyjnor, 145
 apo ti Pelid, tmerr i gjithë burrave
 me flinë mund të zbutësh Largshigjetarin”.
 Egër e pa dhe u përgjigj Akili këmbëshpejtë:
 “Ah, interesaxhi, veshur me paturpësi,
 cili nga akejtë i gatshëm do të bindej nga fjalët e tua 150
 në udhë të dalë a me burra të luftojë trimërisht?
 Se unë nuk erdha që me heshtëmbajtësit trojanë
 këtu të luftoj, të cilët në asgjë nuk më kanë faj;
 se kurrë nuk dolën të na marrin qetë apo kuajt,
 dhe kurrë as në Ftian plisëmadhe e burrë ushqyese³ 155
 s'më rrënuan prodhimet se mes nesh gjenden shumë
 male hijegjatë e deti zhurmëmadh.
 Por ty, o i paturp, të ndoqëm, që të gëzoheshe,
 nder të merrnim për Menelaun dhe për ty, fytyrëqen,
 nga trojanët; dhe për këto nuk shqetësohesh, nuk i përfill. 160
 Dhe tani kërcënon të më marrësh dhuratën,
 për të u mundova shumë e ma dhanë bijtë e akejve.⁴
 Se kurrë baras me ty nuk kam pjesë, kur akejtë
 shkelin ndonjë kala të shumëpopulluar të trojanëve;
 por më të shumtën e luftës së stuhishme 165
 duart e mia e qeverisin, e pastaj po të gjendemi në ndarje,
 pjesa jote shumë e madhe dhe unë të vogël, po të dashur
 sjell në anije kur kthehem i dërmuar nga beteja.
 Por tani në Ftia do të shkoj, se është shumë më mirë
 të kthehem në atdhe mbi anijet zgavroshe,⁵ e s'ndërmend për ty 170

¹ 141. Anija ishte e zezë se trupi ishte lyer me katran, për t'i rezistuar veprimt gjërryes të ujit. εις ἄλα διαν, në detin hyjnor: në këtë rast epiteti διαν, i kthyer në “hyjnor”, sipas traditës, ruan dhe ngjyrimin origjinal: “i ndritshëm”.

² 143. καλλιπάρηον, me faqe të bukura: epitet i bukurisë femërore, thënë edhe për Briseidën (v. 184, 323,346), Leton (XXIV, 607), Helenën (*Odisea*, XV, 123) etj.

³ 155. Naimi vargun “as në Ftian plisëmadhe e burrë ushqyese”, e përkthen: “As në bimërat të Ethisë/ pëllore dhe burramadhe”.

⁴ 162. Shprehje që në thelb është sinonim i *akejve*, por thekson faktin që në luftë shkojnë të rinjtë, kurse etërit pleq qëndrojnë në shtëpi.

⁵ 170. Naimi: “Me anijet kryekthyer...” (të kthehem mbi anijet zgavroshe).

të rri këtu i panderuar e kamje e pasuri të mbledh¹.
 Dhe atij iu përgjigj mbreti burrave Agamemnon:
 “Ikë nëse zemra të shtyn, unë ty vërtet¹
 s’do të të lutem të rrish me mua, pranë meje kam dhe të tjerë
 që do të më nderojnë, dhe mbi të tërë Zeusi i gjithëditur. 175
 Ti më je më i urryeri nga mbretërit hyjnimëkuar²
 se grindjen³ etje ke, betejat edhe luftërat,
 e nëse je kaq i fuqishëm, këtë ta ka dhënë një hyjni.
 Shko në shtëpi me anijet e tua, me shokët e tu
 dhe mbi mirmidonët mbretëro; unë s’të llogarit aspak, 180
 e mërinë tënde shpërfill, por kanosjen time dëgjo:
 Ashtu si më merr Kriseidën Febi Apollon,
 atë me shokë të mi dhe anijen time,
 do ta nis, por do të marr Briseidën faqetrendafile
 duke ardhur unë vetë në çadrën tënde, që të mësosh 185
 se sa më i fortë jam se ty dhe të frikësohet tjetërkush
 të më flasë i barabartë a të më përngajë kur gjendet përballë”.
 Kështu foli dhe u hidhërua Pelidi e zemra
 në gjoksin leshtor i rrihte mëdyshas:
 Të nxirrte shpatën e mprehtë që varej pranë kofshës 190
 dhe t’i shpërndante të gjithë e të therte Atridin,
 apo të qetësonte zemërimin dhe zemrën të përmbante.
 E këto kur vërtiste nëpër mendje e shpirt,
 nga këllëfi shpatën e madhe hiqte, por erdhi Athinaja,
 nga qiejt dërguar nga llërëbardha Herë, 195

¹ 173. Krerët, që ndjekin Agamemnonin janë bashkuar me të me një aleancë të lirë, jo në një raport vasaliteti, dhe mund të tërhiqen nga ajo kur të dëshirojnë.

² 176. Mbretërit thirreshin kështu se besohej që dinjitetin dhe autoritetin e merrnin nga Zeusi. Në përkthimet italisht përdoret forma: *alumni di Zeus*, nxënës, dishepull i Zeusit. Ne preferuam përkthimin e drejtpërdrejt nga Homeri: hyjnimëkuar (ushqyer nga Zeusi).

³ 177. ... *se grindjen* (ἔρις) *etje ke, betejat edhe luftërat*: Erida ka hedhur mollën në dasmën e Peleut me Tetidën, pra të prindërve të Akilit. Kishte të shkruar sipër: ‘Më të bukurës’. Këtë mollë ia shpunë Parit tri hyjneshat: Athinaja, Hera dhe Afërdita, që të gjykonte dhe t’ia jepte më të bukurës. Kjo mollë ishte shkaku i luftës së Trojës. Duke thënë këto, Agamemnoni i kujton Akilit se familja e tij, dhe ai vetë, ka lidhje me fushatën dhe nuk është dorëjashtë, si theksonte më parë. Shënojmë dhe frazën e Pausanias (*Arkadiket*, 25, 6), që thotë: Kur dikush zotërohet nga zemërimi, arkadët e quajnë “εἰρήνην” (eriniin). Këtë mund ta lidhim me atë që arkadët ishin pasardhës të Pellazgut dhe Akili falet më pas te “Zeusi pellazgjik” (XVI, 233). Kjo Eridë mund të rrëfejë “gisht pellazgjik” në fillim të historisë, që përfundoi me luftën akej-trojanë.

që për të dy njëlloj kujdesej e i donte me gjithë shpirt;¹
 i ndenji pas dhe nga flokët e verdhë kapi Peleonin,
 e dukshme vetëm tek ai, askush tjetër s’e shikonte.
 U shtang Akili, u kthye prapa dhe e njohu menjëherë
 Palladë Athinanë; me një shkëlqim tmerrues nëpër sy 200
 duke u kthyer asaj i foli me fjalë fluturake:²
 “Përse erdhe bijë e Zeusit mburojëmbajtës?³
 Të shohësh vallë përdhunën e Atrid Agamemnonit?
 Por të them qartë dhe më ngjan, kjo do të kryhet,
 me këtë fodullëk të pavend, shpejt do të humbasë jetën”. 205
 Dhe hyjneshë Athina sykaltra⁴ atij iu përgjigj:
 “Erdha të të përmbaj zemërimin, po të më dëgjosh,
 nga qielli; më dërgoi hyjneshë Hera llërëbardha,
 që për të dy njëlloj kujdeset e ju do me gjithë shpirt;
 eja, ndale grindjen, me dorë shpatën mos e nxirr. 210
 Po me fjalë po deshe shaje me ç’të të zërë gjuha.
 Dhe si të them e do të bëhet, do të shohësh,
 dhurata të trefishta të paçmuara një ditë do të të japin
 për këtë përdhunë; por na dëgjo, përmbaje zemërimin”.
 Dhe duke iu përgjigjur Akili këmbëshpejtë i tha: 215
 “Fjalës suaj, hyjneshë, është e nevojshme t’i bindem
 dhe pse në zemër fort i mëritur; kjo është më e mira,
 kush hyjnitë i dëgjon dhe ata e dëgjojnë shumë”.
 Foli e mbi dorezën e argjendte mbajti dorën e rëndë
 dhe në këllëf shtyu prapë shpatën e madhe, iu bind 220
 fjalës së Athinasë dhe ajo prapë në Olimp u ngjit

¹ 196. Hera dhe Athinaja duan ta shohin Trojën të shkatërruar nga urrejtja për Paridin, i cili në konkursin e famshëm të bukurisë, i dha çmimin Afërditës, por *Iliada* nuk e njih ose rrëfen se nuk e njih legjendën (XXIV, 30, shënimi).

² 201. ἔπεα πτερόεντα, *fjalë që fluturojnë*: formulë shumë e zakonshme si tek *Iliada* dhe tek *Odisea*, mbështetur në imagjinatën që kur fjala shqiptohet fluturon përmes ajrit nga folësi te dëgjuesi.

³ 202. αἰγιόχοιοσ te Homeri është epitë vetëm i Zeusit, tek autorët e mëvonshëm edhe i Athinasë; fjalë për fjalë do të thotë “që vringëllon mburojën”. Zeusi tundte mburojën për të mbjellë terror mes ushtrive, apo për të mbledhur retë për një shtrëngatë (shën. i botimit *Bur*). Pantazidi e shpjegon si *mbajtës i egjës* (mburojëmbajtës).

⁴ 206. γλαυκῶπις, *me sy të kaltër*, epitët i Athinasë me etimologji të pasigurt dhe interpretime komplekse. Komenti aleksandrinës theksonte se hyjnesha thirrej kështu se kishte sy γλαυκοί, një term që shpreh njëherësh shkëlqimin dhe ngjyrën e kaltër të kulluar.

mes hyjnive, në pallatin e Zeusit mburojëmbajtës.
 Atëherë përsëri Pelidi me fjalë sharake
 iu kthye Atridit pa përmbajtur zemërimin:
 “O sarhosh, syqen¹ dhe me zemër dreri, 225
 kurrë s’u armatose me ushtrinë për luftë,
 as të shkosh në pritë me akejtë më trima
 s’të ka guxuar zemra, kjo të ngjan porsi vdekje!
 Vërtet është më e lehtë në kampin e gjerë të akejve
 t’i rrëmbesh dhuratat atij që sy për sy të flet, 230
 mbret popullngrënës, që urdhëron përmbi të pavlerë,
 ndryshe Atrid kjo padrejtësia jote e fundit do të ishte.
 Por një fjalë të them dhe do të bëj një betim të madh:
 Për këtë skeptër,² i cili kurrë më degë apo gjethe
 s’do të nxjerrë, pasi la trungun atje në male ku u pre 235
 e s’do të lulëzojë më, gjersa përreth ia zhvoshku bronzi
 fletët dhe lëvoren dhe tani bijtë e akejve
 që bëjnë drejtësi e mbajnë nëpër duar, që ligjet
 e Zeusit ruajnë fort; ja ky do të jetë betimi i madh:
 “Do të vijë një ditë kur Akilin do të duan bijtë e akejve 240
 të gjithë; atëherë ti s’do të mundësh dhe pse i pikëllimtë
 t’i ndihësh kur shumë nga dora e burrëvrasësit Hektor
 të bien të vdekur; dhe ty do të të shqyhet zemra
 nga brenga që nuk nderove të parin e akejve”.
 Kështu foli Pelidi dhe përtokë flaku skeptrin 245
 me pafta të arta mbërthyer dhe u ul në vend.
 Nga ana tjetër Atridi u tërbua; mes tyre Nestori³
 fjalëmbël u ngrit, gojëtar i mendjemprehtë i Pilos,
 që më ëmbël se mjalti fjalët i rridhnin nga goja.

¹ 225. Akili e thërret Agamemnonin *κυνώπα*, “fytyrë prej qeni”, më lart në v. 159. Qeni te grekët ishte simbol i pafytyrësisë, i paturpësisë (shih VIII, 423, 483; XI, 362; XIII, 623 etj.); krahasimi me të do këtu të theksojë paturpësinë e mbretit, që shoqërohet me një paburrëri thelbësore, përfaqësuar në përballjen me dreqin. Epiteti u përmendet edhe grave e hyjneshave: Helena e atribuon shumë herë (III, 180; VI, 344; *Odisea* IV, 145); Hefesti ia përmend Afërditës së pabesë (*Odisea* VIII, 319) dhe Agamemnoni Klitemnestrës besëthyesë.

² 234. Skeptri në fjalë nuk i përket Akilit, por është ai që kasneci i vë në dorë atij që ngrihet të flasë në asamble, për të treguar legjitimitetin, karakterin zyrtar, pra autoritetin e ndërhyrjes së tij (shih: II, 279; III, 218; X, 321, 328; XXIII, 566-568).

³ 247. Naimi e karakterizon Nestorin: “U ngrit Nestor fjalëmbël,/ Fjalëvënësi zëbukur”.

Nën të dy breza të njerëzve të vdekshëm¹ 250
 ishin shuar, që lindën e u rritën dikur bashkë me të
 në Pilosin e shenjtë, tani mbretëronte mbi brezin e tretë.
 Dhe atëherë me urtësi mes tyre foli dhe tha:
 “Mjerë, e keqe e madhe pllakosi tokën e akejve!
 Priami sado të ngazëllente dhe të bijtë e Priamit 255
 dhe trojanët e tjerë sado të gëzoheshin në zemër
 këto po të mësonin se qysh u kapët kështu të dy
 të parët e danajve në mendje dhe në armë.
 Dhe dëgjomëni se që të dy jini më të rinj se unë,
 sepse njëherë e një kohë shumë më të fortë se ju 260
 burra kam ndeshur, dhe ata kurrë fjalët s’m’i shpërfillën.
 Burra të tillë as kam parë e asnjëherë s’do të shoh,
 si Piritoonë dhe Drianten,² bari popujsh,³
 dhe Keneun⁴ dhe Eksadin dhe Polifemin barabar me hyjnitë,
 dhe Tezeun, bir i Egjeut, i ngjashëm me të pavdekshmit, 265
 si ata të vdekshëm të pathyer nuk lindën,
 trima të fuqishëm luftonin me trima të fuqishëm,
 me bishat e malit⁵ dhe frikshëm i shfarosën.
 Unë me ta u bashkova nga Pilosi arritur,
 tej, nga një vend i largët, ata vetë më ftuan 270
 e luftova sa munda më mirë. Por me ta askush

¹ 250. Sipas historianit Herodot, tre breza njerëzorë mbulojnë harkun e njëqind vjetëve; kjo do të thotë se Nestori që mbretëron mbi brezin e tretë, duhet të ketë jo më pak se gjashtëdhjetë e gjashtë vjet.

² 263. *Drianti*: një nga prijësit e lapitëve. U shqua për burrërinë në luftën e lapitëve kundër centaurëve. 3 263. *πομπένα λαών*: *bari popujsh*: shprehje nderuese që u atribuohet mbretërve, prijësve, luftëtarëve të vlerave të sprovuara (shih dhe II, 85; V, 144; VI, 214; XVI, 2 etj).

⁴ 264. *Keneu*: ishte mbret i lapitëve, bir i Elatit, at i argonautit Koron (shih: II, 746), gjysh i Leontiut (II, 745), i njohur për luftën e tij kundër centaurëve. Ishte i pacenueshëm nga kundërshtarët e tij dhe përfundimisht u shtyp nga trunjtje pemësh dhe gurë (paraqitje të Keneut në një vazo të lashtë athinase, A134, Muzeu Mbretëror i Brukselit).

⁵ 262-268. Janë lapitët e Thesalisë (cit. II, 740-44); armiqve të tyre, centaurëve, *Iliada* nuk u atribuon pamjen e tyre tradicionale me kokë e gjoks njeriu dhe trupin prej kali.

Nestori i referohet luftës mes lapitëve dhe centaurëve: Peritooi, në dasmën e tij me Ipodamian, kishte ftuar veç miqve dhe centaurët. Ata të eksituar nga vera, u përpoqën të fyejnë nusen dhe gratë e tjera të pranishme. Lindi një betejë e egër mes shokëve të Peritooit, lapitëve dhe centaurëve, këta të fundit dolën të mundur.

Vargu 265 është konsideruar nga shumë studiues si ndërshtënie athinase e shek. VI për të ndërfutur kujtimin e heroit athinas Teze.

s'do të matej nga gjithë të vdekshmit që sot rrojnë mbi tokë;
dhe mendimin më merrnin e fjalën ma dëgjonin,
por edhe ju dëgjomëni se dëgjesa është më e mirë.

As ti, dhe pse i fuqishëm, vajzën mos ia merr, 275
por lërja, gjersa më parë dhurëti ia dhanë bijtë e akejve,
as ti Pelid të mos duash të hahesh me mbretin
sy ndër sy, se kurrë nderim të njëjtë nuk ka me të tjerët
një mbret skeptërmbajtës, që Zeusi i dha lavdi.

Dhe nëse je shumë i fortë, një nënë hyjneshë të lindi, 280
por më i epërm është ai se shumë ka nën urdhër.¹
Atrid, shuaje zemërimin tënd; unë prapë
të lërë mërinë lut Akilin, që është gardh i madh
për gjithë akejtë kundër luftës së keqe”.

Dhe iu përgjigj i fuqishmi Agamemnon e tha: 285
“Po, o plak, të gjitha i the drejt dhe me maturi,
po ky burrë dëshiron të qëndrojë mbi të gjithë,
të gjithë poshtë të na ketë, të sundojë mbi të gjithë,
mbi të gjithë të urdhërojë, por dikush s'do të bindet.

Dhe nëse hyjnitë që rrojnë përjetë e bënë luftëtar, 290
me këtë vallë i dhanë dhe lejen fyerje të vjellë?”
Atje i preu fjalën Akili hyjnor dhe i tha:
“Vërtet do të më quanin frikash dhe të pavlerë
po të ulja kokën në çdo punë tënden, në çdo fjalë që thua;
te të tjerë bëj komandë dhe mua 295
urdhra mos më jep, tani unë nuk do të të dëgjoj.
E një fjalë tjetër do të të them dhe vure ndër mend:
Me ty me duar s'do të luftoj për hir të vajzës,
as me ty as me tjetër, ju ma dhatë dhe ju ma merrni,²
por nga të tjerat ç'kam në anijen e zezë e të shpejtë, 300
asgjë s'mund të më marrësh pa dëshirën time.

¹ 281. Agamemnoni kishte më shumë autoritet e pushtet, jo vetëm si kreu suprem i ekspeditës, por se komandonte në një mbretëri më të gjerë se ajo e Akilit dhe kishte ardhur në Trojë me numrin më të madh të anijeve dhe luftëtarëve se çdokush tjetër.

² 299. Kur një vendim është marrë në asamble (kuvend), përgjegjësia është kolektive, edhe pse më i fuqishmi, si Agamemnoni këtu, ka detyruar vullnetin e tij: kështu Akili dëshiron që gjithë ushtria të dënohet (v. 240-241, 409-410, 309-310). Në këtë mënyrë, rrjedhimet e fyerjes shkaktuar nga Agamemnoni Krisit, kundër mendimit të shfaqur nga gjithë asambleja (v. 22), kishin rënë mbi tërë ushtrinë, e kësajsoj pastrimi kolektiv.

Dhe po të dëshirosh, provoje, ta shohin dhe këta,
shpejt gjaku i zi rreth heshtës do të rrjedhë!”.

Dhe pasi ata të dy u kapën me fjalë grindavece,
u ngritën e mbyllën kuvendin pranë anijeve akease. 305

Pelidi të çadrat dhe anijet me mjeshtri punuar
u tërhoq me Menetiadin¹ dhe shokët e tij;
Atridi atëherë shtyu në det një anije të shpejtë,
zgjodhi njëzet rremtarë e një hekatombë
ngarkoi për hyun, Kriseidën faqebukurën 310

e mori dhe e uli; dhe prijës u ngjit Odisea mendjemprehtë.²
Ata pra, hipën dhe lundronin udhëve ujore,³
dhe Atridi popujt urdhëroi të pastroheshin,⁴
e ata u lanë dhe gjithë lëtyrat i hodhën në det
dhe Apollonit i ofruan hekatomba të përkryera 315

me qe e dhi në cekëtinën e detit shterp;⁵ fjollë-fjollë
ngjitej në qiell era e ciknës me tymin mbështjellë.
Këto gjëra kryenin në kamp; ndërkohë Agamemnoni
s’e braktisi kanosjen, që i lëshoi Akilit më parë,
por thirri Taltibin, thirri dhe Euribatin, 320

¹ 307. *Menetiadi*: biri i Menetit: Patrokli.

² 311. πολύμητις, mendjemprehtë, i shumëditur, shumë i mençur, sipas Fjalorit të Pantazidit. Ndërsa Botimi *Burr*: astuto, *dinak*, *finok*, *dhelparak*; dhe ai i *Einaudit*: l'accorto, i zgjuar i mprehtë, syhapët. Është epiteti më i zakonshëm që shoqëron emrin e Odisesë, gjithnjë bashkëlidhur si një hero i pajisur me inteligjencë të madhe dhe dinakëri, shih dhe Διὶ μῆτιν ἀτάλαντον, “i barabartë me Zeusin në dinakëri”, te II, 169; πολυμήχαν(ε), “shumë i mprehtë”, II, 173; πολύτροπον, “i pasur me dinakëri” në vargun e parë të *Odisesë*, poema që rrefën kthimin e tij (νόστος) nga lufta e Trojës.

³ 312. ὑγρὰ κέλευθα, *rrugë ujore*. sigurisht deti, i brazduar nga anija për të arritur vendmbërritjen e caktuar. Shprehja është e zakonshme tek *Odisea* (III, 71; IV, 842; IX, 252 etj.), ku përshkrime udhëtime në det janë natyrisht më të shumta në numër sesa tek *Iliada*.

⁴ 313-314. Kjo pjesë duhet interpretuar që luftëtarët lahen në det, jo se lahen në tokë dhe pastaj flakin pislleqet në det: shih X, 572-576 dhe Euripidi, *Ifigj*: “deti lan tërë fëlliqësitë e njerëzve”. Pastrimi i gjithë trupit në vend vetëm të duarve para flisë (shih v. 449) gjen justifikimin e tij në dëshirën për t’u çliruar nga murtaja, e konsideruar si ngjitëse.

⁵ 316. ἀτρογέτος, te Homeri është gjithnjë epiteti i detit, përveç në XVII, 425, ku shoqëron αἰθήρ “eterin”. Duke interpretuar si i paqetë, lidhet me foljen τρώω, sflit, kuptohet si mbiemri si “i palodhur”, “në lëvizje të vazhdueshme”. Të tjerë e e bashkëlidhin me foljen τρογάζω, “mbledh fruta” dhe i japin për këtë kuptimin “shterp”, “i pafryt” (deti është kështu në kundërvënje me tokën, që mund ta kultivosh e të japë fruta); të tjerë hipotizojnë një prejardhje nga τροζ “lumi i verës”, prej nga do të ketë kuptimin “i qartë”.

që ishin kasnecë të tij dhe shqytarë besnikë:¹

“Të shkoni në çadrën e Akil Pelidit,
merreni nga dora e silleni Briseidë faqebukurën;
e po nuk e dha, unë vetë do ta marr
me më të shumtë do të vij; dhe drithma do ta zërë”.

325

Kështu tha dhe me kanosje i urdhëroi të iknin.

E ata pa dëshirë shkonin cekëtinës së detit shterp
gjersa arritën në çadrat dhe anijet e mirmidonëve.

E gjetën atë pranë tendës e anijes së zezë

ulur; e sigurisht s’u gëzua duke i parë Akili.

330

Atëherë të dy nga frika dhe nderimi për mbretin

u ndalën e mbetën pa zë dhe nuk po e pyesnin.

Por ai në zemër e kuptoi dhe tha:

“Përshëndetje kasnecë, lajmës të Zeusit e të njerëzve,²

ejani afër, ju s’më kini faj, por Agamemnoni,

335

që ju dërgoi ju të dy për Briseidën, vajzën.

Eja Patrokël hyjnilindur,³ nxirre përjashta vajzën

dhe jepua ta marrin e këta më qofshin dëshmitarë

para hyjnive të stërlumtur e njerëzve të vdekshëm

dhe mbretit të pashpirt, në qëlloftë prapë tjetër herë

340

të më kenë nevojë nga rrënimi i mjerë të shpëtoj

të tjerët; se ai vërtet u marros në zemrën kobzezë

dhe nuk di të shohë bashkë ç’ka përpara, ç’vjen pas,

sesi pranë anijeve mund të luftojnë të shpëtuar akejtë”.

¹ 320-321. I κήρυκες: *kasnecët a lajmëtarët*, shfaqen te Homeri si ndihmës të pushtetit të mbretit, pothuaj si ndërmjetës mes mbretit dhe popullit. Ata thërrasin asamblenë, detyrojnë qetësinë, i japin skeptrin kujt duhet të flasë në kuvende, lozin rolin e dërgatave. Mbanin funksione të rëndësishme edhe në epokat pasardhëse, në rrethe fetare, politike, ushtarake e juridike. Mbahej që Taltibi ishte kryefisi i kasnecëve të Spartës, prej tij merrnin emrin “Taltibiadë” (Herodoti, 7, 134). Të barabartët e magjerioi (gjellëbërës-priiftërinj) dhe fyelltarëve (muzikantë fyelltarë), të rreshtuar në esnafe, përcillnin ofiqin e tyre nga i ati tek i biri (Herodoti 6, 60). Euribati duhet të ishte si Taltibi, një emër i zakonshëm ndër ata që ushtronin ofiqin e kasnecit: në të vërtetë Euribat thirrej dhe kasneci i Odisesë, me origjinë itakase (II, 184; IX, 170; *Odisea*, XIX, 244-248).

² 334. Kasnecët janë *lajmëtarë të Zeusit dhe të njerëzve* se janë në shërbim të mbretëve ‘dishepuj të Zeusit’ (v. 176). Shih VIII, 517, ‘kasnecët e dashur nga Zeusi’. Në epokën e mëvonshme kasnecët janë nën mbrojtjen e Hermesit.

³ 337. Mbiemri *διογενής*, do të thotë ‘pasardhës i Zeusit’, por është përdorur shpesh si në këtë rast më përgjithësisht si ‘hyjnor’, ‘fisnik’, ‘zemërgjerë’; është një epitet që i referohet çdo heroi si i tillë përjashtimisht nga gjenealogjia e tij e veçantë (por sidoqoftë çdo hero rridhte në një mënyrë a tjetër nga një hyjni, kësajoi në fund të fundit nga Zeusi).

Kështu tha dhe Patrokli, iu bind shokut të shtrenjtë, 345
nga çadra jashtë e nxori Briseidë faqebukurën
e dha ta marrin; dhe ata po ktheheshin tek anijet e akejve;
por ajo e pikëlluar shkonte me ta, gruaja; dhe Akili
shpërthyer në vaj rrinte larg shokëve, mënjanë,
në ranishten e detit të thinjur duke parë hapësirën pa fund 350
dhe shumë luste të ëmën duke shtrirë duart:
“Nënë, meqë jetëshkurtër më ke lindur,
lavdi të paktën duhej të më jepte Olimpiasi,
Zeus gjëmimlarti, ndërkaq aspak s’më nderon.
Se vërtet Atridi, fuqimadhi Agamemnon, 355
faqen më nxiu; dhuratën ma rrëmbeu e ma mban ai vetë”.
Kështu foli duke lotuar dhe e dëgjoi nëna e nderuar,¹
që rrinte në thellësi të detit pranë të atit plak,
me ngut u ngjit nga deti i thinjur si mjegull²
e ndenji afër tij që po qante, e përkëdheli 360
me dorë dhe i foli me këto fjalë:
“Biri im, pse qan? Zembrën cila brengë ta goditi?
Fol, mos e fshih nëpër mend, ta dimë që të dy”.
Asaj, rënkimthellë Akili këmbëshpejtë i tha:
“I di, ç’të t’i them propë, kur të gjitha i di? 365
Në Tebë shkuam, në qytetin e shenjtë të Ietionit,³
e rrënuam dhe gjithçka morëm me vete
dhe plaçkën mirë e ndanë mes tyre bijtë e akejve,
për Atridin zgjodhën pjesë faqebukurën Kriseidë.
Por Krisi, prifti i Apollon largshigjetarit, këtu 370
erdhi në anijet e shpejta të akejve kitonëbronztë⁴

¹ 357-358. Me fillimin e luftës së Trojës, Teti ka lënë shtëpinë e të shoqit në Ftia dhe banon në shtëpinë atërore, që gjendej në fund të detit mes Samos dhe Imbrit, për të qenë më afër të birrit: kjo është ngjarja, që duket se spikat me qartësi nga tërësia e pjesëve në të cilët aludohet në njëfarë mënyre në ndejën e kaluar apo të tanishme të Tetit (shih v. 396 etj.; XVIII, 56-60 = 437-441; XIV, 77-79).

² 359. Krahasimi i Tetit me mjegullën, mund të rrëfejë se kur del nga deti ka trajtë mjegulle dhe vetëm kur flet me të birin merr pamje antropomorfe.

³ 366. ... në qytetin e shenjtë të Ietionit: ati i Andromakës, që u vra bashkë me shtatë bijtë nga Akili (VI, 414-428).

⁴ 371. Kitonëbronztë, veshjebronztë: epiteli i zakonshëm për akejtë dhe popuj të tjerë, që sipas arkeologëve nuk do të thotë për koraca të vërteta bronzi, por për koraca prej lëkure apo pëlhure me shtresa të ndryshme, që në pikat më të ekspozuara ndaj shigjetave të armiqve, mbanin pllaka apo rripa bronzi.

të bijën të lironte me shpërblesë të pafund,
 në dorë mbante kurorat e Apollon largshigjetarit
 mbështjellë në skeptrin e artë dhe luste gjithë akejtë,
 por mbi të gjithë dy Atridët urdhëruesit e popujve. 375
 Atëherë të gjithë akejtë e tjerë thirrën e thanë
 të respektojnë priftin dhe të pranohet shpërbleta e ndritshme.
 Vetëm Agamemnonit në zemër kjo s'i pëlqeu, Atridit,
 por e dëbonte me të keqe dhe fjalë të rëndë i tha.
 I zemëruar plaku u kthye prapa; por Apolloni¹ 380
 lutjen atij ia dëgjoi se shumë i dashur ishte për të,
 dhe mbi argejtë hodhi shigjetë të keqe; dhe popujt
 vdisnin njëri mbi tjetrin, fluturonin shigjetat e hut
 ngado në kampin e gjerë të danajve; dhe ne atëherë falltari,²
 që e dinte mirë, na shfaqti vullnetin e Largshigjetarit. 385
 Unë i pari, menjëherë, nxita të zbutnim hyun;
 por mëria atëherë zotëroi Atrionin³ dhe u ngrit në çast
 e lëshoi një kanosje, që tashmë është kryer.
 Dhe akejtë syxixëllues atë me anije të shpejtë
 në Krisë e shoqëruan, blatime i shpunë hyut; 390
 po dhe kasnecët ikën duke marrë nga çadra rioshen,
 vajzën e Briseut, që më dhuruan bijtë e akejve.
 Por ti në mundsh, sigurisht, mbroje birin tënd;
 ngjitu në Olimp dhe lutju Zeusit, nëse ndonjëherë
 zemrën i ke kënaqur Zeusit me fjalë a me vepër. 395
 Se shpesh në pallatin e atit tim të dëgjova
 të lëvdoheshe se Kronionin⁴ rezezë
 e vetme mes të pavdekshmëve e shpëtove nga turpi i pacipë

¹ 380. Realisht përbën një habi për lexuesin sesi *Akili* e di që Krisi iu lut Apollonit të rrënojë akejtë. Dhe këtë e bëri kur ishte larg anijeve të akejve...

² 384. ... falltari: Kalkanti.

³ 387. Atrioni, Atridi, biri i Atreut.

⁴ 397. *κλεινεφέϊ Κρονίωνν: Κρονίωνν* (Kronioni) dhe *Κρονιδης* (Kronidi), *i biri i Kronit*, emërojnë gjithmonë vetëm Zeusin, megjithëse Kroni kishte dhe bij të tjerë. Zeusi thirrej *κλεινεφής*, rembledhës (fjalë për fjalë: “i reve të zeza”), sepse besohej që mbikëqyrte kohën atmosferike dhe në veçanti shiun dhe shtrëngatat. Një epitete tjetër i formuluar me këtë kuptim është *νεφεληγερέτα* (fjalë për fjalë “mbledhës resh”). Ai ka dhe epitete të tjera si zotëria i rrufeve dhe i gjëmimeve. Mbi rrufetë e Zeusit gjatë betejave, shih VIII, 75 etj., 130-136; XVII, 593-596 dhe shënimin te X, 8.

atëherë kur donin ta lidhnin olimpiasit e tjerë,
 Hera me Poseidonin dhe Athina Pallada;¹ 400
 por erdhe ti, hyjneshë, dhe e çlirove nga prangat,
 menjëherë Ekatonkirin² thirre në Olimpjin e madh,
 që hyjnitë e quajnë Briare,³ por të gjithë njerëzit
 Egeon, që në forcë ia kalon dhe të atit,
 ndenji pranë Kronionit krekosur për lavdinë e vet; 405
 atij iu trembën hyjnitë e lumtur dhe s'e lidhën.⁴
 Kur t'ia kujtosh këto, ulu pranë dhe zëri gjunjët,⁵

¹ 400. Dikur u bë një komplot kundër sundimit të Zeusit (*Hyjnë, të birë e Motit*, përkthen Nairni) mes Olimpjasve të tjerë, ku morën pjesë Athinaja, Hera dhe Poseidoni. Donin ta lidhnin Zeusin, por Oqeanida Teti e liron dhe solli *Ekatonkirin* (Njëqinduarshin), i cili i doli në mbrojtje. Tek *Iliada*, janë prapë këta të tre, që mbrojnë dhe ndihmojnë akejtë, në të kundërt me Zeusin, i cili mbron dhe ndihmon trojanët.

Pallada, epiteti i Athinasë që në përgjithësi kuptohet si heshtëvringëlluese, pra lidhur me funksionin e saj si hyjneshë e luftës; përkundër duket që kuptimi original ishte ai i “vajzës” ose dhe i “zonjës”, si shthurje e termit semitik *ba'alat*.

Zeusi dhe Poseidoni ishin përplasur duke dashur të dy të martoheshin me Tetidën, por kur hyjneshja Temis u tha se i biri i tyre do të ishte më i fuqishëm se i ati, vendosën të mos këmbëngulnin. Pastaj Teti u martua me Peleun dhe lindi Akilin.

² 402. *Ekatonkiri*: Njëqinduarshi (it. Ecatonchiri = Centimani).

³ 403-404. Mes korintasve, *Briareu*, konsiderohet si rregullues i grindjes mes Poseidonit dhe Heliosit, që u ndau këtyre të dyve tokën e Korintit. Poseidonit i dha Istmin dhe krahinat përreth, dhe Heliosit i dha lartësinë mbi qytet (Akrokorintin: Pausania, *Korintiaket*, 1, 6). Këtu shohim se vetë Briareu ka mbrojtur sundimin e Zeusit, pas ftesës së Tetidës.

Egeoni ishte bir i Geas dhe i Pontit (*Homeriket*, Titanomahia 3); Mal i madh i Egeonit, jo larg nga Fringia (*Argonautiket*, 1, 1165); Dhe në dallgët ku banojnë hyjnitë e detit, Egeoni, ku duart e tij madhështore përqafojnë balenat. Por edhe te Hesiodi (*Teogonia*), ku përmendet se Rea fshehu Zeusin e vogël në malin Egeon.

Nuk janë të pakta pjesët në letërsinë greke, ku aludohet për një gjuhë të veçantë të hyjnive nga ajo e njerëzve. Vetëm tek *Iliada*, II, 813, një kodër e njohur nga njerëzit me emrin “Baticia”, thirret nga hyjnitë “varri i Mirinës së shkathët”; XIV, 290. Ku një zog për hyjnitë është *kalkis* dhe për njerëzit *kymindis* etj. Në rastin tonë, Briare sugjeron idenë e forcës; i dyti, Egeon, në përgjithësi lidhet me detin Egje e me hyun e detit Poseidon, ngaqë dhe ai është Egeon... Duket që sipas Homerit ai është bir i Poseidonit, megjithatë kontrastin plani për të shfronësuar Zeusin mbështetur në forcën e tij fizike. Është një interpretim që lë hapësirë e ngjall habi se te Hesiodi, përkundër Briareu, është bir i Uranit dhe Geas, dhe lufton përkrah hyjnive olimpikë kundër Titanëve dhe si shpërblim merr për grua Kimopolean, bijën e Poseidonit...

⁴ 406. Është një episod i panjohur i këtyre luftrave ndër hyjnitë për pushtet, që lulëzojnë tek *Iliada*, ku, sundimi i Zeusit, duket i konsoliduar. *Briareu*, si dhe përbindësja të tjerë me njëqind duar, kishin ndihmuar Zeusin edhe në luftën kundër Titanëve.

⁵ 407. Ishte zakon që lutësi shtrirë, me të majtën i rrokte gjunjët personit, të cilit i drejtohej lutja, ndërsa zgjaste dorën e djathtë për të prekur mjekrën.

ndofta ai dëshiron ndihmës t'u bëhet trojanëve,
 ndërsa të tjerët, akejtë, pranë kiçeve buzë detit t'i strukë,¹
 të gjakosur, që mbretin e tyre ta gëzojnë të gjithë. 410
 Të kuptojë dhe i biri i Atreut, i pushtetshmi Agamemnon²
 verbërinë e tij që s'e nderoi të parin e akejve".
 Iu përgjigj atëherë Teti duke derdhur lot:
 "Ah, biri im, përse të linda e të rrita, nënëzeza?
 Të ndodhte pranë anijeve pa lot e pa dhimbje 415
 të rrije gjersa jetë të shkurtër paske, jo të gjatë.
 Por tani bashkë vdekjeshpejtë e më i mjerë nga të gjithë
 qenke; me fat të lig të linda në pallat.
 Dhe këtë fjalë për ty do t'ia them Zeusit rrufedashës,
 në Olimpën borëmbuluar vetë do të shkjoj, ndofta më dëgjon. 420
 Por ti tani duke qëndruar tek anijet që rrugëtojnë shpejt
 mërihu me akejtë dhe luftën ndërprite krejt,
 se Zeusi tek Oqeani dhe etiopët patëmetë³
 i ftuar në tryezë shkoi dje dhe të gjithë hyjnitë e ndoqën.
 Në të dymbëdhjetën⁴ prapë do të kthehet në Olimp, 425
 atëherë për ty do të shkjoj në shtëpinë pragbronztë të Zeusit,⁵
 t'i bie në gjunjë dhe shpresoj që ta bind".

¹ 409. Në thelb edhe *Akili* kërkon shkatërrimin e akejve.

² 411. Përsëritet se ai dhe vetëm ai është më i miri i akejve. Ngaqë nuk ia njohu Agamemnoni, i kërkon së ëmës, që t'i lutet Zeusit që të rrënojë gjithë popullin. Që të... mësojnë! Kjo tregon se thirri kuvendin e akejve për shkak të murtajes, vetë ai nuk ka qëllim tjetër veçse *njohjen e tij si prijës*, të paktën në sytë e luftëtarëve...

³ 423. Oqeani ishte konceptuar si një lumë që rridhte e gjithi rreth diskut të rrafshët të tokës. Shënonte, pra, kufirin si në lindje e në perëndim, në jug si në veri. Dorë pas dore që zgjeroheshin njohuritë gjeografike, ky emër iu rezervua Oqeanit Atlantik, kufirit të botës në perëndim. Tek *Odisea* (I, 22 etj.), etiopët janë vendosur në dy zona të ndryshme, në brigjet e kundërta të Oqeanit, njëra në lindje, tjetra në perëndim. Është një popull mitik, që për dhëmbshurinë e tij është vizituar shpesh nga hyjnitë (shih XXIII, 295-20; *Odisea*, V, 282). Identifikimi i etiopëve me popullin që banon në jug të Egjiptit, nuk është dokumentuar me siguri para shek. VI (shih Hekateu, *FgrHist* I F 325-328).

Këto *udhëtime të hyjnive* pranë etiopëve të largët (edhe XXIII, 206 dhe *Odisea*, I, 22) i shërbejnë poetit si mjet i rehatshëm për të larguar hyjnitë nga skena kur prania e tyre nuk është e kënaqshme, herë të tjera hyjnitë "nuk shikojnë" ose "shohin gjetkë".

⁴ v. 425. Në ditën e dymbëdhjetë.

⁵ v. 426. Διὸς ποτὶ χαλκοβατῆς δῶ, në *shtëpinë me truall të bronzit të Zeusit*: nuk ka dëshmi arkeologjike të dyshemeve të bronzta. Formula χαλκοβατῆς δῶ, gjithnjë referuar një banese hyjnore, dhe një herë edhe pallatit të Alkinoit (*Odisea*, XIII, 4), do të theksojë shkëlqimin dhe madhësitinë; shih dhe χάλκεος οὐδός, "pragu i bronzit" (VIII, 15). Shënimi është i botimit *Bur*, ne preferuam variantin e dytë, *pragbronzitë*, sipas përkthimeve të tjera.

Kështu foli dhe u ngrit e iku dhe e la atje
të zemëruar përbrenda për gruan brezbukur,¹
që me dhunë ia rrëmbyen. Ndërkaq Odisea 430
arriti në Krisë duke sjellë hekatombën e shenjtë.
Ata, pra, kur arritën brenda limanit shumë të thellë,
mblodhën velat dhe i vendosën në anijen e zezë,
direkun shtynë në mbajtësen e vet duke e zbritur me litarët
me ngut dhe drejt bregëzimit arritën me rrema. 435

Jashtë hodhën gurët e vrimuar² dhe lidhën litarët e kjiçit;
jashtë dolën dhe ata mbi zallishtën detare,
jashtë nxorën dhe hekatombën e largshigjetarit Apollon,
jashtë doli dhe Kriseida nga anija që rrugëton mbi det.
Pastaj pranë altarit e shpuri Odisea mendjemprehtë, 440
në duart e të atit të shtrenjtë e dorëzoi dhe i tha:
“O Kris, më dërgoi kryezoti Atrid Agamemnoni
të të jap bijën dhe Febit hekatombë të shenjtë
t’i flijoj nga danajtë, që të zbusim mbretin,
që tani u dërgon argejve dhimbje me shumë ahte”. 445

Kështu foli dhe në duar ia besoi e ai e priti hareshëm
bijën e shtrenjtë; ata menjëherë hekatombën e shenjtë të hyut
e vunë në radhë përçark altarit të ndërtuar hijshëm;
duart lanë³ pastaj dhe morën kokrrat e shenjta të elbit.
Dhe për ta zëllartë u lut Krisi duke ngritur duart: 450
“Dëgjomë Harkargjend, që mbron Krisën
e Killën hyjnore dhe je zot në Tenedo;
dhe herë tjetër më parë më dëgjove lutjen,
më nderove dhe shumë e dëmtove popullin e akejve,
kështu prapë përmbushmë këtë dëshirë: 455
Dëboje tani nga danajtë shkatërrimin poshtërues”.
Kështu foli duke u lutur dhe e dëgjoi Feb Apolloni.

¹ 429. ἐυζώνιο, *me brez të bukur, brez bukur*, epitet që shënon elegancën dhe zhdërvjelltësinë e trupit femëror.

² 436. Spirancë.

³ 449. Një akt pastrimi para se t’i kryenin flijimin Apollonit.

Kur u falën dhe hodhën kokrrat e shenjta të elbit,¹
 kthyen pas qafat e kafshëve në fillim, i therën, i rropën,
 prenë kofshët, i mbuluan me shtresë dhjami 460
 të dyfishtë dhe përsipër vunë copëra mishi të njomë;
 mbi bujashka i digjte plaku e përsipër me verë të ndritshme
 i spërkaste; të rinjtë rreth tij pesëhejeshe mbanin në duar.
 Dhe kur u dogjën kofshët e të përbrendshmet shijuan,
 pjesën tjetër e copëtuan, i shkuan në heje 465
 e pasi i poqën mirë e mirë të gjitha i hoqën nga zjarri.
 E kur mbaruan punë dhe përgatitën tryezën,
 po hanin dhe askujt s'i mungonte pjesa e barabartë.
 Pastaj kur hëngrën e pinë sa u desh zemra,
 të rinjtë kurorezuan me verë kraterët,² 470
 të gjithëve u ndanë nëpër kupa, të pikonin verë.
 Dhe tërë ditën me këngë e valle falje i kërkonin hyut
 duke ia marrë një peanë³ të bukur djemtë e akejve,
 nderonin Largshigjetarin; dëgjonte ai e zemra i ngazëllehej.
 Kur dielli perëndoi dhe erdhi poshtë errësira, 475

¹ 458-468. Janë përshkruar fazat kryesore të flijimit të kafshës, dmth. therja e një preje me një gosti vijuese. Pasi kafsha theret, i digjen kofshët, apo me siguri kokcat e kofshës mbështjellë me një shtresë dhjami (shih Hesiodi, *Teog.*, 556 etj.); mbi to janë vënë pjesë të vogla të çdo pjesë tjetër me qëllim që të formohej simbolikisht qenia e prerë dhe për t'ia ofruar hyut. Njëherësh bëhet dhe një libacion, pra i ofrohej hyjnisë dhe një sasi e vogël vere duke e derdhur me cirka mbi zjarr (shih v. 463 λειόμε, libonte, shih dhe shënimin te v. 470-471); rrethi më i ngushtë i shërbenjesve fetarë ka privilegjin të hajë të brendshmet e flisë, që janë të parat që piqen. Pastaj piqen në prush pjesët e mbetura të destinuara për gostinë, ku marrin pjesë gjithë të pranishmit. Oferta paraprake e kokrrave të elbit gjen një shpjegim në dëshirën për të përfshirë në ofertën hyjnisë edhe elemente të botës bimore, shih dhe II, 421 etj.

² 470-471. I mbushën me verë gjer në grykë.

Krateri është një vazo ku përzihej uji me verë dhe pastaj mbusheshin kupat.

Aludohet për serinë e akteve tradicionale me të cilat ishte rregulluar pirja e verës: 1) sakët "libojnë" (derdhin) ndonjë pikë në kupën e çdo gostiari; 2) gostiarët bëjnë libacione duke derdhur përtokë me formula lutjeje këtë pjesë të parë të verës; 3) sakët mbushin kupat e gostiarëve; 4) gostiarët pinë sipas dëshirës. Duhet kujtuar se vera nuk konsumohej e pastër, por e përzier me ujë, sipas përpjesëtimesh, që variojnë në kohë dhe sipas vendeve: Hesiodi, p.sh., rekomandon një përzierje të tri pjesëve me verë, me një pjesë ujë (*Op.* 596).

³ 473. παιήονα, *peana*: këngë që në origjinë mbase i kushtohej Peonit, që te Homeri shfaqet si mjek i hyjnive (shih p.sh. V, 401), dhe në vijim u identifikua me Apollon. Karakterizuar nga epifonema (*frazëz proverbiale dhe emfatike në mbyllje të një kuvendimi*) τῆ τῆ παιάων, përgjithësi lidhej me kultin e Apollon, si në këtë rast, por mund t'u drejtohej dhe hyjnive të tjerë (Artemidës, Asklepit, Poseidonit etj.) për të kërkuar ndihmë a për t'i falënderuar për një rrezik të kapërcyer.

atëherë pranë pallamarëve të biçit të anijes fjetën;
dhe kur u shfaq mëngjeslindura Eos gishtrëndafila,¹
atëherë u nisën drejt kampit të gjerë të akejve;
erë të mbarë u dërgoi Largshigjetari Apollon;
dhe ata lartësuan direkun, shpalosën pëlhurat e bardha, 480
era frynte në mes velën e përreth dallga
e shkumëzuar në kallumë fort ulërinte teksa anija udhëtonte;
vraponte ajo përmbi valë duke kryer rrugëtumin.
Por kur arritën te kampi i gjerë i akejve
anijen e zezë e tërhoqën në bregun e thatë, 485
lart, mbi rërë, dhe poshtë trarë të gjatë i vunë
dhe u shpërndanë nëpër çadra dhe anije.
Por i mëritur qëndronte në anijet rrugëshpejta
hyjnilinduri bir i Peleut, Akili këmbëshpejtë;
kurrë në kuvend, lavdi e burrave, nuk shkonte, 490
as në luftë kurrë, veç i brente zemrën brenga
që rrinte, ndonëse dëshironte britmën dhe betejën.
Po kur arriti agimi i dymbëdhjetë pas kësaj dite,²
atëherë për në Olimp u nisën hyjnitë e përjetshëm
të gjithë bashkë, në krye Zeusi; dhe Teti s'harroi lutjen 495
e të birit, nga dallga e detit u shkridh
dhe e mjegullt u ngjit në qiellin e madh, në Olimp;
gjeti Kronid zëgjëmimin ndenjor mënjanë të tjerëve
në majën më të lartë të Olimpit me shumë kreshta;
u ul përpara tij dhe i zuri gjunjët 500
me të majtën dhe me të djathtën e çiku nën mjekër,
e foli duke lutur mbret Zeus Kronionin:
“Zeus at, nëse të ndiha ndonjëherë mes të pavdekshmëve
me fjalë a me vepër, më kryej këtë dëshirë:
Nderoje tim bir, që më vdekëshpejtë nga të tjerët 505
ka lindur; por atë tani mbreti i burrave Agamemnoni,
e çnderoi, i mori e i mban dhuratën vetë duke e rrëmbyer.
Por ti nderoje, Zeus Olimpiasi mendar;

¹ 477. ῥοδοδάκτυλος Ἥως, *Agimja me gishtat e trëndafilla*: rrezet e dritës që përhapen në agim, ngjyra e të cilave të kujton atë të trëndafilave, janë krahasuar me gishtat e një dore të hapur, e kësajsoj të përfytyruar si gishta të trëndafilte të vetë hyjneshës, që personifikon agimin.

² 493. Pas asaj dite kur Teti takoi Akilin (shih v. 423-425).

trojanëve jepu forcë gjersa akejtë
 birit tim t'i shlyejnë nderin, që i kanë borxh". 510
 Kështu foli, por asaj s'i tha asgjë Zeus rembledhësi,
 i heshtur rrinte gjatë dhe Teti si i përqafoi gjunjët,
 u shtrëngua në to dhe e luti edhe një herë:
 "Jepmë premtim të vërtetë dhe bëj shenjë,
 apo mos prano, gjersa i patrembur je, që ta di mirë 515
 sesa mes të gjithëve jam hyjneshë e përbuzur".
 Atëherë shumë i inatosur i tha Zeus rembledhësi:
 "Ah, punë e mallkuar! Do të më bësh të grindem
 me Herën, kur të më thumbojë me fjalë sharake;
 ajo me mua gjithnjë mes hyjnive të pavdekshëm 520
 shamaton e më thotë se trojanët ndih në luftë.
 Por ti tani largohu, mos ndien ndonjë gjë
 Hera: unë të gjitha do t'i mendoj gjersa t'i kryej;
 do të bëj shenjë me kokë që të besosh,
 se kjo është mes të pavdekshmëve më e madhja 525
 shenjë; se s'kthehet më pas, s'mund të mashtrojë,
 e pakryer s'mbetet, çka unë premtoj me shenjën e kokës".
 Foli dhe me vetullat e zeza bëri shenjë Kronioni;
 flokët e ambroztë¹ të mbretit u pështjelluan
 mbi kryet e pavdekshme dhe Olimpën e madh lëkund. 530

¹ 529. Mbiemri ἀμβρόσια, e ambroztë, "e përjetshme", "e pavdekshme", i referohet gjithçkaje që lidhet me hyjnitë: përveç flokëve, "shigjetat e ndritshme ... hyjnore të Herës" (XIV, 176 etj.), kënga (Hesiodi, Teog. 60), si dhe objektet me të cilat veprojnë, rroba, sandale, melhemet (V, 338; XIV, 172; XXI, 507; XXIV, 340 etj.). Prej saj rrjedh emri ἀμβροσία "pavdekësia", që në përgjithësi rrëfen ushqimin e hyjnive, ndërsa νέκταρ "nektari" (që në epikë zakonisht e shoqëron), është pija e tyre (shih XIX, 347, 353; Odisea, V, 93, Hesiodi, Teog. 640, 796). Ky dallim nuk paraqitet njëkuptimësh në gjithë burimet antike: nganjëherë ambrozi kuptohet si vetë pija (Safo, fr. 141, 1 Voight), ndërsa nektari si ushqim (Alkmani, fr. 42, Page...). Të gëlltitura nga një qenie njerëzore, i japin pavdekësinë (Pindari, Ol., 1, 60 etj.), ndërsa kufomën e një të vdekuri e ruajnë nga dekompozimi (XIX, 38). Ambrozi në veçanti njihet përdorime të tjera, veç atij si ushqim: si melhem (XVI, 670, XXIII, 186 etj.), si kozmetikë (XIV, 170), si parfum (Odisea IV, 445), si tagji për kuajt hyjnorë (V, 369, 777). Si përdorimet e caktuara dhe këmbimet ambroz-nektar, kanë shpënë kritikën moderne që të ofrojnë këtë barazim si "mjaltë". Sipas traditës antike, mjalti kishte rënë nga qielli dhe i jepeshin të njëjta karakteristika ëmbëlsie e dëshirimi si dhe ushqimit hyjnor. Ndërsa ἀμβρόσιος dhe ἀμβροσία janë fjalë greke me formim të qartë, për nektarin nuk mund të jepet një etimologji e saktë; duhet të bëhet fjalë për një fjalë që do të thotë "i parfumuar", marrë nga semitikja sipas S. Levin-it; apo nga një term me origjinë nga Azia e Vogël, që ka në bazë një element shprehës "hy", nga i cili ambrozi duket jo vetëm sinonimi, por edhe përkthimi grek, sipas P. Kretschmer...

Të dy pasi vendosën u ndanë; ajo pastaj
 kërceu në detin e thellë nga Olimpi gjithë rrëzëllime;
 Zeusi shkoi në shtëpinë e tij; hyjnitë gjithë bashkë u ngritën
 nga fronet përballë atit të tyre; askush nuk guxoi
 të rrijë ulur tek vinte, por të tërë në këmbë e prisnin. 535
 Atëherë mbi fron ai u ul; por syrit të Herës
 s' i kishte shpëtuar që pa se foli me të,
 Tetin këmbë argjendta,¹ bijë e plakut të detit.
 Iu kthye shpejt Zeus Kronionit me fjalë therëse:
 “Kush nga hyjnitë, mendje dinak, me ty u këshillua? 540
 Gjithnjë ty të pëlqen ndenjmur mënjandë larg meje
 të mendosh fshehtas, vendime të marrësh dhe kurrë
 atë që ke vënë ndër mend s'ke dashur të ma thuash”.
 Asaj iu përgjigj pastaj ati i hyjnive e i njerëzve:²
 “Hera, mos shpresë që gjithë mendimet e mia 545
 t'i dish. E vështirë dhe për ty, ndonëse më je shoqe shtrati.
 Por çka është me vend të dëgjosh, askush,
 as hyjni, do ta mësojë para teje, asnjeri;
 dhe cilin veçmas nga hyjnitë unë ndërmendem,
 ti mos pyet hollësitë dhe mos kërko të rrëmosh”. 550
 Atij iu përgjigj pastaj e respektuara Herë symëshqerra:³
 “Kronid i tmerrshëm, ç'fjalë the?
 Ka kohë sigurisht që as pyes as rrëmoj,

¹ 538. ἀργυρόπεζα, *këmbë argjendta*, epiteti i Tetit (XVI, 574; XVIII, 127, 146 etj.). Kjo gjen shpjegimin e vet në faktin që Teti është hyjni detare, këmbët e saj janë të argjendta, dmth. të bardha dhe përshkënditëse, ashtu siç është e tillë shkuma e detit në të cilën shfaqen duke u kredhur kur hyjnesha del nga ujërat në afërsi të ranishtes. Në të vërtetë Pindari këtë epitet ia atribuon Afërditës, hyjneshës së lindur nga shkuma e detit dhe Bakilidi lidhur me Nereidet, motra të Tetit, afirmonte që “përshkënditje pothuaj si flakë ndriste nga gjymtyrët shkëlqimtarë” (*Dit.* 17, 103-105).

² 544. ... *ati i hyjnive dhe i njerëzve*: shprehje e përdorur tek *Iliada* për të treguar Zeusin, dhe për më shumë si pohim i epërsisë së tij mbi gjithë qeniet hyjnore dhe njerëzore.

³ 551. βωῶπις, *me sy kau*, epiteti i Herës, vetëm në dy raste u referohet grave të vdekshme (III, 144; VII, 10). Sipas komentit përkatës, është një epitet i thjeshtë i bukurisë, me qëllim që të theksojë sytë e mëdhenj; nga studiuesit modernë është hamendësuar se bëhet fjalë për një relik të një kulturi antik teriomorf (në fetë politeiste: *hyjnitë e përfitruara në formë apo karaktere kafshësh*), baras me γλαυκῶπις, *me sy të kaltër* (shih shënimin te v. 206). Afërmendsh që ky ngjyrim semantik nuk hamendësohet kur epiteti nuk i referohet një hyjneshe, por një gruaje: në të dyja rastet e cituara (III, 144; VII, 10), prandaj është përkthyer me shprehjen “me sytë e mëdhenj”. Por ne preferuam origjinalin, nga “sy kau” në “symëshqerra”.

por moskokëçarës mendo çfarë të duash.
 Tani frikësohem në zemër me tmerr mos të ka joshur 555
 këmbargjenda Teti, bija e plakut të detit.
 Në agim të ndenji pranë, të zuri gjunjët.
 Asaj, dyshoj, i ke dhënë shenjë të pagabueshme që Akilin
 do të nderosh, do të rrënosh shumë akej ndanë anijeve”.
 Asaj duke iu përgjigjur foli Zeus rembledhësi: 560
 “Oh, shpirtzezë, gjithnjë dyshon dhe kurrë s’të shpëtoj;
 megjithatë asgjë s’do të mundesh; përkundër larg zemrës
 më shumë do të të kem dhe do të jetë më e hidhur për ty.
 Nëse gjërat janë kështu, do të thotë më pëlqen kësisoj.
 Por rri e mos fol dhe bindju fjalës sime, 565
 se mos s’të ndihni dot gjithë sa hyjni janë në Olimp
 kur të të vij pranë dhe mbi ty të shtrij duart e pathyera”.¹
 Kështu tha e u tremb e respektuara Herë symëshqerra
 dhe e heshtur rrinte duke shtrënguar zemrën.
 U hidhëruan edhe hyjnitë qiellorë në banesën Zeusit, 570
 por Hefesti, mjeshtri i famshëm, filloi të flasë mes tyre,
 duke ëmbëlsuar të ëmën, Herën llërëbardhë:
 “Ah, punë e mbrapshtë dhe e padurueshme
 nëse ju të dy grindeni kështu për të vdekshmit,
 do të sillni trazirë mes hyjnive; as tryezën e ndritshme 575
 do të gëzojmë, gjersa fiton më e keqja.
 Nënës sime i jap një këshillë, që e kupton edhe vetë:
 Atit të shtrenjtë Zeus t’i sillt ëmbël, që të mos
 mërihet prapë ati dhe tryezën na e bën rrëmujë.
 Se po të donte rrufehedhësi Olimpias² 580
 nga fronet do të na flakte, se është vërtet më i forti.
 Por ti me fjalë të buta merre me të mirë
 dhe atëherë dashamir do të jetë shpejt Olimpiasi me ne”.

¹ 567. Hyjnitë homerikë janë madhështorë kur shfryjnë kundër njerëzve; mes tyre luftojnë si njerëzit, por me ndryshimin se ata nuk mund të arrijnë në skaj, duke qenë të pavdekshëm, e kësisoj duhet të kufizohen në kanosje dhe sharje, duke marrë pamjen e mburravecëve të paaftë.

² 580. Olimpiasi, Zeusi që ka ndejnë në Olimp dhe është sovran. Por thirren kësisoj edhe hyjnitë e tjerë, që banojnë në këtë vend: shih p.sh.: XX, 47.

- Kështu tha dhe duke çaluar një kupë dyshe¹
i vuri në dorë të ëmës së shtrenjtë e i thotë: 585
“Durim, nëna ime, dhe përmbaju, ndonëse e hidhëruar,
mos ndodhtë dhe pse e shtrenjtë më je, të të shoh me sy
të rrihesh, e atëherë s’do të mund, dhe pse i pikëlluar
të të mbroj, se i frikshëm është Olimpiasi me kë përballet.
Se dhe një herë tjetër kur doja të të mbroja, 590
nga këmba më rrëmbeu e më flaku nga pragu hyjnor
dhe gjithë ditën bija, por me perëndimin e diellit
u rrëzova në Lemnos, me shpirt ndër dhëmbë.
Atje burra sintë u kujdesën sapo rashë”.²
Kështu tha dhe vuri buzën në gaz Hera llërëbardha 595
dhe duke buzëqeshur nga dora e djalit mori kupën;
edhe gjithë hyjnive të tjerë nga e djathta ai³
u mbushte nektar të ëmbël zbrazur nga krateri.
Një e qeshur e pashuar krisi mes hyjnive të pavdekshëm⁴
kur panë Hefestën të gulçonte nëpër shtëpi. 600
Dhe gjithë ditën gjer të perëndonte dielli
hanin dhe askujt nuk i mungonte pjesa e barabartë,

¹ 584. Hefesti është i çalë se është një farkëtar; në komunitetin primitiv, kur nuk ekzistonte ende ndarja e punës, specialistët e parë bëheshin të tillë se ishin të paktë. Kush nuk mund të gjuante, ose të punonte me shat ose të luftonte, bënte farkëtarin; siç është tradicionale edhe figura e këngëtarit të verbër.

² 590-594. Një aludim i po këtij episodi në shek. XV, 18-24. Edhe pse teksti homerik nuk e qartëson, ky version i mitit duhet të vendosë në raport rënien rrënimtare të hyut me çalimin e tij. Një version i ndryshëm i rënies së Hefestit nga Olimpi është rrëfyer në shek. XVIII, 395-405: nëna Herë e hodhi për shkak të deformimit të tij dhe ai u prit nga Eurinomi e Teti në gji të detit. Lemnosi është një ishull i karakterizuar nga fenomene të mëdha vullkanike, prandaj mbahej i shenjtëruar Hefestit, hyut të zjarrit dhe ishte një nga ndejet më të rëndësishme të kultit të tij. Sintët ishin, sipas mitit, banorët më të vjetër të tij, para se ishulli të kolonizohej nga grekët. Tek *Odisea* VIII, 294, quhen *αγρόφωνοι*, pra “folës të një gjuhe të palatuar” (*gjuhë barbare*), si të tillë të konceptuar si primitivë. Tek *Iliada*, ku hyjnitë, shmangin arrijten në dhunën e skajshme (cit., sipër në v. 567), atentate të tilla shfaqen vetëm në kujtimet e tyre të së shkuarës, ose në kanosjet, që shkëmbejnë mes njëri-tjetrit.

³ 597-598. Nektari mbushje një krater qendror dhe u ndahej të pranishmëve në analogji me çfarë bëhej me verën në gostitë e njerëzve. Hidhej nga e majta në të djathtë se ky ishte drejtimi i konsideruar ogurmbarë.

⁴ 599. Kupëmbajtësit (sakët) e hyjnive janë Ebeja dhe Ganimedi, të përkujtuar për bukurinë dhe elegancën e tyre. Por kjo skenë me hyun e çalë që bën punën e sakut, paraqet një parodi të gostive të zakonshme hyjnore.

as qestja¹ sublime që i binte Apolloni,
 as Muzat që këndonin me radhë zëëmbël.
 Pastaj kur u fsheh rrezja e ndritshme e diellit, 605
 ata shkuan të flinin, gjithkush në shtëpinë e tij,
 që secilit Çalamani² i dëgjuar
 banesë i kishte bërë, Hefesti me mendjen e ditur.
 Edhe Zeusi shkoi në shtrat, Olimpiasi rrufehedhës,
 ku fle gjithnjë kur e merr gjumi i ëmbël, 610
 atje u ngjit e u shtri dhe pranë Hera fronarta.³

¹ 603-604. Interpretimi i kësaj pjese nuk është njëkuptimësh: sipas disave, Muzat, të shoqëruara nga φόρμιγγς e Apollos, këndonin një sërë monodish, të rilidhura njëra me tjetrën, ashtu si bënin aedët në festa. Sipas një interpretimi tjetër, që mbështetet nga përballja me pjesë të tjera, si p.sh.: te XXIV, 720-722 (vajtimi funebër për Hektorin), mund të përfytyrohet që Apolloja këndon fillimthi dhe kori i Muzave i përgjigjet çdoherë këngës së tij me një refren. φόρμιγγς-i që gjejmë në duar të Apollonit, ishte instrumenti i aedëve antikë. Bëhet fjalë për një tip të lirës primitive, apo më saktë, të një qesteje primitive. Mund të kishte tri deri pesë korda, por zakonisht kishte katër. Arti gjeometrik na ka lënë pasqyrimë të mira.

Qeste, vegël muzikore me tela, e ngjashme me lirën (kitarë).

² 607. Për Hefestin ekziston një mit se e lindi Hera vetë, pa Zeusin. Por këto fraza këtu rrëfejnë se Hefesti e konsideron Zeusin at, ashtu si dhe fëmijët e tjerë të tij.

ἀμφιγυήεις epitet i Hefestit te Homeri dhe Hesiodi, kuptimi i të cilit ende diskutohet. Shënimet dhe leksikografët kuptojnë “i gjymtuar”, “çalamani nga të dyja këmbët”; të tjerë si “dydjathtak”, pra i aftë të punojë me të dyja duart. Një interpretim tjetër është “ai që përdor sëpatë të dyfishtë”, referuar sëpatës dytchëshe, me të cilën shpesh është pasqyruar.

³ 611. χρυσόθρονος Ἥρα, *Hera me fron të artë*, shih shënimin te VIII, 565.



Libri i dytë, B

Ëndrra dhe katalogu i anijeve

Hyjnitë e tjerë atëherë dhe heronjtë me përkrenare krifëgjatë¹
 tërë natën flinin, po Zeusin s’e mundte gjumi i ëmbël,
 vetëm ai vërtiste nëpër mend se si Akilin
 ta nderonte e shumë të rrënonte pranë anijeve të akejve.
 Dhe ky iu duk në shpirt mendimi më i bukur, 5
 të dërgojë tek Atrid Agamemnoni Ëndrrën mashtruese;²
 e pasi e thirri i foli me fjalë fluturake:
 “Ngrihu e shko Ëndërr mashtruese tek anijet e shpejta të akejve.
 kur të arrish te çadra e Agamemnon Atridit,

¹ 1. *ἰπποκροῦσταί*, me përkrenare jelegjatë: në kreshtë të përkrenares vendosej si stoli një cul-lufe pak a shumë e gjatë sa jelet e kalit. Fjala greke përbëhet nga dy elemente: *ἵππος*, “kalë”, me referim krifën e kalit, dhe *κροῦσταί*, që do të thotë “pajisur me përkrenare”.

² 6-22. Ëndrra e Agamemnonit hyn në tipologjinë e ëndrrave “objektive”, që është përshkruar më shpesh nga Homeri. Kush fle vizitohet nga një figurë onirike (*ëndërrash*), që ekziston pavarësisht prej tij dhe nuk është krijuar nga mendja e vet. Kjo figurë mund të jetë një hy (*Odisea* VI, 20 etj.), një hije (shih XXIII, 65 etj.), përfytyrimi i rremë i një personi njerëzor, i formuar dhe i dërguar nga hyjnitë për të përcjellë një mesazh (*Odisea* IV, 795). Rasti në shqyrtim është i kategorisë së fundit të renditur më lart, është ndërlikuar më tej nga prania e një hyjnie specifike, Ëndërrës që mashtron, Ëndërrës mashtruese, e cila, dërguar nga Zeusi, merr përngjasimin e Nestorit.

Ëndrra (Oneiros), fëmijë të Hypnos (Gjumi) dhe të Niktes (Natës). Vendbanimi i tyre në udhën e Hadit, tej Oqeanit, ka porta briri dhe fildishi. Nga të parat (prej briri) dilnin Oneiros, mbartëse të ëndrrave të vërteta, nga të dytat (të fildishtat) mbartëse të ëndrrave gënjeshtare, mashtruese. Oneiros më mashtruesë janë Morfeu (paralajmërues i së vërtetës), Fantasi (frymëzues i iluzioneve të çmendura dhe të çudive të pabesueshme) e Fobetori (mbartës i frikës) ose Ikeli (ky i fundit përfaqëonte ëndrrat më tmerruese).

gjithçka pa gabuar kumtoi, siç urdhëroi: 10
 Të armatosë, thuaji, akejtë flokëgjatë¹
 sa më shpejt, se tani mund të marrë qytetin rrugëgjere
 të trojanëve, se tani për të, ata, që kanë banesat olimpike,
 të pavdekshmit, s'mëdyshen, të gjithë i ka epur
 Hera duke i lutur dhe gjëmat varen mbi trojanët". 15
 Kështu foli dhe u nis Ëndrra kur dëgjoji urdhrin;
 arriti me vrull tek anijet e shpejta të akejve,
 shkoi të kërkonte Atrid Agamemnonin dhe e gjeti
 duke fjetur në çadër, gjumë i ambroztë² i derdhej përreth.
 I qëndroi mbi kokë, e ngjashme me të birin e Neleut, 20
 Nestorin, atë që mes pleqve nderonte shumë Agamemnoni,
 përngjarë me të Ëndrra hyjnore i foli:
 "Ti fle, bir i Atreut të ditur në luftë, kuajzbutësit,³
 po nuk duhet të flejë gjithë natën një burrë këshilltar⁴
 që popujt i besuan për kaq gjëra të kujdeset. 25
 Tani më dëgjo shpejt; jam lajmëtar i Zeusit,
 që për ty, ndonëse larg, shumë të mendon e të përdëllen.
 Të urdhëron të armatosësh akejtë flokëgjatë
 sa më shpejt; se tani mund të marrësh qytetin rrugëgjere
 të trojanëve, se tani për të, ata që kanë banesat olimpike, 30
 të pavdekshmit, s'mëdyshen, të gjithë i ka epur
 Hera duke i lutur dhe gjëmat varen mbi trojanët
 nga Zeusi. Por ti këto ndërmendi, as harresa
 mos t'i marrë kur të të lërë gjumi mjaltë i ëmbël".
 Kështu foli dhe shkoi, atje e la 35
 të mendonte në shpirt gjëra që s'kishin për t'u kryer;

¹ 11. Cilësimi i akejve si "flokëlëshuar", i kundërvihet "flokëcullufe", trajtë që përdorej për trakasit, aleatë të trojanëve.

² 19. ἀμβρόσιος... ὕπνος, gjumi hyjnor: mbiemri ἀμβρόσιος (i ambroztë) "i pavdekshëm", "hyjnor", normalisht u referohet flokëve, veshjeve, ushqimit të hyjnive (shih shënimin te I, 529), se ëmbëlsia e tij dhe efiikasiteti jetëdhënës është konceptuar si një dhuratë e hyjnive njerëzve, e njëherësh, ngaqë në gjumë janë subjekte vetë hyjnitë, jo më pak se njerëzit. Në pjesë të tjera të poemave homerike (Iliada XIV, 231; XVI, 454; Odisea, XIII, 80) dhe te Hesiodi (Teog. 212), ai është personifikuar (Hypnosi) dhe është përfaqësuar si vëlla i vdekjes (T(h)anatos).

³ 23. ἰπποδάμοιος, *zbutës kuajsh*: epitet i mjaft heronjve, në veçanti i Diomedit dhe Hektorit (VII, 404; IX, 51; XVI, 717); shoqëron normalisht emrin e trojanëve. Epiteti shpjegohet me rëndësinë që ka për qëllime luftarake, aftësia e luftëtarit për të stërvitur dhe për të ngarë kuajt, që tërheqin qerren e tij.

⁴ 24. Βουλῆφόρος, *këshilltar*: në origjinalin homerik, epitet i hegjemonëve (sundimtarëve), që japin këshilla në asamble (kuvend).

kujtonte se do të merrte qytetin e Priamit atë ditë,
 i pamendi, që nuk dinte ç'punë mendonte Zeusi,
 se donte t'u shkaktonte ende dhimbje dhe vaje
 trojanëve dhe danajve mes betejash të ashpra. 40

U zgjua nga gjumi, dhe zëri hyjnor derdhej përreth;
 pasi u ngrit më këmbë e ndenji dhe veshi kiton¹ të butë,
 të bukur e të ri dhe u mbështoll me një mantel të gjerë,
 nën këmbët e ndritshme lidhi sandale të hijshme
 dhe në supe vari një shpatë me tokëza argjendi;² 45

pastaj mori skeptrin atëror, përjetë të pathyeshëm,
 me të shkoi tek anijet e akejve kiton bronzte.
 Hyjnesha Eos u ngjit tek Olimpi i lartë
 Zeusit t'i kumtonte dritën dhe të pavdekshmëve të tjerë;
 pastaj kasnecët³ zë gjëmimtarë urdhëroi 50

të thërrasin kuvendin e akejve flokëgjatë;
 sapo u lajmëruan, ata u mblodhën me të shpejtë.
 Në fillim thirri Këshillin⁴ e Pleqve shpirtmëdhenj
 pranë anijes së Nestorit, mbretit lindur në Pilos,
 dhe kur u mblodhën, mendime të urta u tha: 55

“Dëgjoni, o miq! Më erdhi në gjumë Ëndrra hyjnore
 mes natës së ambroztë⁵, madje Nestorit hyjnor
 në pamje, në shtat dhe në fis i përngjante shumë;
 më qëndroi mbi kokë e më tha këto fjalë:

¹ 42. Χιτώνα, *kítōn* (*hitona*), këmishë: kitoni është tunika (veshje prej leshi a liri, gjer në gjunjë, me mëngë të shkurtra, që mbahej shtrënguar nga një brez) veshur në trup, me gjatësi, cilësi e zbukurime të ndryshme. Vishet vetëm ose nën koracë apo nën pelerinë. Ndryshe nga epokat pasardhëse, kitoni te *Homeri* është vetëm veshje meshkujsh; veshja femërore është pepli.

² ξίφος ἀργυρόηλον, *shpata me tokëza argjendi*: një tip shpate në të cilën tokëzat e metalit të çmuar mbajnë të bashkuar dorezën me presën e bronzte (XI, 29 etj. ku tokëzat e shpatës së Agamenonit janë prej ari). Arkeologjia vërteton përdorimin e saj në periudhën mikenase, ndërsa nuk është më e pranishme në epokën homerike, në shek. VIII. Si rezultojnë nga pjesa homerike, varej në shpatullën e djathtë me një rrip.

³ 50. Për funksionet e kasnecëve shih shënimin te I, 320-321.

⁴ 53. Këshilli (βουλή) dallohet nga Kuvendi (ἀγώρη, asambleja); këshilli është i ngushtë, marrin pjesë vetëm pleqtë, pra krerët, prijësit (shih v. 79); ndërsa kuvendi është mbledhja e përgjithshme e ushtrisë. Shih dhe shënimin te IX, 70.

⁵ 57. ἀμβροσίην διὰ νύκτα, *përmes natës së pavdekshme*: mbi termin ἀμβροσίην, shih shënimin te I, 529; mbi shenjtërinë e hyjnizimin e natës, që këtu është e qartë lidhja me pavdekësinë e saj, shih shënimin te XI, 194.

“Ti fle, bir i Atreut të ditur në luftë, zbutësit të kuajve, 60
 po nuk duhet të flejë gjithë natën një burrë këshilltar,
 që popujt i besuan për kaq gjëra të kujdeset.
 Tani më dëgjo shpejt: Jam lajmëtar i Zeusit,
 që për ty, ndonëse larg, shumë të mendon e të përdëllen.
 Të urdhëron të armatosësh akejtë flokëgjatë 65
 sa më shpejt, se tani mund të marrësh qytetin rrugëgjërë
 të trojanëve, se tani për të ata që kanë banesat olimpike,
 të pavdekshmit, s’mëdyshen, të gjithë i ka epur
 Hera duke i lutur dhe gjëmat varen mbi trojanët
 nga Zeusi. Por ti këto ndërmendi”. Pasi foli kështu 70
 iku fluturimthi dhe mua gjumi i ëmbël më la.
 Të shohim, pra, si do të armatosim të bijtë e akejve;
 në fillim unë me fjalë do t’i vë në provë, siç është e drejtë,
 e të ikim me anijet me shumë rrema do të urdhëroj;
 dhe ju, kush këndej kush andej t’i pengoni me fjalë.¹ 75
 Kështu foli ai dhe u ul e ndërmjet tyre u ngrit
 Nestori, që ishte mbret në Pilosin ranor;
 dhe duke menduar urtë, u foli dhe u tha:
 “O miq, prijës dhe krerë të argejve,
 nëse ndonjë tjetër ake do të na rrëfente ëndrrën, 80
 gënjeshtër do ta quanim dhe madje do ta mbanim larg,
 tani e pa ai që lëvdohet se është më i miri i akejve;
 të shohim, pra, si të armatosim akejtë”.
 Kështu foli e ishte i pari që la Këshillin,
 e të tjerët u ngritën të bindur ndaj bariut të popujve, 85
 mbretërit skeptërmbajtës; dhe mblidheshin popujt.
 Siç shkojnë luzmat e bletëve të panumërta,
 që dalin pandërprerë nga një shkëmb i zgavërt
 dhe fluturojnë vile-vile mbi lulet e pranverës,

¹ 75. Ky episod i “*provës së ushtrisë*”, që vijon, ka një zhvillim të ngatërruar dhe kontradiktor; mendohet me arsye të forta se aty është ripunuar një këngë, ku Agamemnoni nxiste seriozisht ushtrinë, por ajo rebelohej. Përpunimi do të fillonte me këtë Këshill të pleqve, ku si duket është ndërfaqur në një tekst tashmë të plotë, ndër të tjera, sepse ai mblidhet kur edhe asambleja është ndërkohë e mbledhur. Pastaj tek *Iliada* duhet vënë re se e vetmja mbledhje e rregullt është asambleja (kuvendi); nuk ekziston një shtab i përgjithshëm, dhe kuvendet e pakta vetëm të krerëve, lindin në rrethana të rastit: një banket për nder të Ajaksit, një takim rastësor, një intrigë e natës (VII, 313 etj.; XIV, 27 etj.; X, 53 etj.; në fillim të librit IX të dhënat janë konfuzë). Institutu klasik i Këshillit është ende i huaj tek *Iliada*.

ca këndeje fluturojnë mizëri, ca andej; 90
 kështu dhe këta, trumba të shumta, nga anije e çadra
 përpara bregut të thellë viheshin në rresht
 sipas grumbujve në kuvend; dhe mes tyre flakërinte Fama,¹
 lajmëse e Zeusit, i nxiste të shkonin e ata mblidheshin.
 Kuvendi trazohej, rënkonte toka nga poshtë, 95
 ndërsa popujt uleshin; dhe ishte rrëmujë; nëntë
 kasnecë i përmbanin duke bërëtitur, që zërat
 të ulnin dhe të dëgjonin mbretërit hyjnilindur.
 Zorshëm më në fund ndenji populli, u ulën nëpër vende,
 gumëzhitjen pushuan; dhe kreu Agamemnon 100
 u ngrit duke mbajtur skeptrin, që Hefesti² punoi me mund;
 Hefesti ia dha mbretit Zeus Kronionit,
 pastaj Zeusi ia dha Lajmëtarit Argovrasës,³

¹ 93. Në original Osa (Οσσα), zëri, tingulli, lajmëtare e Zeusit. Zëri në thelb është hyjnia që kryeson përhapjen e lajmeve gojë më gojë gjersa tërë grupi social të vihet në dijeni. Për personifikimin e Oσσα, Zëri, shih Odisea I, 282 etj.; XXIV, 413. U preferua termi Fama, sipas Dukas, pra fjala, zëri, që shpërndahet.

² 101. Nga veprat mjeshtrërore e të jashtëzakonshme të Hefestit:

- Vepra argjendarie në shpellën e Oqeanit (XVIII, 400); - Banesat e hyjnive olimpikë (I, 605); - Pallati i Herës (XIV, 166); - Sallat e skalitura të pallatit të Zeusit (XX, 10); - Froni i Hypnosit (XIV, 236); - Pallati i Hefestit (XVIII, 369); - Skeptri mbretëror i Zeusit, që arrin tek Agamemnoni (II, 100); - Egjida (mburoja) luftarake e Zeusit (XV, 307); - Mburoja e Diomedit (VIII, 191); - Armët e Akilit (XVIII, 142, 478, 609); - Tripodët automate apo vetëlëvizës (XVIII, 372); - Kacekët vetëfeksionues (XVIII, 468); - Shërbëtoret prej ari (XVIII, 410); - Mburoja e Akilit (XVIII, 478-608); - Vargonjtë e Aresit dhe Afërditës (Odisea, VIII, 272, 295, 326); - Vargonjtë e Herës (Pausania, *Udbëtime*, 1, 20, 3); - Vargonjtë e Prometeut (Hesiodi, *Teogonia* 521, Eskili, *Prometen i lidhur*, 6); - Pandora (Hesiodi, *Punët dhe ditët* 60, *Teogonia* 571); - Kurora e Pandorës (Hesiodi, *Teogonia* 578); - Mburoja e Herakliut; - Pallati i Kipridës (Apoll. Rodios, *Argon*. 3, 36); - Punishtja lundruese (Apoll. Rodios, *Argon*. 3, 41); - Çezmat në pallatin e Eitit (Apoll. Rodios, *Argon*. 3, 215); - Qetë e Eitit (Apoll. Rodios, *Argon*. 3, 230, Apollodori, *Biblioteka*, 4, 9, 23); - Plugu i çelikut të Diellit (Apoll. Rodios, *Argon*. 4, 1638; Apollodori, *Biblioteka*, 1, 9, 26, Sofokliu, *Dedali*, fragm. 160-161); - Dhurata martesore të Europës (Eratosteni, *Kataster*, fragm. 33); - Gjerdani i Harmonias (Apollodori, *Biblioteka*, 3, 4, 2); - Kurora e Ariadnës (Eratosteni, *Kataster*, fragm. 5); - Cimbalet e Herakliut (Apollodori, *Biblioteka*, 2, 5, 6); - Shtëpia e Oinopionit (Apollodori, *Biblioteka*, 1, 4, 4); - Djepin e Diellit (Mimnermi, fragm. 10).

³ 103. διακτόρω ἀργεῖφόντη, *Shoqëruesit, Vrasësit të Argos*. Hermes i emëruar në vargun vijues. Që të dy epitetet janë të vështira në interpretim. Mes dijetarëve antikë shpjegimi më i zakonshëm i διακτόρωç ishte ai i "lajmëtarit". Atëherë epiteti do të aludonte në këtë rast në funksionin e lajmëtarit të Zeusit, që kryente Hermesin (shih p.sh.: *Odisea* V, 43 etj.). Kritika moderne e ka interpretuar më shumë si "drejtues" (prijë), "shoqërues", sipas një hipoteze të shtruar nga Esikiu (Esichio). Në të vërtetë hyu ishte shoqërues i udhëtarëve dhe i shpirtëve të të vdekurve në rrugëtimin e tyre për në Had. ἀργεῖφόντη tradicionalisht është shpjeguar qysh në antikitet si "vrasës i Argos", i përbindëshit, që Hera e vuri në rojë të Ios. Epitete të tjera të Hermesit janë: lajmëtar i Zeusit, prijës, shoqërues (i udhëtarëve, si dhe i shpirtëve në Had).

Hermes mbreti ia dha Pelopit ngarës kuajsh
dhe Pelopi prapë ia dha Atreut bari popujsh; 105
pas vdekjes Atreu i la Tiestit më shumë dhen,
dhe prapë Tiesti Agamemnonit ia la që ta mbajë,
të mbretërojë në shumë ishuj¹ e në të gjithë Argosin.²
Mbështetur në të, ai u foli argejve këto fjalë:
“O miq, heronj danaj, shërbestarë të Aresit, 110
shumë rëndë më verboi dhe më pleksi Zeus Kronidi,³
i pashpirti, që më zotohej dhe më dha shenjë,
se do të kthehesha kur të rrënoja Ilionin me mure të fuqishme,
por tani mendoj një mashtrim të keq dhe më shtrëngon
i palavdishëm të arrij në Argos, pasi humba shumë popull. 115
Kështu duhet t’i pëlqejë Zeusit të plotfuqishëm,
që shumë qyteteve u shkatërroi kështjellat
dhe ende do të shkatërrojë; e epërme është fuqia e tij.
E është turp këtë ta marrin vesh edhe ata që do të vijnë
se pa dobi i tillë popull akejsj dhe kaq i shumtë 120
luftë të kotë luftonte dhe ndeshej
me burra më të pakët pa iu dukur fundi.
Se dhe sikur të dëshironim akej e trojanë
e të betoheshim me besë e fli, të numëronim të dyja anët,
të mblidheshin veç trojanët vendës, sa janë, 125

Nuk është e qartë prania e Hermesit në këtë listë: duket se përmendet në cilësinë e lajmëtarit të Zeusit, sesa në raportet e tij me sagën e pelopidëve, ku Hermesit shfaqet si at i Mirtilit. Ky kishte ndihmuar Pelopin në garën kundër Enomaut dhe pastaj ishte vrarë me tradhëti, motiv nga hyu kishte shpërthyer një urrejtje të pashuar mes dy bijve të tij, Tiestit dhe Atreut. Por në këtë pjesë, ngjarje të tilla duken se janë shpërfillur, apo sidoqoftë nuk janë marrë në konsideratë.

¹ 108. Duhet të jenë ishujt Ciklade. Prandaj dhe nuk ka ushtri të veçantë nga këta ishuj në Katalogun e anijeve, gjersa sundohen prej Agamemnonit, si edhe nga Argosi.

² 108. Ἄργεϊ παντὶ, në tërë Argosin. Toponimi Argos te Homeri rrëfen qytetin e Argosit, por edhe gjithë rajonin e Argolidës (që përfshin Argosin, Mikenën, Tirintin), apo tërë Peloponezin, ndonjëherë edhe Greqinë në përgjithësi. Në këtë mënyrë, referimi është me territorin ku shtrihet sundimi i Agamemnonit, dhe identifikimi me Argolidën duket i natyrshëm, por realisht është problematik: te Homeri, qyteti i Agamemnonit është në fakt Mikena, ndërkohë qytetet e Argos dhe Tirintit janë nën sundimin e Diomedit.

³ 111-113. Agamemnoni u referohet me siguri përgjigjeve profetike dhe të falltarisë të marra para fillimit të ekspeditës. Ishte zakon i vërtetë i grekëve (dhe romakëve), nga epokat e lashta gjer në ato të vonëta, që para çdo fushate ushtarake të këshilloheshin me priftërinjtë kompetentë në shpjegimin e vullnetit hyjnor, për të ditur nëse në këto kushte fushata do të kishte sukses.

dhe në dhjetëshe akejtë të rreshtohemi të gjithë
dhe nga trojanët kupëmbajtës¹ të marrë secila,
do të mungonte gostitësi nga shumë prej tyre.
Kaq them unë jemi bijtë e akejve më shumë
nga trojanët, që banojnë në qytet; por burra e besëtarë 130
nga shumë qytete janë, që heshtën tundin mirë,
që më zmbropsin me forcë, e s'më lënë, ndonëse dua
të shkel qytetin e mirëpopulluar të Ilios.
Dhe nëntë vjet të Zeusit të epërm² shkuan tani
e drurët e anijeve u kalbën, pallasartët³ u tretën; 135
rrinë gratë tona me fëmijët belbëzues
në shtëpi duke pritur; dhe neve puna
që erdhëm këtu të bëjmë është ende e pakryer.
Por, eni, kështu si them unë të bëjmë të gjithë, të bindur;
të ikim me anije në tokën e shtrenjtë atërore. 140
Kurrë më nuk do të marrim Trojën rrugëgjërë".
Kështu dhe atyre u kërceu zemra në gjoks
të gjithëve mes turmës, sa nuk e kishin dëgjuar vullnetin e tij;
dhe kuvendi u trazua si dallgë të mëdha deti,
të Detit të Ikarit, që Euroja⁴ me Jugën 145
ngrenë duke kërcyer poshtë nga retë e atit Zeus,
a kur vjen Zefiri dhe pështjellon një arë me të korra të larta,⁵
i furishëm me shtrëngatë dhe ep kallinjte,
ashtu lëvizti kuvendi dhe me ushtimë
në anije u derdhën dhe nga këmbët pluhuri 150

¹ 127. *Kupëmbajtës*, gostitës, sak, ai që u mbush gotat me verë në një tryezë a gosti (në Greqinë e Lashtë vera hollohej në një krater pastaj ndahej nëpër kupa).

² 134. Zeusi konsiderohej nga Homeri si Zot i kohës; është ai që mbikëqyr këmbimin e ditës me natën, si dhe të stinëve.

³ 135. *Pallasartët*, litarët e anijes.

⁴ 145. *Euro*-ja, shiroku, erë juglindore.

⁵ 147-148. Të vihet re një herë e mirë se qëllimi i vërtetë i *krahásimeve homerike* nuk është të zbukurojë, por për të dhënë me efektshmëri maksimale dhe thukët çaste të aksionit (veprimit), që stili i zakonshëm nuk mund t'i përshkruajë me kaq shkurtësi; ndërsa rrëfimi epik ka plot mbiemra zbukurues, shtuar shpesh për lehtësi metrike, në krahasimet e zakonshme, janë thjeshtuar në një numër të domosdoshëm, si dhe janë zgjedhur me kujdes.

Zefiri te Homeri është era e perëndimit, e rrëmbyer dhe sjellëse e shtrëngatës (jo era e butë që do të paraqiste poezia në shekujt e mëvonshëm).

ngrihej në erë dhe njëri-tjetrin nxitnin
 të kapnin anijet e t'i tërheqin në detin e shenjtë,
 dhe hullitë¹ pastronin; e në qiell arrinte britma
 e të paduruarve, e shtylloret² hiqnin nën anije.
 Do të kryhej atëherë kundër fatit kthimi i argitëve 155
 nëse Hera s'do të arrinte t'i thoshte Athinasë:
 "Ah, moj bijë e Zeusit egidëmbajtës, Atritona,³
 kështu pra në shtëpitë e atdheut të ëmbël atëror
 do të ikin argejtë mbi gjoksin e gjerë të detit
 duke u lënë mburrje dhe Priamit dhe trojanëve 160
 Helenën argite, gjersa për të shumë akej
 në Trojë vdiqën larg tokës së dashur atërore.
 Por shko shpejt te populli i akejve kitonëbronzte
 dhe me fjalët e ëmbla pengo secilin nga burrat,
 e të mos lësh që në det anijet e dymysëta⁴ të tërheqin". 165
 Kështu tha dhe hyjnesha sykaltër iu bind fjalës
 dhe u lëshua me një kërcim nga majat e Olimpit.
 Menjëherë arriti në anijet e shpejta të akejve,
 Odisenë gjeti, të ngjashëm me Zeusin në urtësi,
 pa lëvizur; vërtet ai anijen kuvertëmirë 170
 s'ë prekte, se shpirt e zemër ia mbushte hidhërimi.
 Pranë i qëndroi sykaltra Athina dhe i foli:
 "Laertiad hyjnilindur, Odise mendjemprehtë,
 kësisoj, pra, në shtëpi, në tokën e dashur atërore
 do të ikni duke u hedhur në anijet me shumë rrema 175
 dhe Priamit e trojanëve mburrje do t'u lini
 Helenën argite, gjersa për të kaq akej
 vdiqën në Trojë larg atdheut të tyre?
 Por shko mes popullit të akejve, mos u vono më,

¹ 153. οὐρούς, *hullitë e karenes* (kallumës): janë hullitë (brazda) mes të cilave anijet çohen nga deti në tokë dhe anasjelltas.

² 154. *Shtyllore*, kallumë, shtyllat ku mbështeten anijet në tokë.

³ 157. Atritoni, *Atritoní*, Atritona (Ἀτρυτώνη, *it.* Atritona): epitet i hyjneshë Athinasë: *E pamposhtur, e paepur*. (Ἀτρυτώνη, *it.* *L'invincibile, Infaticabile*). Por kjo etimologji është e pasigurt dhe mund të ketë edhe origjinë jogreke.

⁴ 165. *Dymysët*, dylugët, i mysët nga të dyja anët, i dalë si gungë, i lugët.

me fjalët e buta pengoje secilin burrë¹ 180
dhe mos lër që në det të tërheqin anijet dymysëta”.
Kështu tha; dhe ai ia njohu zërin hyjneshës që foli
dhe u derdh me vrap duke flakur pelerinën, që e mori
kasneci itakas Euribat, i cili i rrinte pas.
Përballë Atridit Agamemnon erdhi 185
dhe i mori skeptrin stërgjyshor përjetë të paprishshëm,
me të rendi tek anijet e akejve kitonëbronzte.
E cilindo mbret a burrë të zgjedhur ndeshte,
me fjalë të buta e pengonte duke i ndenjtur pranë:
“I pamend, nuk të shkon të tutesh si frikës, 190
por ndalu ti dhe bëj të rrinë dhe luftëtarët e tjerë,
ende qartë s’ke kuptuar mendjen e Atridit,
tani i vë në provë, por shpejt do t’i shtrëngoj bijtë e akejve.
Në kuvend të gjithë a nuk dëgjuam çfarë tha?
Mos zemërohet e u bën keq bijve të akejve; 195
e madhe është mëria e mbretërve hyjnimëkuar,
nderi i tyre prej Diosit qënka, i do Zeusi i gjithëditur”.
E kur ndeshte ndonjë luftëtar nga vulgu që çirrej
keqas e frikësonte dhe me skeptër e godiste:
“I pamend, qëndro ulur dhe dëgjo mendimin e të tjerëve, 200
që janë më të fortë se ti, burracak dhe frikash,
që as në luftë të numërojmë as në kuvend;
sigurisht këtu s’do të mbretërojmë të gjithë akejtë;
sundimi shumëkrerësh sjell dëm, një të jëtë kreu,
mbreti një, ai, që i biri i Kronit mendjefshehtë³ i dha 205
skeptrin dhe ligje, të mbretërojë mbi të tjerët”.
Ashtu duke urdhëruar ai përmbajti ushtrinë; në kuvend

¹ 180. Krerët nuk kujtojnë detyrën e Agamemnonit (v. 75), ose këto vargje nuk njohin që ka pasur një Këshill të krerëve (prijësve). Këtu duket që Agamemnoni nuk ka instrumente disiplinore dhe shtypëse: asambleja mund të përmbahet vetëm “me fjalë” (v. 75, 164, 180, 189). Odisea do të përdorë edhe shkopin, por bëhet fjalë për skeptrin e Agamemnonit.

² 197. Në original: Διός, Dios, *Zensi*.

³ 205. Κρόνου... ἀγκυλομήτεω, i Kronit me mendime të fshehta: epitet që shoqëron rregullisht emrin e Kronit (Κρονος). Aludohet me siguri për mjetet mashtruese, që përdori kundër të atit, Uranit në fillim, dhe pastaj kundër vetë bijve të tij, për të ruajtur sundimin e vet.

212. Θερόσις është një emër “folës”, i trajtësuar posaçërisht për personazhin në fjalë. Formuar nga eoliku θέροσος = joniku θέρσος, “paturpësi”, do të thotë pikërisht “i kuturitur”, “i pacipë”.

prapë derdheshin ata nga çadrat dhe anijet
 me zëra të egra ashtu si dallga e detit shumëfërfërimësh
 gjëmon në bregun e gjerë dhe deti bulurin. 210
 Të tjerët të gjithë u ulën nëpër vendet e tyre,
 Tersiti¹ i vetëm, llafeshumë, ende zhurmëronte,
 që dinte shumë fjalë të pavenda të gjente me mendje,
 marrëzisht e pahijshëm të përgojonte mbretërit,
 duke thënë ç't'i ndërmendej që i dukej se për argejtë 215
 ishte qesharake; i shëmtuar tjetër si ai nuk erdhi në Ilion,
 ishte vëngërosh dhe i çalë nga njëra këmbë, supet
 e kërrusura, që përpara ia mbulonin gjoksin,
 me kokë hollake me majë e sipër flokëpakët.
 Ishte i urryer shumë, sidomos nga Akili dhe Odisea 220
 se shpesh i përfliste; po atëherë Agamemnonin hyjnor
 duke krakëllirë me mprehtësi shpifte; me të akejtë²
 me brengë në zemër shumë zemëroheshin.
 Dhe ai duke bërtitur me Agamemnonin grindej:
 “Atrid, ç'kërkon prapë? Na thuaj ç'të mungon? 225
 Plot bronz çadrat e tua, të shumta janë dhe gratë
 në çadrat e tua, të zgjedhura, që ne akejtë
 të parit ty të japim kur marrim ndonjë qytet.
 Ende ke etje për ar, që do të sjellë dikush
 nga trojanët kuajzbutës nga Ilioja, shpërblesë për të birin, 230
 që unë pasi e lidha po e sjell apo tjetër ake?
 Apo dashke grua të re që me të të bashkohesh në dashuri,
 që mënjane për vete e mban; s'është e drejtë
 një prijës t'i kredh në fatkeqësi bijtë e akejve.
 Frikësa, të keqturpëruar, akeje, jo më akej, 235
 në shtëpi me anije të kthehemi dhe këtë ta lëmë
 këtu në Trojë dhuratat e tij të tresë, që të shohë
 nëse edhe ne në ndonjë gjë e ndihëm apo jo.

¹ 212. Θερσίτης është një emër “folës”, i trajtësuar posaçërisht për personazhin në fjalë. Formuar nga eoliku θέρσοος = joniku θέρσοος, “paturpësi”, do të thotë pikërisht “i kuturitur”, “i pacipë”.

² 222. τῷ, kundër tij; jo kundër Tersitit u zemëruan akejtë (siç e kuptojnë shumë komentues), por kundër Agamemnonit për atë që i ka bërë Akilit. Tersiti shfrytëzon ndjenjat e e përhapura në ushtri për të pasur rastin që të fyejë prijësit.

Ai dhe tani Akilin, një burrë të madh e trim
 çnderoi, se dhuratën ia rrëmbeu dhe ia mban. 240
 Por nuk mbajti vrer në zemër Akili dhe shkujdeset,
 se përndryshe do të ishte fyerja jote e fundit, Atrid¹.
 Kështu grindej me bariun e popujve, Agamemnonin,
 Tersiti; kur shpejt iu afrua Odisea hyjnor
 duke e parë vëngër iu vërsul me fjalë të ashpra: 245
 “Tersit fjalëturbull, edhe pse gojëtar i hollë,
 ndalu e mos kërko i vetëm të grindesh me mbretër,
 se po them që ndonjë i vdekshëm më i keq se ty
 nuk gjendet nga sa erdhën në Ilion me Atridin.
 Prandaj mos fol duke pasur mbretërit nëpër gojë,
 duke vjellë sharje për ta në pritje të kthimit 250
 se ende nuk e dimë ç’fund do të kenë këto punë,
 me të mirë a me të keqe do të kthehem i ne bijtë e akejve.
 Dhe ti tani Atrid Agamemnonin, bari popujsh,
 kënaqesh duke e sharë, se shumë dhurata i japin 255
 heronjtë danaj; dhe ti ligjëron duke e fyer.
 Por dëgjo dhe beso, se ç’do të them do të kryhet,
 në të gjetsha tjetër herë mendjeçoroditur, si tani,
 kryet mos qëndrofshin mbi supet e Odisesë,
 as të më quajnë më baba të Telemakut, 260
 në s’të zënça menjëherë e të të zhvesh nga rrobat,
 nga pelerina e tunika, që turpet² të mbulon
 dhe të të dëboj prapa duke qarë, në anijet e shpejta,
 nga kuvendi, të rrahur me goditje për turp”.
 Kështu tha dhe me skeptër në shpinë dhe në supe 265
 e qëlloi; ai u kërrus dhe i nxehtë loti iu rrokullis.
 Një ënjtje e përgjakur në shpinë iu fry
 nga skeptri i artë; dhe ai u ul dhe u tmerrua,
 nga dhëmbja i përhumur pa përreth dhe fshiu lotin.

¹ 242. *Tersiti*, si na thotë Homeri në vargun 221, shpesh e shante Akilin. Tani e mbron. Këtu kemi rastin e kundërt të Akilit. Sipas Agamemnonit, Akili donte të “mbretëronte të gjithë”, pra kishte prirje totalitare (I, 287 e në vijim). Tersiti i kundërt është përfaqësuesi i “anarkisë së keqe”, i gatshtëm të shfrytëzoi cilëndo gjendje për të akuzuar me fjalë të shëmtuara çdo prijës.

² 262. Në origjinal: χλαῖναν τ’ ἠδὲ χιτῶνα, τὰ τ’ αἰδῶ ἀμφικαλύπτει, nga *pelerina e tunika, që turpet të mbulon*; turpet, pjesët e turpshme të burrit, herdhet.

Të tjerët dhe pse të pikëlluar me zemër qeshën me të;¹ 270
dhe kështu dikush i thoshte tjetrit pranë:
“Oh, një mijë punë të mira ka bërë Odisea,
duke dhënë këshilla të mira, duke prirë në luftë,
por tani kjo më e madhja e më bukura që kreu mes argejve,
që sherrakut gojështurur ia preu fjalën; 275
nuk do të guxojë prapë zemra e tij e pacipë
të përshajë mbretërit tanë me fjalë fyese”.²
Kështu i tha morisë; në këmbë qytetrrënuesi³ Odise,
skeptrin mbante dhe pranë tij Athinaja sykaltër
në pamje kasneci, të heshtte urdhëroi popullin, 280
që bashkë dhe të parët dhe të fundit bij të akejve
t’i dëgjonin fjalën dhe të kuptonin këshillën.
Dhe atyre ai me mendim të urtë u foli e u tha:
“Atrid, tani akejtë dëshirojnë, o mbret,
të të turpërojnë para gjithë të vdekshmëve 285
dhe as mbajnë premtimin që në krye të bënë
kur u nisën për këtu nga Argosi kuajrritës,
Ilion me mure të forta ta rrënosh e të kthehesh.
Se si fëmijë të vegjël dhe gra vejusha,
vajtojnë njëri me tjetrin të kthehen në shtëpi. 290
Vërtet, e dhimbshme pas mundimesh të kthehet dikush;
nëse njëri dhe një muaj të qëndrojë larg gruas,
me anijen me shumë rrema, do të zemërohet që stuhitë
dimërore e mbajnë mbyllur dhe deti i fryrë;
dhe tek i nënti vit në rrotullimin e tij na gjeti 295

¹ 270. Asambleja qesh me Tersitin e rrahur me shkop nga Odisea, megjithëse në të vërtetë i vjen keq që propozimi i tij është rrëzuar.

² 277. Episodi i Tersitit, që ndërfit tek *Iliada* shprehjen më të fuqishme të polemikës sociale, rrëfen se në cilat skajshmëri mund të arrinte kundërshtia shoqërore në një demokraci primitive tashmë shumë të diferencuar.

Tersiti nuk është ende një i përjashtuar, një nënshtetas: merr pjesë në asamble, atje mund të flasë, përkundrazi ka zakonin të përgojë krerët (v. 220-21, jo vetëm për Agamemnonin), nga të cilët nuk e ndanin as ligje as forca publike. Inferioriteti i tij nuk është shoqëror, por personal; ndëshkimi është miratuar nga e gjithë asambleja. Personale është dhe polemika e poetit, që paraqet Tersitin si një karikaturë, por e bën të flasë kundër Agamemnonit saktësisht të njëjtat gjëra, që ka thënë Akili në librin e parë.

³ 278. *Qytetrrënuesi*, në origjinal: πτολιποροθης, ai që shkatërron, që shkreton qytete, karakterizim për Aresin, Akilin, Odisenë etj.

ndenjuri këtu, prandaj s'inatosem me akejtë
 që mërihen pranë anijeve të mysëta, por
 turp është të rrihesh kaq shumë e duarbosh të kthehesh.
 Duroni, o miq e prisni dhe pak kohë, gjersa të mësojmë
 nëse të vërtetën paratha Kalkanti apo jo. 300
 Se këtë e dimë mirë në mendje dhe të gjithë
 dëshmitarë jemi, sa s'i morën Keret,¹ që sjellin vdekjen;
 si dje dhe pardje ishte kur në Aulidë anijet e akejve
 mblidheshin, të keqen t'i sillnin Priamit e trojanëve.
 Dhe ne përreth burimit,² tek altaret e shenjta, 305
 të pavdekshmëve u bënim hekatomba të përkryera,
 nën një rrap të bukur ku rridhte ujë i kristaltë.
 Shenjë e madhe u shfaq atje, një dragua i kuqërremtë³ në shpinë,
 i tmerrshëm, që pikërisht Olimpiasi⁴ e solli në dritë,
 nga poshtë altarit brofi dhe drejt rrapit u vërsul. 310
 Atje një fole trumcakësh ishte, krijesa të brishta,
 në degën më të skajshme, ndër gjethe strukur,
 tetë dhe e nënta ishte e ëma, që i lindi fëmijët.
 Atëherë ai i hëngri kur pingëronin të sflitur
 dhe të ëmën që fluturonte përreth duke qarë fëmijët, 315

¹ 302. *ἄρρες... θανάτοιο, fati i vdekjes*: teksti grek emëron Keret, domethënë hyjneshat e fatit të paracaktuar, që u sjellin vdekjen njerëzve.

Fjalorët homerikë shpjegojnë edhe: *Keret* (në origjinal: *Κήρες*, it. Chere, Kere (*Κήρ*, *Κηρός*)): 1. Hyjnesha personifikime të vdekjes, bija të Natës dhe motra të Tanatos e Hypnos (Vdekja dhe Gjumi, hyjni të Ferrit); e ndryshme nga *Μοίρα* dhe *Αίσα*, personifikim i vdekjes së dhunshme, në luftë, në det; 2. Fati i vdekjes, vdekja.

² 305-310. Duke përshkruar në shek. II të e. s., tempullin e Artemidës në Aulidë, Pausania (9, 19, 7), pohon se aty gufonte ende *burimi* i përshkruar nga Homeri, si dhe mund të shihje mbetje të trungut të rrapit, të ruajtur me fanatizëm. Pra një lavdi vërtet e përjetshme për mrekullinë dërguar nga Zeusi, si profetizoi falltari Kalkant.

³ 308. Dragoi, simbol i Lakedemonit (Pausania, X, Fokika, kap. 26, 3: Në mburojën, që mban Menelau, është gdhëndur sipër një dragua, që përbën një aluzion në mrekullinë e flisë në Aulidë. Dhe tek Illiada, XII, 199-229).

Për simbolikën e dragoit, shkruan Pausania në Arkadika, 11, 7: Pas përfundimit të betejës (të Mantineias), Epaminonda hoqi dorë, dhe nga plaga dha shpirt. E varrosën në vendin ku u bë përlëshja. Mbi varr është ngritur një kolonë dhe mbi të një mburojë me basoreliev ku paraqitet një dragua. Dragoi ka kuptimin se Epaminonda ishte nga fisi i të quajturve Sparton (Spartanë).

⁴ 309. *Olimpiasi*, Zeusi Olimpik, i Olimpik.

me dredhë e zuri nga krahu kur vajtonte.
 Dhe pasi kishte gëlltitur trumcakët dhe të emën,
 shenjë të qartë e bëri hyu, që e kishte shfaqur,
 se në gur e ktheu i biri i Kronit mendjefshehtë
 dhe ne rrinim e çuditëshim me çfarë kishte ndodhur, 320
 si erdhën mes five shenja të frikshme të hyjnive;
 por shpejt Kalkanti shpjegoi vullnetin e hyjnive:
 “Vallë si mbetet pa zë, akej flokëgjatë?
 Këtë shenjë të madhe na shfaqi Zeusi mendjethellë,
 e vonët, e kryer vonë, po kurrë fama s’do t’i shuhet. 325
 Ashtu si ai hëngri të vegjilit e trumcakut dhe atë,
 tetë dhe e ëma ishte e nënta, ajo që lindi krijesat,
 kështu edhe ne kaq vjet do të luftojmë atje,
 dhe të dhjetin do të marrim qytetin rrugë gjerë”.¹
 Kështu ai fliste dhe tani të gjitha po kryhen. 330
 “Por të tërë këtu qëndroni akej kollçikëmirë,
 gjersa kalanë e madhe t’ia marrim Priamit.”
 Kështu tha dhe argejtë klithën fort dhe përreth
 anijet frikshëm gjëmuan nga britmat e akejve,
 që brohoritën fjalën e Odisesë hyjnor. 335
 Atëherë Nestori, kalorësi gerenias,² atyre u tha:
 “Ah, ju flisni porsi fëmijë
 belbacukë, që s’e vrasin mendjen për punët e luftës.

¹ 329. Është shumë e çuditshme që këtë profeci të *Kalkantit* e mban mend vetëm Odisea. Nëse vërtetë kishte profetizuar diçka të tillë, dhe e merrnin seriozisht, do të duhej të mos kishin nisur rrethimin e Trojës - mbase dhe kjo “profeci” e Kalkantit, nëse e bëri vërtet, të kishte këtë kuptim, domethënë që të shkëshillonte fushatën. Duhej, pra, që të mos i jipnin, të paktën Agamemnoni dhe Menelau, asnjë rëndësi Kalkantit. Mbase ngaqë ishin mësuar që të parashikonte vetëm gjëra të këqija, gjë që zakonisht bëjnë falltarët.

² 336. Γεργήνιος ἰππότα, *kalorësi gerenias*, gjithnjë referuar Nestorit. Nga gerenias, që në antikitet i jepnin interpretime të ndryshme. Në bazë të Hesiodit (fr. 34, 35, 6-8), lidhej me Gerenia ose Gereno, qytet në gjirin mesenik (të Mesinias), ku Nestori kaloi pjesë të rinisë së tij. Ishte lidhur edhe me γέρον, “plak”, ose α γέρας, “privilegj onorifik”, prandaj është kuptuar si “plak” apo “i nderuar”. Në të vërtetë bëhet fjalë për një epitet me traditë të lashtë poetike, kuptimi i të cilit na shpëton. E vetmja lidhje që mund të hamendësohet është ai i antroponimit (*emrit të veçantë të personit*) Kereno = Γεργήνός, i dëshmuar si mikenas. Termi ἰππότα, *kalorës*, te Homeri nënkupton luftëtarin me qerre tërhequr nga kuajt, ngaqë nuk përdorej në luftë kali me shalë.

Marrëveshjet dhe betimet tona ku vanë?

Në zjarr këshillat të shkojnë dhe mendimet e burrave, 340
spërkatja me verë të paholluar, të djathtën¹ ku u mbështetëm?

Se kështu me fjalë grindemi dhe shpëtim
s'mund të gjejmë, megjithëse kohëgjatë rrimë këtu.

Atrid, ti si më parë, me vullnet të pathyer, 345
priju argejve mes betejave të ashpra

dhe këta, një a dy, lëri të hahen, nga akejtë
mënjatë të pleqërojnë - prokopi me ta nuk bëhet -

të arrijnë më parë në Argos, para se Zeusin egidëmbajtës²
ta shohim nëse premtimet të rreme i ka apo jo. 350

Se them që shenjë na dha Kronioni i plotfuqishëm
atë ditë kur në anijet e tyre të shpejta u ngjiten

argitët, masakër e vdekje t'u sillnin trojanëve,
duke gjëmuar nga e djathta ogur të mbarë shfaq.

Prandaj askush të mos ngutet të kthehet në shtëpi,
para se të ketë fjetur me gruan e ndonjë trojani 355

e të hakmerren përpëlitjet dhe rënkimet e Helenës.
E nëse dikush marrëzisht kërkon të kthehet në shtëpi,³

le të prekë anijen e tij të zezë me kuvertë të mirë,
para të tjerëve vdekja dhe e shkruara do ta gjejë. 360

Por, o mbret, vetë mendo mirë dhe dëgjo tjetrin.
Fjala, që do të them, s'do të jetë për t'u hedhur,

burrat ndaji sipas fratrisë⁴ dhe fisit, Agamemmon,
që vëllazëria-vëllazërinë të ndihë e fisi-fisin po ashtu.

Dhe nëse këtë do të bësh dhe të binden akejtë,

¹ 341. σπονδαί τ' ἄκριτοι, libacione bërë me verë të pastër (të papërzier me ujë, siç ishte ajo që pinin) dhe njëherësh pakte të pastra, të sinqerta. Tóka, *bëjmë tóka*, i japim dhe i shtrëngojmë dorën njëri-tjetrit kur takohemi, kur lidhim një fjalë etj.: toka e besës. Në original është: e djathta (dora).

² 348. *Egidëmbajtës*, mburojëmbajtës (Αιγίτοχος, Αιγίδοφόρος), epitet i Zeusit, që mban egidën. Është mburoja e Zeusit e farkëtuar nga Hefestí. Ishte e pamposhtur dhe lëshonte shkrepëtima, duke ngjallur tmerr tek armiqtë. Më pas egida i atribuohet edhe Athinasë, Apollit, Herës, si dhe Aresit.

³ 357-359. Nestori do të thotë se kush këmbëngul në projektin e braktisjes së luftës, do të pësonte në çast dënimin, që pret dezertorët, domethënë vdekjen.

⁴ 363. Fratria, sipas originalit homerik, është bashkimi më i vjetër i familjeve në farefis mes tyre; fratritë nga ana e tyre ishin mbledhur në tribu (nënfise), që në origjinë ishin ndarje të mëdha në mjedisin e fiseve greke, themeluar mbi lidhje të vërteta a të hamendësuara gjaku. Gjon Shllaku përkthen: fis e vëllazëri.

do të njohësh cili prijës e luftëtar është i keq 365
dhe cili i virtytshëm, se do të luftojnë veç e veç,¹
do të mësosh se qytetin s'e merr nga vullneti hyjnor,
apo nga frika e burrave dhe nga padija e luftës".
Atëherë iu përgjigj Agamemnoni i fuqishëm:
"Prapë, o plak, i munde bijtë e akejve në kuvend. 370
Ah, sikur të kisha, Zeus at dhe Athina e Apollon,
dhjetë këshilltarë të tillë mes akejve,
atëherë shpejt do të binte qyteti i mbret Priamit,
i pushtuar dhe i shkatërruar nga duart tona.
Por Zeusi Kronidi egidëmbajtës dhimbje më ka dhënë, 375
në grindje të kota dhe armiqësi më ka shtënë.
Se me Akilin u shamatuam për një vajzë
me fjalë të rënda, e unë me të i pari u mërita,
por nëse një ditë biem në një mendje, s'do të arrijnë
trojanët të marrin frymë nga e keqja as një çast. 380
Por tani shkoni të drekoni, që pastaj të marrim prapë Aresin.²
Secili të mprehë mirë heshtën, mburojën të ndreqë,
ushqim të mirë t'u japë kuajve këmbëshpejtë,
qerren të këqyrë mirë përqark me mendjen në luftë,
që gjithë ditën të matemi me Aresin kobtar. 385
Se armëpushim nuk do të bëhet as për pak
para se të vijë nata, tërbimin e burrave të ndajë.
Do të laget me djersë përreth gjoksit rripi
i mburojës që mbron burrat, dora në heshtë do të mpihet,
do të djersijë dhe kalë që tërheq qerren drulëmuar. 390
Dhe cilido larg betejës do ta pikas, duke dashur
të qëndrojë tek anijet e lugëta, atë pastaj

Është e habitshme, por Uilliam Martin Liku (Udhëtime në Shqipërinë e Vezirëve, Migjeni 2008), në vizitën në Himarën e vitit 1805, kur përshkruan përbërjen e saj, përmend këtë fjalë homerike: ... "Pesë vëllazëri kryesore, që quhen parentie në italisht, ndërsa në greqisht fratries-φρατρίας, një fjalë klasike që unë vështirë prisja ta gjeja në Shqipëri".

¹ 366. Rreshtimi i luftëtarëve sipas vëllazërisë dhe fisit, nxjerr në pah meritat e grupeve të veçanta, e për këtë nxit vlerat e luftëtarëve. Prandaj, edhe gjermanët, sipas përshkrimit të Tacitit, luftonin sipas grupeve farefisnore.

² 381. *Të rimarrim Aresin*: të rinisim luftimet; Aresi është hyu i luftës.

s'është e sigurtë se qenve dhe orlëve do t'u shpëtojë"¹

Ashtu tha e argejtë britmë të madhe nxorën si një dallgë
gjëmon bregut të lartë kur e shtyn Juga, 395
mbi një shkëmb që spikat; kurrë s'e lënë dallgët
e gjithë erërave, që këndeje e andej e rrahin.
Brofën në këmbë dhe u shpërndanë rreth anijeve,
ndezen zjarr pranë çadrave dhe u ulën për të ngrënë.
Dhe njërit e tjetrit hy të përjetshëm i flijonte secili 400
duke u lutur vdekjes t'i ikte dhe tërbimit të Aresit.
Atëherë një dem² flijoi mbreti i burrave Agamemnon,
të majmë, pesëvjeçar, të plotfuqishmit Kronion,
dhe ftonte pleqtë, të parët e panakejve³
Nestorin të parin dhe mbret Idomeneun, 405
pastaj të dy Ajaksët dhe të birin e Tideut,
të gjashtin Odisenë, përngjarë me Zeusin në urtësi.
Vetvetiu erdhi Menelau zëgjëmimi,⁴
e ndiente në zemër vëllanë se si sflitej.
Rreth demit qëndruan dhe morën kokrrat e elbit, 410
mes tyre, u lut Agamemnoni i fuqishëm e tha:
"Zeus i lavdishëm, i epërm, rezezë, që në eter banon,
të mos perëndoje dielli dhe të mos vijë errësira

¹ 393. Kanosja e Agamemnonit i referohet ndëshkimit të tradhëtarëve, dezertorëve dhe bishtnuesve nga lufta: do të vriten dhe trupat e tyre nuk do të varrosen, duke u bërë pre e qenve dhe e zogjve grabitqarë.

² 402-403. βούν... πίονα πενταέτηρον, një ka... të lulëzuar pesëvjeçar; pra të 'rritur', 'të rritur mirë'; shih VII, 314 etj.; *Odisea*, XIX, 420.

³ 404. γέροντας ἄριστους Παναχαιοῶν, pleqtë, të parët e panakejve: përmenden "pleqtë" në kuptimin politik-shoqëror, si në v. 53. Por këtu bëhet fjalë për një kuvend më të ngushtë, rezervuar shtatë a tetë më fisnikëve. *Panakej* (Παναχαιοί), akejtë të gjithë bashkë, në tërësinë e vet, si një ushtri konfederale, motivuar në njëfarë mase nga uniteti i saj etnik. Rosa Calzecchi Onesti përkthen: *tutti quanti gli Achei* (të gjithë akejtë).

Në të kundërt me rendin, që donte Akili, sipas mendimit të Agamemnonit gjithnjë (totalitar) dhe në të kundërt me laicizmin (rendin popullor) e Tersitit, Agamemnoni vepron me mënyrën aristokratike. Fton një këshill të përbërë prej 8 të parësh: *ftonte pleqtë e parë të panakejve...*

⁴ 408. βούην ἀγαθός, i fuqishëm në britmën e luftës, forca e zërit, që i kushtohet dhe Diomedit dhe luftëtarëve të tjerë, ishte një cilësi shumë e rëndësishme në betejë, si për të frikësuar armikun, ashtu dhe për të dhënë urdhra shokëve të armëve.

para se të kem shtrirë përtokë çatinë¹ e Priamit
me blozë dhe zjarrin rrënues të hedh në porta, 415
dhe Hektorit t'ia shqej tunikën përreth gjoksit
me bronz, lecka-lecka; dhe qark tij shokë të shumë
përmbys në pluhur dheun të kafshojnë me dhëmbë".
Kështu foli, por Kronioni nuk ia përmbushi,
flinë e pranoi, por dhimbjen e hidhur ia shumëfishoi.² 420
Pasi u lutën dhe kokrrat e elbit shpërndanë³
ia kthyen pas kokën në fillim, e therën, e rropën,
prenë kofshët, i mbuluan me dhjamë
me dy shtresa dhe sipër vunë mishra të njomë.
Dhe ato mbi dru të çara pa gjethe i digjnin, 425
e të brendshmet pasi i shkuan në hell, i mbanin mbi zjarr.
Kur u dogjën kofshët e të përbrendshmet hëngrën,
pjesën tjetër e bënë copa-copa, i shkuan nëpër heje,
i poqën mirë e mirë të gjitha e i hoqën nga zjarri.
E kur mbaroi mundimi dhe përgatitën tryezën, 430
po hanin dhe askujt s'i mungonte pjesa e barabartë.
Dhe pasi hëngrën e pinë sa u desh zemra,
mes tyre mori fjalën kalorësi Nestor, gerenias:
"Atrid i lavdishëm, mbret i burrave, Agamemnon,
të mos rrimë më duke folur këtu, të mos vonojmë 435
më punën që hyu na ka dhënë në dorë.⁴
Shpejt kasnecët e akejve tunikëbronztë⁵
të thërrasin popullin e ta mbledhin pranë anijeve
dhe ne të gjithë bashkë në ushtrinë e gjerë të akejve
të vemi e të zgjojmë sa më shpejt Aresin zemërak". 440
Këto tha dhe Agamemnoni i madh ia dëgjoi fjalën.
Menjëherë kasnecët zëmprehtë urdhëroi

¹ 414-415. μέλαθρον/ αἰθαλόεν: *çatia me blozë*, pra, nxirë nga tymi i vatrës, e cila zinte qendrën e sallës kryesore të *megaron* (salla kryesore e pallatit)... Tymi nuk përcillej përmes kubesë së oxhakut, por përmes një vrime të bërë në çati. Shih *Odisea* XXII, 239: "mbi trarin e sallës së tymtë".

² 420. Vijon mashtrimi i Zeusit: flija vazhdon në mënyrë që të duket se mirëpritet nga hyu.

³ 421-431. Janë përshkruar gjithë fazat e një flije me shprehjet e njëjta të I, 458-468; shih shënimin përkatës.

⁴ 436. I mashtruar nga zhvillimi i flijimit, Nestori mendon se Zeusi është në favor të aksionit.

⁵ 437. Tunikëbronztë, kitonëbronztë (në origjinal: χαλκό-χίτων), epitet i akejve, që mbajnë veshje (këmishë) të bronztë, të koracuar, me koracë bronzi.

për luftë të thërrasin akejtë flokëgjatë;
dhe ata thirrën e të tjerët u mblodhën me ngut.
Dhe përreth Atridit mbretërit hyjnimëkuar 445
nxitonin t'i rreshtonin¹ e me ta Athinaja sykaltër
me mburojën e paçmuar,² të paplakshme e të pavdekshme
ku vareshin njëqind thekë krejt të artë,
të thurura bukur të gjitha, çdonjëra vlente njëqind qe.
Me të duke vetëtitër përshkonte popullin e akejve, 450
i nxiste të bënin përpara; forcë i zgjonte secilit
në zemër, të bënte luftë e të ndeshëj paprerë.
Dhe menjëherë lufta iu bë atyre më e ëmbël sesa kthimi
me anijet e lugëta në tokën e shtrenjtë atërore.
Si një zjarr shkatërrues djeg një pyll të pafund 455
në majë mali dhe nga larg duket flakërima,
ashtu nga bronzi i ndritshëm tek përparonin
një shkëlqim drite mes ajrit arrinte në qiell.
Dhe ata, si një radhë e panumërt zogjsh me krahë,
me pata a kurrilla³ a mjellma qafëgjatë, 460
në livadhet e Asit, nëpër rrjedhat e Kaistrit,⁴
fluturojnë andej-këtej me krahë të hareshme
dhe ndërsa ulen duke klithur, fusha oshëtin,
ashtu dhe ata radhëshumë nga anijet dhe çadrat
derdheshin fushëtirës së Skamandrit; dhe toka nën ta 465
gjëmonte tmerrshëm nga këmbët e tyre e të kuajve.
U ndalën në livadhin e Skamandrit të lulëzuar,

¹ 446. Mbretërit rreshtojnë luftëtarët sipas rendit të treguar nga Nestori në v. 362, sipas fiseve dhe vëllazërive.

² 447-452. Egida (αίγις) normalisht është privilegj i Zeusit, nga merr dhe epitetin egidë (mburojë) mbajtës αἰγίοχος, egjiokos (shih p.sh.: IV, 167; V, 742; XVII, 593 dhe shënimin te I, 202). Hyjnitë e tjerë që e përdorin ndonjëherë, janë Athinaja dhe Apolloja. Sipas disa komentuesve bëhet fjalë për lëkurën e dhisë Amaltea, që ushqeu Zeusin fëmijë. Ajo kishte fuqi të madhe magjike, nguliste kurajë apo ngjallte terror mes luftëtarëve. Zeusi e shkundte edhe kur donte të mblidhte retë e zeza për një shtrëngatë. Është edhe simbol i kontrollit të klimës atmosferike nga Zeusi.

³ 460. *Kurrillë*, zog shtegtar me qafë si të lejlekut; krillë.

⁴ 461. Në rrafshirën e Asit, në rrjedhat e Kaistrit. Asi (Ἄσιος λειμών, -ώνος), rrafshira e Asit në Lidi, në jug të Tmolit. *Kaistri*, *Kaistros* (Καύστριος, it. *Caistro*): lumë në Azinë e Vogël, që derdhet pranë Hefesit. *Fusha e Kaistrit* (Καύστρου πεδίων, qytet pranë lumit, sot Bulvudun).

me mijëra, sa gjethe e lule lindin në orën e pranverës.
 Si janë të shumta retë e dendura me miza,
 që përreth një stani fluturojnë, 470
 në orën pranverore kur qumështi i mbush vedrat,¹
 kaq akej flokëgjatë përballë trojanëve
 qëndronin në fushëtirë, me dëshirë për t'i shqyer.
 Dhe ashtu si kopetë e shpërndara me dhi burrat dhiarë
 dallojnë lehtësisht, kur përzihen në kullotë, 475
 ashtu dhe prijësit i rreshtonin këndeje-andej
 për të hyrë në betejë, mes tyre i fuqishmi Agamemnon,
 përngjarë në sy e në krye me Zeusin rrufehedhës,
 në brez porsi Aresi,² në gjoks si Poseidoni.
 Si një ka në tufë, mbi të gjithë, krenar vërtitet 480
 demi; se dallohet nga lopët grumbull,
 të tillë e bëri atë ditë Zeusi Atridin,
 krenar mes të shumtëve, të ndritshëm mes heronjve.
 Më thoni tani, o Muza, që banesën kini në Olimp³
 ju, hyjnesha, që kudo gjendeni dhe i dini të gjitha, 485
 ne asgjë nuk dimë, veç famën⁴ dëgjojmë,
 cilët ishin krerët dhe cilët prijësit e danajve,
 morinë s'mund ta them, as ta përmend me emër,
 sikur dhe dhjetë gjuhë e dhjetë gojë të kisha,
 dhe zë të palodhur e zemrën prej bronzi të kisha, 490
 veç nëse Muzat olimpiase, të Zeusit egidëmbajtës
 bija, do të dëshironin të kujtonin sa erdhën nën Ilion.
 Por për prijësit e anijeve do të them dhe anijet të gjitha.

¹ 471. *Vedër*, enë druri, me grykë të gjerë e një vesh apo dorezë, që përdoret për qumështin e mjelë apo për të ruajtur bulmetin.

² 479. *Në brez porsi Aresi*: do të karakterizojë strukturën e fuqishme fizike të mbretit edhe në lartësinë e brezit, ndërsa për pjesën tjetër ai është i ngjashëm me Poseidonin dhe vetë Zeusin.

³ 484-493. Poeti homerik i drejtohet Muzës, si në fillim të poemës, se bëhet gati për një mundim të thiktë, në të cilin do të vihet në provë të ashpër memoria e tij mitike: të rendisë popujt që marrin pjesë në luftën e Trojës, krerët e tyre, qytetet nga vijnë, numrin e anijeve, që disponon çdo grupim. Privilegj i hyjneshave është gjithëdija, ndërsa poeti nuk di asgjë: vetëm frymëzimi i Muzave i lejon kujtimin (shih shënimin te I, 1). Për lutjen Muzave të ndërfitur gjatë rrëfimit, shih edhe XI, 218; XIV, 508; XVI, 112.

⁴ 486. Në original *kleos* (κλέος): famë, britmë, lajm; lavdi.

Beotasve u prinin Peneleu dhe Lejti, ¹ dhe Arkesilau, Protoenori dhe Kloniù,	495
që në Iria banonin dhe në Aulidën e gurtë, ² te Skeni e Skoli, në Eteonin shumëgrykësh, në Tespia e Graia ³ e Mikalesonë e gjerë; sa banonin rreth Armës, ⁴ në Ilesio, në Eritra, të tjerë kishin Eleonin dhe Ilen dhe Peteonin, Okalean dhe Medeonin, qytet i ndërtuar mirë, Kopen, Eutresin dhe Tisben me shumë pëllumba; të tjerë Koronean dhe Aliartin ⁵ gjithë bar, të tjerë kishin Platean e banonin në Glisanto, e kishin Ipotebën, ⁶ qytet i ndërtuar mirë, dhe Onkestin e shenjtë, rrethojë drurëndendur e Poseidonit;	500
	505

¹ 494. Fillon *Katalogu i anijeve*, i quajtur edhe *Boiotía*, nga emri i popullit, që hap rreshtimin. Arsyeja e kësaj preference është dashur të gjendet në faktin se Aulida në Beoti ishte porti nga u nis flota akeje drejtuar për në Trojë. Vijon pra, përshkrimi i kontigjenteve ardhur nga rajonet përreth, nga Peloponezi, nga Greqia perëndimore, nga ishujt lindorë. Katalogun e anijeve e ndjek katalogu i luftëtarëve më të mirë dhe i kuajve më të mirë, që fillon me një lutje të re Muzës (v. 761); vijon pastaj katalogu i ushtrisë trojane (v. 816). Këto lista në vargje, për të cilat ishte i shquar Hesiodi (shih *Katalogu i grave*), kishin një funksion shumë të rëndësishëm në kulturën arkaike: “Ato përbënin si të thuash arkivin e një shoqërie pa shkrim..., synojnë të vënë në rend botën e heronjve dhe të hyjnive, të hartojnë një emërtesë sa më të saktë dhe tërësore. Në këto repertore emrash, që ngulitin listën e përfaqësuesve njerëzorë dhe hyjnorë, që saktësojnë familjen e tyre, vendin, origjinën dhe hierarkinë e tyre, kodifikohen tradita të ndryshme legjendare, organizohet dhe klasifikohet lënda e rrëfimeve mitike” (J. P. Vermant). *Katalogu i anijeve* është për ne një repertori i çmuar gjeografik, topografik dhe historik. Por ai mbetet problematik në mëdyshjen nëse në bërthamën themelore të tij ngjitet në traditat mikenase apo nëse i duhet atribuar në bllok një epoke të mëvonshme.

² 496. *Aulida shkëmbore* e Homerit ishte në rrëzë të një lartësie të gurtë. Afër Aulidës gjendej një liman i madh, që quhej Limani i thellë. Këtu e përcakton Straboni vendndodhjen e përqëndrimit të anijeve të akejeve.

³ 498. *Graia*, fshat i lashtë i Beotisë, pranë Oropit (Strabon 9, 2, 10); sipas Pausanias: Tanagra e mëvonshme.

⁴ 499. Qyteti *Arma* ia kushton emrin ndodhisë që këtu u zhduk qerrja (*Arma*) e Amfiareut, gjatë të quajturave tanagreon dhe jo në vendin ku thonë tebanët. (Pausania IX, 19, 4).

⁵ 503. Straboni (9, 410) përcakton vendndodhjen e *Aliaritit*: “Pranë Oghistusë, nën malin Fenikio (Fikio)”.

⁶ 505. Ἰποθήβας, *Ipoteba*. Teba e poshtme, Teba në fushëtitër. Poeti me siguri do të theksojë se ndërsa zhvillohet lufta e Trojës, Teba e vërtetë duhej të ishte ende një grumbull gërmadhash e shkatërruar nga Epigonët, bijtë e të Shtatëve, që kishin bërë një mësymje të pafat mbi qytet; dhe tebanët nuk kishin se ku të strehoheshin në ndonjë vend tjetër veç në luginën e akropolit të vjetër (Kadmeas).

të tjerë kishin Arnen me shumë vreshta, e Midean
 e Nisën e shenjtë dhe të largtën Antedonë;
 ata me pesëdhjetë anije erdhën, në secilën
 ishin ngjitur njëqind e njëzet të rinj beotë. 510
 Ata që banonin Aspledonën e Orkomenin e minëve,¹
 kishin në krye Askalafin dhe Ialmenin, bij të Aresit,
 që i lindi Astioka në shtëpinë e Aktor Azeidit²
 virgjëresha e denjë, u ngjiti në dhomën e sipërme³
 me Aresin e fuqishëm, i cili u dergj vjedhtas pranë saj; 515
 me ta u rreshtuan tridhjetë anije të lugëta.
 Fokeasve u prinin Skediu dhe Epistrofi,
 bij të Iftit, shpirtmadhit Naubolid,
 atyre që kishin Qiparisin⁴ dhe Piton gurishtore,
 Krisën e shenjtë dhe Daulidën e Panopean, 520
 dhe atyre që rronin në Anemoria⁵ dhe Iampoli,
 e pranë lumit të shenjtë Kefiso⁶ banonin,

¹ 511. Homeri e quan *Orkomenin* “minias” nga fisi (kombi) i minionëve. Thonë se prej këndej u shpërngulën disa në Iolko, prandaj dhe argonautët thirren minias (Pausania, IX, 34 etj., thotë se miniasit ishin vijim i fisit të Sizifit). Gjendeshin në skajin perëndimor të Kopajdas. E mori emrin nga Orkomenó-ja, bir i Minias, i cili ishte at i Elaras, që lindi me Zeusin gjigandin Titio. Qyteti në rrëzë të malit Akontio, ishte i banuar qysh në epokën neolitike dhe, gjatë periudhës mikenase, ishte qendër e një qytetërimi të shkëlqyer.

² 513. *Aktori*, një nga stërnipërit e Friksit, bir i Azeut, nip i Klimenit, baba i Astiokës. *Klimeni*, bir i Presbonit, mbret i minëve (shih: Apollodori II 67, dhe *Odisea*, Kënga 3, v. 452); vajza e Klimenit dhe motër e Aktorit, Euridika, ishte martuar me Nestorin.

³ 514. ὑπερώϊον εισαναβάσσα, u ngjiti në dhomën e sipërme: është dhoma e gjumit, zakonisht e grave, e vendosur në katin e sipërm të banesës. Është vendi i bashkimit të fshehtë seksual mes një hyu dhe një gruaje të vdekshme, edhe në XVI, 184 etj.

⁴ 519. Pausania (*Fokika*, 36, 5) thotë se *K(Q)iparisi* i Homerit është Antikira (Shtëpitë e Bardha, *Ασπρα Σπίτια*) gjendet përballë rrënojave të Medeonit. Edeoni është përcaktuar me siguri në një ullishtë dhe në një pronë (bregdetare) të manastirit të Osíu Luka, që u tjetërsua më 1962 për hir të fabrikës së aluminit. Hapësia e kësaj prone edhe sot është e njohur si Elukaitiko.

⁵ 521. *Anemoria* dhe e mëvonëshmjia *Anemolia*, qytet i Fokidës, pranë Delfit. Pausania (X, 35, 5): Në *Iampol* ishin strehuar iantët (Υάντες), të cilët kishin ikur nga Teba prej Kadmit dhe ushtrisë së tij. Më herët nga fqinjët quhej “Qyteti i inateve”. Por më vonë mbajti emrin Iampol.

⁶ 523. Nga Lilea buron *Kifisoí*. Gjendet 4 km. nga fshati Agoriani. Lumi para se të hyjë në Beoti, kalon menjëherë në anën lindore të Dadiusë (Amfiklea) dhe është i njohur si lumi i Dadiusë. Në Beoti kalon në lindje të Keroneas dhe ndjek një drejtim për nga lindja, përgjatë gjatësisë së malit Akontio gjer në atë të Orkomenit, i cili ka skajin e Akontios. Prej andej dikur bashkohej me lumin

dhe kishin Lilean, mbi burimin e Kefisosë,
 të gjithë këta dyzet anije të zeza i ndiqnin,
 radhët e fokeasve rreshtonin krerët 525
 pranë beotasve, majtas tyre, të armatosur.
 Lokrëve në krye ishte Ajaksi i shpejtë i Oileut,
 më i pakët, jo kaq i madh sa Ajaksi i Telamonit,
 shumë më i pakët, madje i vogël e me mburojë liri,¹
 po në hedhjen e heshtës mundte panhelenët² e akejtë. 530
 Ata banonin Kinon,³ Opuntin dhe Kiliarën,
 Vishën⁴ e Skarfin⁵ dhe Augjan e dashur,

Melana, që lind para Orkomenit dhe drejtohej nga Kópet dhe për nga tej llagëmeve të Kópeve. Në rajonin e Kópeve, llagëmet nuk mund të pranenin të gjithë ujin, formohej liqeni, i cili gjithnjë kishte më shumë ujëra në anën veriore të tij.

Pausania: (Fokiket, 3, 1): (Më 38 p.e.s.), *Filipi i Maqedonisë* i dha fund Luftës së tretë të Shenjtë, kur arhond i njohur në Athinë ishte Teofili, gjatë vitit të parë të Olimpiadës së njëqind e tetë, gjatë së cilës Polikël Kireneu fitoi garën e vrapimit. Qytetet e Fokëve, që u pushtuan, u rrafshuan. Mes tyre Lilea, Iampoli, Antikira, Parapotamejtë, Panopeu dhe Daulida. Ata ishin të dëgjuar qysh nga koha e vjetër, nga vetë poemat e Homerit.

¹ 529-530. Këto dy vargje ishin shfuqizuar nga gramatikani Aristark për tre motive: 1) për rëndimin e tepruar në përshkrimin e shtatit të Ajaksit; 2) për atribuimin Ajaksit të një korace lini, që i përshtatej më mirë përshkrimin të lokrezëve si trupa me armatim të lehtë, por kontraston vendosmërisht me përdorimin e heshtës (të një arme të rëndë), ku Ajaksi kishte vendin e parë; 3) për praninë e fjalës “panhelenë”, që përfshin përhapjen e ardhshme të fjalës elines, helenë, për të treguar gjithë grekët, ndërsa është e sigurt që të Homeri fjalët elas apo elines, u referohen ende përkatësisht vetëm rajonit dhe banorëve përreth Ftias (shih dhe v. 683 etj.).

² 530. Panhelenët, *gjithe helenët*. Shenjë karakteristike që nga disa është konsideruar si shtojcë e mëvonshme. Se Homeri nuk u referohet helenëve si kombësi, por i quan me atë kuptim që ka emri akej, danaj dhe argej. Ekzistonte në Ftia një qytet me emrin (H)elas, banorët e të cilit thirreshin (h)elenë, por ky karakterizim nuk shtrihet në Heladën tjetër (Greqi), që sipas Homerit quhej Argos... (shënim i K. Dukas).

³ 531. *Kinos*, skela, porti më i rëndësishëm tregtar i të gjithë lokrëve. Lashtësia e Kinosit duket nga gojëdhëna se atje kishte banuar Deukalionin dhe Pirra. Madje atje, në kohën e Strabonit (9, 425), ekzistonte varri i Pirras. Straboni e përcaktonte vendndodhjen e Kinon në skajin verior të gjirit të sotëm të Atalantës (Opuntisë), në largësi 60 stade (mbi 10 km.) nga Opunta, përballë Edipsos. Shton se ekziston ‘mes Opuntës dhe Kinon një fushë e begatë’. Kështu, Kinosit i shënohen rrënoja në largësi të vogël më në veri të fshatit të sotëm Livanates.

⁴ 532. Emrin e qytetit të Lokridës, *Visha* (Βῆσσα), e kemi vënë të përputhur me origjinalin (e jo sipas variantit italisht të Rosa Calzecchi Onestit dhe të Giovanni Cerrit, që do të ishte Bessa), edhe për nostalgji, meqë një grykë në përroin e Himarës, mban po këtë term homerik: **Visha**.

⁵ 532. Pausania (Libri X, *Fokiket*, 1, 2), e përmend me emrin *Skarfeia*. Mbante (sipas Strabonit, *Gjeografiket*, 9, 426), dhjetë stade (më pak se dy km.) nga gjiri Maliakó. Gjendej afër fshatit të sotëm Skarfeia, në lindje të Termopileve dhe të fshatit Molos, dhe në perëndim të Kamenon Vurlon.

dhe Tarfin e Tronion, mbi rrjedhën e Boagrit,
dhe atë dyzet anije krejt të zeza e ndiqnin
të lokrezëve, që rronin përballë së shenjtës Eubè. 535

Ata që kishin Eubenë, abantët që frymonin mëri,
dhe Kalkidën e Eretrian dhe Istiean me shumë vreshta,
dhe Kerintin buzëdetit dhe qytetin e lartë të Dionit,
dhe ata që kishin Karistin e në Stira banonin,
atyre në krye ishte Elefënor, filiz i Aresit,¹ 540

Kalkodontiadi, prijës shpirtmadh i abantëve.
Atë e ndiqnin abantët e shpejtë flokëlëshuar gjer në zverk,
heshtarë të gatshëm me shtizat e gjata prej frashëri
të thyejnë koracën rreth gjoksit të armiqve,
atij dyzet anije krejt të zeza i shkonin prapa. 545

Dhe ata që kishin Athinën, qytet të mirëndërtuar,
popull i shpirtmadhit Erekte,² që dikur Athinaja
e rriti, e bija e Diosit - e lindi toka jetëdhënëse -
e në Athinë e vuri, brenda tempullit të saj të pasur,
atje me dema e qengja i kërkojnë mëshirë 550

të rinjtë e athinasve atij vit pas viti;
në krye të tyre ishte i biri i Peteut, Menesteu,
kurrë në tokë nuk lindi njeri me të i ngjashëm
për të renditur kuaj dhe njerëz mburojëmbajtës;
vetëm Nestori matej me të, se ishte më i moshuar; 555

atë pesëdhjetë anije të zeza e ndiqnin nga pas.
Ajaksi nga Salamina u printe dymbëdhjetë anijeve,
dhe i vuri në radhë pranë falangave të athinasve.
Ata që kishin Argon dhe Tirintin e murosur,
Ermionin dhe Asinën, që kanë gjire të thellë, 560

dhe Trezinën, Eionën, Epidaurin mbjellë me vreshta,
dhe ata që kishin Eginën e Masetën, të rinjtë e akejve,

¹ 540. Formulë shumë e zakonshme, e interpretuar tradicionalisht si filiz, degë (nip, stërnip) i Aresit.

² 547-551. Erekteu, hero athinas, fillimisht i padalluar nga Erektionio, kishte lindur nga toka e mbjellë nga fara e Hefestit, kur ishte përpjekur të zinte Athinanë. Referimi te v. 551 është te festat vjetore më vonë të quajtura “Atenetë e vogla” në kundërvënje me “Panatenetë e mëdha”, të festuara qysh nga 566-565, çdo katër vjet me madhështi shumë më të bujshme. Bëhej fjalë për festimin më të madh fetar të qytezës athinase, origjina e së cilës ngjitej gjer te Tezeu dhe te vetë Erekteu, që përmendet këtu.

këtyre në krye ishte zëgjëmuesi Diomed
dhe Stèneli, bir i shtrenjtë i Kapaneut të lavdishëm,
i treti Euriali shkonte me ta, vdekatar baras hyjni, 565
bir i Mekisteut, mbret i Talanoidës;
por mbi të gjithë printe zëgjëmuesi Diomed
dhe ata tetëdhjetë anije të zeza i ndiqnin.
Ata që kishin Mikenën, qytet i mirëndërtuar,
Korintin e pasur dhe të mirëndërtuarën Kleonë, 570
dhe banonin në Ornea dhe në Aretirean e dashur,
e në Sikionë, atje ku mbretëroi në fillim Andrasti,
e ata që Iperesian dhe Gonoesën përgjelartë
dhe Pelenin kishin, e rreth Egiut banonin
dhe në tërë Egjalin e përreth Elikit të gjerë, 575
ndër ta me njëqind anije printe Agamemnoni i fuqishëm,
Atridi, me të të shumta dhe fisnike
aradhe vinin; dhe ai ishte veshur në bronz vetëtitës
dhe shkonte krenar, mes gjithë heronjve i parë,
se më i forti ishte, e printe popuj të shumtë. 580
Ata që kishin Lakedemonin e lugët,¹ gjithë gryka,
dhe Farin e Spartën dhe Mesin e pasur me pëllumba,
dhe në Brisea banonin e në Avgean e dashur,
që kishin Amiklën e Elon, qytet buzë detit,
që kishin Laan dhe banonin në Etilo, 585
atyre u printe i vëllai, zëgjëmuesi Menelá,
me gjashtëdhjetë anije; dhe mënjanë ngjishnin armët,
në mes lëvizte ai, me besim në kurajën e tij
dhe i nxiste për luftë; e shumë i ziente në zemër
të shpaguante rënkimet dhe brengën e Helenës. 590
Dhe ata që rronin në Pilo² dhe në Arenin e dashur,
e në Trio, në vaun e Alfeut dhe në Epiun e mirëndërtuar,
dhe Kiparisuntën e Amfigenian banonin,
dhe në Pteleón e Elos dhe Dorion, atje ku Muzat

¹ 581. Në origjinal: Κοίλην Λακεδαίμονα, *Lakedemonia grykëthellë*, e lugët.

² 591. *Pilosi* homerik ishte një qytet më në veri sesa i sotmi, pothuaj në deltën e Alfut dhe në lartësinë e Pigos së Ileas.

takuan Tamirin¹ trakas dhe ia prenë këngën 595
 tek kthehej nga Ekalia, nga Eurit Ekaleu;
 se rrinte e mburrej që do të fitonte dhe nëse ato,
 Muzat, do të këndonin, bijat e Zeusit mburojëmbajtës,
 por ato të zemëruara e verbuan dhe këngën
 hyjnore ia morën dhe e bënë të harronte t'i binte qestes; 600
 këtyre në krye ishte kalorësi gerinias Nestor;
 nëntëdhjetë anije të lugëta ai vinte në radhë.
 Dhe ata që kishin Arkadinë, nën malin e rrëpirtë të Kilenës,
 pranë varrit të Epitit, ku njerëzit luftojnë trup me trup,
 ata që banonin në Fene dhe në Orkomeno me shumë dele, 605
 dhe në Ripe e Stratë dhe në Enispen erërrahur,
 dhe kishin Tegean dhe Mantinean e dashur,
 dhe kishin Stimfalin dhe në Parrasia banonin,
 atyre u printe i biri i Ankeut, Agapenori i fuqishëm,
 me gjashtëdhjetë anije; dhe në çdo anije shumë 610
 heronj arkadë me përvojë lufte ishin ngjitur.
 Dhe u dha atyre vetë mbreti i burrave Agamemnon
 anijet kuvertëmirë, të kapërcenin detin e errët,²
 Atridi, se ata nuk i njihnin punët detare.
 Ata që banonin në Bupras e në Elidën e shenjtë, 615
 gjer atje ku Irmini dhe Mirsini i largët
 dhe krepin Olenia e Alesi i përmbyllnin,
 këtyre katër ishin krerë, dhe secilin burrë dhjetë
 anije të shpejta e ndiqnin dhe epej të shumë ishin ngjitur.

¹ 594-600. Erudicioni antik e vendoste Tamirin ndër më të lashtë poetë-këngëtarë (*domethënë që shoqëroheshin me qeste*), duke i atribuar kompozimin e një poeme për luftën e Titanëve kundër hyjnive; të tjerë, të keqkuptuar nga pjesa homerike, e konsideronin si kitarist të thjeshtë, pa shoqërim vokal. Legjenda e garës muzikore me Muzat gjendet dhe te Hesiodi, që në vend të Dorios në Meseni, e vendos në fushëtirën Dotia, në Tesali. Verbëria është e lidhur shpesh me aftësinë për të kënduar si në Greqi, edhe në kultura të tjera. Është në njëfarë mënyre një kundërpeshë që ndjekin hyjnitë për të dhënë përsosmërinë në këngë; ndëshkimi i dhënë Tamirit, që ka guxuar të sfidojë Muzat, konsiston pikërisht në këputjen e këtij ekuilibri: është i verbër dhe njëherësh i privuar nga arti në të cilin shkëlqente më parë.

² 613. οἴνοπα: epiteti i famshëm homerik për detin. Fjalë për fjalë: “i ngjashëm me detin”; por studiues të ndryshëm e interpretojnë: “i errët si vera”, i ndritshëm, i shkumëzuar. Dy herë (*Iliada*, XIII, 703; *Odisea* XIII, 32) οἴνοψ i atribuohet qeve të mbrehura në plug, referuar nga kritika ndërsjellë të ngjyra kuqalashë e lëkurës apo nga fakti që kur janë lodhur, qetë shkumëzojnë nga goja.

Atyre u prinin Amfimaku dhe Talpi, 620
 njëri bir i Kteatit, tjetri i Euritit, Aktorionët,¹
 dhe i treti printe Diori i fuqishëm, Amarinkeidi,²
 dhe i katërti Polikseni i ngjashëm me hyjnitë,
 djalë i Agastenit, mbretit Augeiad.³
 Ata nga Dulihi dhe Ekinadet, të shenjtët 625
 ishuj, që ndodhen tej detit përballë Elidës,
 në krye kishin Megin, me Aresin i ngjashëm,
 Fileidi, që e lindi kalorësi File⁴ nga Zeusi i dashur,
 i cili dikur emigroi në Dulihi, i meritur me të atin,
 këtë dyzet anije të zeza bashkë e ndiqnin. 630
 Odisea u printe kefalonitëve shpirtmëdhenj,
 ata që kishin Itakën dhe Neritin gjethefëshfërimë,
 dhe banonin në Krokile dhe në Egilipën e ashpër,
 dhe kishin Zakintin e banonin në Samo,
 dhe zotëronin sterenë e në brigjet përballë banonin, 635
 prijës i tyre ishte Odisea, i ngjashëm me Zeusin në urtësi,
 shkonin me të dymbëdhjetë anije me fajka të kuqe.⁵
 Etolëve në krye ishte Toanti, bir i Andremonit,
 dhe ata banonin në Pleuronë e Olenë dhe Pilenë,
 në Kalkidë buzë detit dhe në Kalidonën gurishtore; 640
 se më në jetë nuk ishin bijtë e Oineut shpirtmadhit,

¹ 620-621. Kteati dhe Euriti, vëllezër binjakë, heronj elej dhe veçanërisht epej, luftëtarë të fuqishëm, të shkathët, sidomos në ngjarjen e qerreve. Quheshin Molionë nga gjyshi nga e ëma dhe Aktorionë nga i ati i supozuar Aktor, emër që e morën dhe bijtë e tyre, Amfimaku dhe Talpi (bij të Aktorit, it. *Attoridë*: Aktoridët).

² 622. Bir i Amarinkeut.

³ 624. Bir i Augeias.

⁴ 628-629. Sipas burimeve të mëvonshme (Straboni etj.), Fileu hyri në konflikt me të atin Augia, mbret i Elidës, ngaqë ai ishte përpjekur të mashtronte Herakliun lidhur me shpërblimin e caktuar për pastrimin e stallave të tij. Ishte ky një nga mundimet (bëmat), që duhej nënshtruar Herakliu për t'u çliruar nga zgjedha e Euristeut. Në XIII, 692 e XV, 5519, Megeti është paraqitur si prijës i epejve, të përmendur më sipër si banorë të Elidës (v. 615), por mbase pushtonin edhe ishujt përballë Ekine, një nga të cilët është pikërisht Dulihi.

⁵ 637. *Anijet e Odisesë* (12), kishin bash të kuq, domethënë dalloheshin nga anijet e tjera të grekëve, që siç i përshkruan Homeri, ishin të zeza (*fajka*, faqja anësore e anijes ose e lundrës). Odisesë i shënohen kësisoj pak anije, në krahasim me dyzet të Meges, hero jo ndër të mëdhenjtë, se në këtë rast, poeti ka dashur t'i përmbahet numrit të rrëfyer në poemën *Odisea*, IX, 159.

as ai vetë s'rronte më, kishte vdekur Meleagri flokëverdhtë;¹
 atij pra, iu dha sundimi të mbretëronte mbi gjithë etolët,
 dyzet anije të zeza e ndiqnin nga prapa.
 Kretasve u printe Idomeneu i lavdishëm në heshtë, 645
 e ata kishin Knosòn dhe Gortinën e murosur,
 Liktin, Miletin dhe Likastin me gurin e bardhë,²
 Festin, Rition, qytete të shumëpopulluara
 dhe të tjerë në Kretën me njëqind qytete;³
 ndër ta sundonte Idomeneu në heshtë i lavdishëm 650
 dhe Merioni, i ngjashëm me Enialin⁴ burrëvrasës;
 ata tetëdhjetë anije të zeza i ndiqnin pas.
 Tlepolem Herakliidi, i hijshëm dhe shtatmadh,
 nga Rodi, u printe nëntë anijeve të rodasve krenarë,
 që banonin në Rodos ndarë në tre vendbanime, 655
 Lindi, Iálisi dhe në Kamiron me gurin e bardhë.
 Mbi ta mbretëronte Tlepolemi në heshtë i lavdishëm,
 që Astiokea ia lindi forcës së Herakliut,⁵
 e kishte marrë nga Efra, nga lumi Selënt,
 pasi rrafshoi shumë qytete burrash hyjnimëkuar. 660
 Tlepolemi kur u rrit mes pallatit të mirëndërtuar,⁶
 vrau dajën e shtrenjtë të atit të tij,
 Likimnin tashmë plak, pasardhës të Aresit.

¹ 642. Meleagri, hero i famshëm i Etolisë, ndodhitë e të cilit rrëfehen në IX, 543 etj.

² 647. Më saktë, sipas Fjalorit Homerik të Pantazidit, është: argjilore.

³ 649. *Kreta e njëqind qyteteve*: tek Odisea, XX, 174, thuhej se ky ishull kishte nëntëdhjetë qytete, një mospërkim të shënuar nga antikët dhe veçanërisht nga Χωριζοντες (ndarësit), në përpjekjen e tyre për të hequr *Odisenë* nga atësia e Homerit. Në të vërtetë si në njërin dhe në tjetrin rast, bëhet fjalë për një shprehje hiperbolike, që do të rrëfejë pasurinë dhe dendësinë e popullsisë së këtij ishulli, pa u krahasuar me numrin real të qyteteve të Kretës.

⁴ 651. Ενωαλίω ἀνδραειφόντη, *Eniali masakrues burrash*: është hy i luftës, specifikisht i britmës së luftës, i ngjashëm me Aresin, që shumë herë tek *Iliada*, është identifikuar si vetë Enial. Ka mundësi të bëhet fjalë për dy hyjni fillimisht të ndryshme, pastaj të nënshtuar një procesi njëjtësimi.

⁵ 658. βίη Ἡρακλεῖης, *forcës së Herakliut*, perifrazim për Herakliun, shih shënimin te XIII, 248.

⁶ 661-668. Kush kishte kryer një vrasje dhe donte të shmangte hakmarrjen e të afërmve të të vrarit, duhej të shkonte në ekzil dhe të gjente në një tjetër qytet ndonjë zotëri që ta nënështronte në ritualin e pastrimit apo ta mikpriste. Tlepolemi, bir i denjë i Herakliut, gjen një zgjidhje më mbretërore: mbartet me ithtarët e tij në një zonë të pabanuar të Rodit, themelon tre qytete të rinj, Lindin, Ialisin e Kamirin dhe vetiu bëhet sovran i tyre. Për të drejtën lidhur me krimet e gjakut te Homerit, shih edhe shënimin te IX, 632-636.

Dhe shpejt ndërtoi anije e mblodhi popull të shumtë e iku mbi det se e kanosnin të tjerët bij dhe nipër të Herakliut të fuqishëm.	665
Në Rod arriti pastaj duke u endur dhe me mundime, atje në tri ndeje u vendosën, sipas farefisit ¹ dhe u deshën nga Zeusi, që mbretëron mbi hyjni e njerëz dhe mbi ta pasuri të mahnitshme derdhi Kronioni.	670
Nireu prapë u printe tri anijeve simetrike nga Simi, Nireu, bir i Aglaisë dhe i mbretit Karop, Nireu, burri më i bukur që erdhi nën Ilion nga gjithë danajtë e tjerë pas Pelidit patëmetë, por ishte pa përvojë luftime dhe popull i pakët e ndiqte.	675
Atyre që kishin Nisirin, Krápatin, Kasin dhe qytetin Kos të Euripilit, ² dhe ishujt Kalidna, prapë në krye ishte Fidipi e Antífi, që të dy djem të Tesalit, mbret Heraklidit, ³ me ta rreshtoheshin tridhjetë anije të lugëta.	680
Tani gjithë ata që banonin në Argon Pelasgjike, ⁴ dhe ata që rronin në Alo e Alopi dhe në Trakinë, dhe kishin Ftian e Heladën me gratë e bukura, që quheshin mirmidonë dhe helenë ⁵ dhe akej, mbi ta dhe pesëdhjetë anije Akili ishte prijës.	685

¹ 668. Për institutin e tribusë, farefisit, shih shënimin te V, 363. Është i qartë aluzioni për strukturat triadike (treshe) tipike të dorëve, që gjithsesi nuk janë emëruar, sipas normave aedike-rapsodike për të shpërfillur në formulimet e qarta, realitetet e mëvonshme nga lufta e Trojës.

² 677. *Euripili* ishte bir i Poseidonit dhe Astipaleas, at i Halkiopit, mbret i meropëve në Ko. U vra nga Herakliu, kur ai po kthehej nga Troja, dhe me dredhi të Herës, u rrëmbye nga dallgët dhe doli në Ko. Herakliu, pasi vrau Euripilin, u martua me Halkiopin. Djalë i tyre ishte Tesali (Tesalos) dhe bij të Tesalit: Fidipi dhe Antífoi, tashmë prijës të koonëve (Κόων) dhe të banorëve të ishujve pranë, në Luftën e Trojës, në krah të Agamemnonit.

³ 679. Birit të Herakliut.

⁴ 681. *Argos pellazgjike*: i referohet rajonit tesalik përreth lumit Sperkio. Pellazgët tek *Iliada* janë një popull i Azisë së Vogël (shih v.840; X, 429), ndërsa te *Odisea* (XIX, 177) banojnë në Kretë, por ishte përhapur bindja se kanë qenë edhe banorët primitivë të Greqisë (Herodoti I, 56-58 etj). shih dhe shënimet te V, 108 dhe IX, 141.

Shih dhe Strabon, Libri V: Dhe Argosi pellazgjik, Thesalia quhet, ndërmjet grykëderdhjes së Pineut dhe Termopileve, gjer në malësi drejt Pindit, ngaqë në këtë vend ekzistonin pellazgët. Ndërsa Zeus Dodoneun, ky poet e quan pellazgjik: Ζευ, ἀνα, Δωδωναίε, Πελασγικέ ("Zot Zeus, dodonas, pellazgjik; shih: *Iliada*, XVI, 233).

⁵ 683-684. Te Homeri, termi Ἑλλάδα, Ἑλλάς (H)ellas i referohet një rajoni të Tesalisë që bënte pjesë në mbretërinë e Peleut, atit të Akilit. Helenë, Ἑλληνες (elines, elinas) janë banorët e tij.

Ata luftën e frikshme s'e kishin ndër mend,
 nuk kishte kush t'u printe rreshtave të tyre,
 se rrinte në anije hyjnori Akil këmbëshpejti,
 i zemëruar për vajzën flokëbukur Briseidë,
 që e kishte marrë nga Lirnesa, pas mundimesh të shumta 690
 pasi shembi Lirnesën dhe muret e Tebës;
 dhe Minitin¹ mposhti dhe Epistrofin, heshtëfortët,
 djem të mbret Evin Selepiadit.
 Për të rrinte brengosur, por shpejt do të ringrihej.
 Dhe ata që kishin Filakin dhe Pirasin e lulëzuar, 695
 rrethojë e shenjtë e Demetrës, dhe Itonën nënë të grigjave,
 dhe Atronën buzë detit dhe Pteleonin shtrat me bar,
 mbi këta propë sundonte Protesilau luftarak²
 gjersa rronte; por qysh atëherë e mbante poshtë dheu i zi.
 Prej tij, e shoqja, faqeçjerrë, në Filaki rrinte 700
 dhe shtëpia gjysmë e mbaruar; e vrau një burrë dardan,
 kur nga anija kërcente, më i pari nga akejtë.
 Vërtet pa krye³ nuk ishin, megjithëse dëshironin prijësin,
 ata i rendiste Podarki, pasardhës i Aresit,
 djalë i Ifikël Filakidit⁴ me delet e shumta, 705

¹ 692. Bashkëshorti i *Briseidës*, që e vrau Akili, kur pushtoi Lernisën.

² 698. *Protesilau*, bir i Ifikliut dhe Astiokës, hero i luftës së Trojës, nga Filaki i Tesalisë. Ishte prijës i tesalëve të Filakit dhe Pirasit, si dhe greku i parë, që vdiq në tokën e Trojës, duke u vrarë nga trojanët. Pas vdekjes adhurohej si hero në Eliuntë dhe Kersoniso (shih dhe *Iliada*, XIII, 681; XV, 705). Anija e Protesilaut ishte e para që trojanët u përpoqën t'i vënë zjarr, por i ndali Patrokli (shih: *Iliada*, XVI, 286).

Kur u vra Protesilau, prijës u bë vëllai i tij, Podarki, e bashkë me të, Medoni, vëllai nga babai i Ajaksit dhe bir jashtëmartese i Oileut, i cili ngaqë vrau vëllain e thjeshtës (nënës së Ajaksit), Eripodës, u vetë internua në Filaki të Ftiotidës (shih: *Iliada*, XIII, 692 etj.).

Pausania, 4, 2, 8: Poeti i Eposit të kiprionëve, thotë se bashkëshortja e Protesilaut, - i cili kur grekët arritën në Troadë, pati guximin të zbriste i pari, - quhej Polidora dhe ishte bijë e Meleagrit, birit të Oileut. Pas vdekjes së tij, bashkëshortja u vetëvra (Homeri e përshkruan, - ἀμφιδουρής ἄλοχος, - ajo që duke qarë gërvishte faqet).

³ 703. *Krye*, kreu, prijës, udhëheqës.

⁴ 705. *Filaki*. Gjysh i Protesilaut; ishte bir i Dionit dhe i Diomedës, at i Ifikliut. Themelues i Filakit, qytet i Ftiotidës (shih dhe *Odisea*, XV, 231).

Gjatë fushatës ë Kserksit, përmendet nga Herodoti (8,39) se heroit Filaki dhe Antonoi, pronat e të cilëve ishin afër tempullit të Delfit, dëbuan persët, që shkuan për të pushtuar këtë shenjtërore. Pra, prona e Filakit ishte sipër tempullit të Pronaias, ndërsa e Antonoit pranë burimit të Kastalias, nën majën e Iampias.

vëlla me një baba e një nënë i shpirtmadhit Protesila,
më i ri në moshë; i parëlindur dhe më trim
heroi Protesila luftëtari; kështu popujt
nuk ishin pa prijës, por dëshironin atë më të fortin.

Atë e ndiqnin dyzet anije të zeza bashkë. 710

Por atyre që banonin në Fere, në liqenin Boibeida,
në Boibe dhe Glafirë dhe në Iaolkun e mirëndërtuar,
u printe biri i shtrenjtë i Admetit¹ me njëmbëdhjetë anije,
Eumeli,² që e lindi me Admetin një grua hyjnore,
Alkesti, më e bukura ndër bijat e Pelias. 715

Atyre që banonin në Metoni dhe Taumaki,
dhe kishin Melibeian dhe Olizonën gurishtore,
u printe Filokteti, mjeshër i harkut,
me shtatë anije; e pesëdhjetë rremtarë në secilën
u ngjitën, mjeshtra që luftonin fuqishëm me hark. 720
Por ai në ishull dergjej duke hequr mundime të mëdha,³

¹ 713. Për etimologjinë e emrit shih *Iliada*, XXIII, 266: Ἰππον ἔθηκεν ἔξέτε' ἀδμήτην βρέφος ἡμίονον καέουσαν; një pelë e pasbërur gjashtë vjeçe, që ndërmentë mushkë të lindte.

Pindari, i cili në Oden e 4-t *Pitike*, flet për këtë familje, thotë se *Admeti* ishte kushëri i Iasonit. I ati i Admetit, Feri dhe i ati i Iasonit, Iasoni, ishin vëllezër. Rrjedhimisht i biri i Admetit, Eumeli, dhe i biri i Iasonit dhe Ipsipilit, Eunio (mbret i Limnos gjatë luftës së Trojës, shih *Iliada*, VII, 468), ishin kushërinj të dytë.

Të shënojmë se, siç shkruan Pausania (Korintiaset 3:6), Feri ishte emri i njërit nga djemtë e Iasonit me Medean, i dyti quhej Mermer.

² 714. *Eumeli* ishte bir i Admetit dhe Alkestit, bijës së Pelias; është e njohur tragjedia e Euripidit me titull *Alkesti*. Tema e saj është vetëflimimi i bashkëshortes së Admetit për të shkuar vetë në Had në vend të tij, siç do të duhej. Këtë Admeti ia kishte thënë Apolloni, i cili për një kohë kishte shërbyer si bari në pallatin e tij, që të pastrohej nga vrasja e Qiklopëve, të cilët ishin përgatitësit e rrufeve të Zeusit.

Vrasja e Qiklopëve nga Apolloni u bë për hakmarrje të vrasjes së birit të tij, - Asklepit, - nga Zeusi, se kishte ngjallur një njeri me mjeshhtërinë shëruese që zotëronte. Kështu që Alkesti vdiq dhe në fund e risollë në jetë Herakliu, siç thotë tragjedia. Shohim se Homeri nuk përmend asgjë nga këto, vetëm se Alkesti ishte shumë i bukur, që do të thotë se në epokën homerike nuk ishte ndërtuar ende ky mit mbi ringjalljen, vrasjen e Asklepit, etj.

Tek *Odisea*, IV, 798, përmendet se Eumeli ishte martuar me vajzën e Ikarit (dhe motër e Penelopës), Iftimin. Që të dyja gratë, pra, Penelopa dhe Iftimi, ishin kushërira të Helenës, se Ikari ishte vëlla i Tindareut.

³ 721-725. Filokteti ishte braktisur në ishullin e Lemnos për shkak të erës së keqe që përhapej nga plaga e tij. Grekët do të *detyrohen* të kujtohen për të, pra të shkonin për ta marrë, nga një profeci që thoshte se Troja nuk mund të pushtohej pa harkun dhe shigjetat e Herakliut, që i zotëronte Filokteti. Këto fakte nuk do të rrëfohen tek *Iliada*, por në një poemë tjetër të ciklit trojan, *Iliada e Vlogël*, dhe do të rimerren edhe nga tragjikët (p.sh.: i famshmi *Filokteti* i Sofokliut).

në Lemnosin e shenjtë,¹ ku e braktisën bijtë e akejve,
i munduar nga plaga e ligë e një gjarpri uji të kobshëm;
ai dergjej atje i pikëlluar, por shpejt do të kujtoheshin
arcejt pranë anijeve për mbret Filoktetin. 725

Vërtet ata s'ishin pa prijës, po dëshironin kreun e tyre,
i rendiste Medonti,² biri jashtë martese i Oileut,
që Reni ia lindi Oile kështjellërrënuesit.
Ata që kishin Trikën dhe Itomin e rrëpirët,
dhe kishin Ekalinë, qytet i Eurit Ekaleut, 730
mbi ta mbretëronin dy djemtë e Asklepit,³
shëronjësit e mirë, Podaliri dhe Makaoni;
me ta radhiteshin tridhjetë anije të lugëta.
Ata që kishin Ormenin dhe burimin Iperea,
dhe kishin Asterin dhe majat e bardha të Titanit, 735
në krye kishin Euripilin, bir i lavdishëm i Evemonit,⁴
dyzet anije të zeza e ndiqnin nga prapa.
Ata që kishin Argisë dhe banonin në Girtonë,
në Orte dhe Elonë dhe në qytetin e bardhë Oloosonë,
mbi ta mbretëronte luftëtari i patrembur Polipet, 740
bir i Piritout, që e lindi Zeusi i pavdekshëm;
ia lindi Piritout Ipodamea e dëgjuar
ditën që ai ndëshkoi bishat leshtore,⁵
i dëboi nga Pelioni, i shtyu drejt etikëve,

¹ 722. Λήμνον ἠγροθέη, në *Lemnosin e shenjtë*: çdo qytet është i shenjtë në kuptimin që në të ngrihen shumë tempuj të hyjnive dhe hyjni të caktuara gëzojnë kulte të veçanta; edhe Troja është cilësuar përgjithësi e shenjtë tek *Iliada* (shih Ἴλιος ἱερὴ te IV, 46, 164; VI, 448, XX, 216; XXIV, 27 etj.). Lemnosi, ishull vullkanik, ishte i shquar në nivel panhelenik për kultin e Hefestit, të Tokës dhe të Kabirëve. Në Lemnos shkoi hyjneshë Hera për të takuar hyun Hypnos (shih: *Iliada*, XIV, 230 etj.). Lemnosi ishte qyteti i Toantit, të cilin e kishte vendosur atje Radamanti. Mbret i Lemnos tani ishte Evini, bir i Iasonit dhe i Ipsipilit, bijë e Toantit (shih: *Iliada*, VII, 467 etj.), i cili bënte tregti me akejtë, që rrethonin Trojën (shih: *Iliada*, XXI, 40 etj.)

² 727. Medonti, megjithëqë ishte lokrez, ishte transferuar në veri të Greqisë, në vijim të një krimi vrasjeje, shih te XIII, 694-697.

³ 729-733. Në Greqinë arkaike Asklepi nderohej si hero mjek. Kult i tij shpesh shoqërohej me atë të Apollos, hy shërues, biri i të cilit mbahej. Opinioni se ishte një hy duket se është afirmuar jo më parë se shek. V në Epidaur e prej andej u përhap në gjithë botën greke.

⁴ 736. Sipas Strabonit (Libri VIII), *Euripili*, bir i Eumonit, ishte kushëri i Fenikës, mësues i Akilit.

⁵ 743. *Bishat leshtore* (Centaurë). Në tekst: Firas (ΦΗΡΑΣ = τους Φήρες, ashtu quanin centaurët). Pra, Homeri i emërtonte bisha (egërsira) dhe shoqëron emrin me mbiemrin lahnientas (ΛΑΧΝΗΝΤΑΣ), leshtore, me lesh.

jo vetëm, bashkë me të Leontiu, pinjoll i Aresit, bir i shpirtmadhit Koron Keneidit; këta bashkë dyzet anije të zeza i ndiqnin. Guneu nga Kifoja u printe njëzet e dy anijeve dhe e ndiqnin enienët dhe peribejtë trima, ¹	745
që përreth Dodonës dimërkeqe ngritën shtëpitë, ata që kultivonin fushat përreth Titaresos së dashur që te Peneu derdh ujërat, rrjedhat e bukura, por nuk përzihet me Peneun valë argjendi, i rrjedh përsipër, porsi vaj ulliri, se është degë e Stigës, ² ujit të tmerrshëm të betimit. Magnitëve në krye ishte Protou, bir i Tentredonit, që përreth Peneut dhe Peliut gjethedendur banonin; dhe Protou i shpejtë u printe e bashkë me të dyzet anije të zeza vinin. Këta ishin krerët dhe prijësit e danajve, ³	750
Po cili më i miri mes tyre ishte, ma thuaj, Muzë, ⁴ mes tyre e mes kuajve, që ndiqnin atridët. Pelat më të mira ishin të Feretiadit, ⁵ dhe i ngiste Eumeli, të shpejtë posi zogj,	755
	760

¹ 749-754. Dodona ishte një faltore dhe orakull i rëndësishëm i Zeusit, ku përgjigjet e orakullit nxirreshin nga fëshfërima e gjetheve të një lisi të shenjtë. Gjendej në Epir, 18 kilometra në jug të Janinës së sotme (shih *Odisëa*, XIV, 327-329). Lumi Pene lind nga rrëza e Pindit, pra jo larg Dodonës, për të përshkuar pastaj Tesalinë dhe për t'u derdhur në gjirin e Selanikut. Probleme të ndryshme topografike janë ngritur në raport me identifikimin e lumit Titaresos, Τίταρησός (apo Τίταρησιον sipas leximit përcjellë nga kodikët) dhe të ndejave të enienëve dhe peribejve, popullata tradicionalisht të lidhura me Tesalinë, jo me Epirin.

² 755. Stiga është lumi skëterror, mbi ujërat e të cilit betoheshin hyjnitë (shih XIV, 271; Hesiodi, *Teog.*, 782-806). Në veri të Arkadisë gjendej një burim i quajtur Styx, që banorët e vendit mbështesnin se brofte nga lumi skëterror dhe se në ujërat e tij bënin betimet më solemne (Herodoti, 6, 74).

³ 761. Homeri, pasi bëri përshkrimin e ushtrive greke, do të na thotë, me ndihmën e Muzës, cili nga burrat dhe cili nga kuajt ishte më i miri. Ngaqë përmend kalin më të mirë, kjo tregon se u jepnin rëndësi të jashtëzakonshme kuajve, domethënë racës së tyre, si dhe stërvitjes.

⁴ 760. Numri i përgjithshëm i anijeve është 1.180. Numri i njerëzve, i llogaritur nga antikët, është 120.000, nga Aristarku në veçanti, 142.300.

⁵ 763- 767. Feretiadi është Admeti, bir i Feretit. Ngaqë Admeti tashmë kishte vdekur, pelat e tij i përkisnin të birit, Eumelit (shih më lart, 711 etj.). Ato ishin rritur nga Apolloja, se hyu kishte kaluar një vit në shërbim të Admetit si bari. Lokalizimi ἐν Πηλοῖη “në Perea” duhet t'i referohet vendit të Ferës ku mbretëronte Admeti. Kjo formë është përcjellë edhe nga papirë dhe vërtetohet dhe nga Stefani i Bizantit.

të njëjtë në moshë, në qime dhe në lartësinë e shpinës, 765
 në Perea i kishte rritur Apolli harkargjendtë,
 të dyja femra, që mbartnin tmerrin e Aresit.
 Nga burrat i madh e i shquar ishte Ajaks Telamoni
 gjersa Akili ishte i meritur, se shumë më i fortë ishte ai,
 si dhe kuajt që mbartnin Pelidin e pashoq. 770
 Por ai tek anijet e lugëta, që shkojnë nëpër det,
 rrinte, i zemëruar me bariun e popujve Agamemnon,
 Atridin; dhe popujt¹ përgjatë buzë detit,
 me disqe zbavitëshin dhe me heshtat që hidhnin
 dhe shigjeta; dhe kuajt, pranë qerres së secilit, 775
 duke ngrënë tërfil² dhe selino rritur moçaleve
 rrinin; qerret e prijësve të mbuluara mirë qëndronin
 në çadra; e ata dëshironin prijësin e tyre të dashur nga Aresi
 duke u endur këndej-andej nëpër kamp pa luftuar.
 Të tjerët shkonin sikur zjarri të kulloste gjithë vendin, 780
 e toka rënkonte nga poshtë, ashtu sikur Zeus rrufehedhësi
 inatoset dhe kamzhikos tokën e Tifòeut³
 në Arimi, ku thonë se shtrati i Tifòeut gjendet,
 kështu nën këmbët e tyre toka rënkonte thellë
 tek shkonin përpara dhe fushën kalonin shumë shpejt. 785
 Dhe erdhi lajmëse te trojanët Iri si e shpejtë me këmbë ere⁴

Një interpretim alternativ, përcjellë nga pjesa më e madhe e kodikëve, është ἐν Πιερίῃ, “në Përia”: bëhet fjalë për ndejën e famshme të Muzave e ndonjëherë dhe të Apollit, që nga ana tjetër nuk do të ketë lidhje me legjendën e Admetit, princ i Feres. (Ky shënim është marrë nga botimi: *Omero, ILLADE, Nona edizione BUR Classici greci e latini novembre 2015*).

¹ 773. *Popujt*: njerëzit, luftëtarët e Akilit.

² 776. Në original: λωτός, *lotus*, një lloj tërfili, “bar”. Ndërsa botimi i *Einaudit* përdor fjalën “loto”, ai Bur përdor fjalën “meliloto”, makth, bimë e ngjashme me trëndelinën, që bën lule me erë si të mjaltit.

³ 782-783. *Tifjeu* a *Tifju* ishte një përbindësh i pajisur me njëqind kokë gjarprinjsh, që shfrynin zjarr; fantazia e antikëve i atribuonte atij fenomenet vullkanike. Lindur nga Gea (Toka) si sfidë e fundit ndaj marrjes së pushtetit nga Zeusi, u godit me rrufe nga ky i fundit, u flak në brendësi të tokës dhe u lidh në një shtrojë të gurtë. Vendi i arimëve është identifikuar me një rajon vullkanik të Kilikisë, Lidisë a Sirisë (Straboni, 13, 4, 6). Një lokalizim i shquar tjetër i përbindëshit mitik ishte në Sicili, në rropullitë e Etnës.

⁴ 786. ποδῆνεμος ὠκέα Ἴρις, *Irisi e shpejtë që ka në këmbë erën*: epitet që lidhet me funksionin e Irisit si lajmëtare e hyjnive, që fluturon shpejt si era për të shpënë mesazhet e tyre gjer në vendndodhjet më të largëta. Artet figurative e paraqesin si një vajzë me krahë (fluturake).

dërguar nga Zeusi mburojëmbajtës, me lajmin e hidhur;
 ata ishin mbledhur në kuvend te portat e Priamit,
 të gjithë bashkë, të rinj e pleq,
 duke qëndruar pranë tyre këmbëshpejta Iris, foli; 790
 ngjante¹ në zë me të birin e Priamit, Politin,
 që kishte ndenjur rojë e trojanëve, me besim te këmbët e shpejta,
 në majë të varrit të plakut Esiet,²
 duke pritur kur do të dyndeshin nga anijet akejtë.
 E ngjashme me të, Iris këmbëshpejta tha: 795
 “O plak, ty gjithnjë të pëlqejnë fjalët e ëmbla pa fund,
 si dikur në paqe, por një luftë e paepur u ngrit,
 në shumë beteja burrash mora pjesë gjer tani,
 por kurrë të tillë s’pashë dhe kaq popull,
 se shumë përngjajnë me gjetet dhe kokrrat e rërës 800
 tek vijnë nëpër fushë të luftojnë kundër qytetit.
 Hektor, ty të drejtohem më tepër e kështu të bësh:
 Besëtarë të shumtë janë në qytetin e madh të Priamit,
 dhe secili nga fiset e ndryshme të njerëzve ka gjuhën e vet,³
 pra, çdo burrë t’u japë shenjë atyre në krye të cilëve është, 805
 dhe me rregull qytetarët të prijë në luftë”.

Kështu tha dhe Hektorit s’i shpëtoi që foli hyjnesha,
 shpërndau menjëherë kuvendin, vrapuan nën armë,
 u hapën gjithë portat, populli u derdh jashtë,
 këmbësorë e kalorës, një trazirë e madhe u ngrit. 810
 Një kodrinë e lartë gjendet përpara qytetit,
 fushës mënjane, që mund të përshkohej ngado,

¹ 791. *Përngjasim*. Ky është një nga fenomenet më të rëndësishëm të *Iliadës*. Domethënë, hyjnitë, ndërsa shfaqen dhe njihen e flasin drejtpërdrejt me grekët, kur duan të komunikojnë me trojanët, marrin trajtë njerëzore (zakonisht të ndonjë trojani apo besëtarë të tyre) për të folur. Kjo gjë ndodh gjatë gjithë rrëfimit të *Iliadës*.

Te grekët diçka e ngjashme ndodhi në rastin e *Ëndrësmashtruese* (së gënjeshtërt) tek Agamemnoni gjatë gjumit të tij, kur hyu Oneiros (Ëndrra) mori trajtën e Nestorit (*Iliada*, II, 20).

² 793. Esiet është një personazh i panjohur, me siguri i ndryshëm nga i ati i Alkatout me të njëjtin emër, i përmendur në XIII, 427.

³ 804. Në *kampin trojan*, çdo popull fliste gjuhën e tij. Në të kundërt, në kampin grek, nuk ndodh diçka e tillë, ndryshe do ta kishte thënë Homeri.

të cilën njerëzit e thërësin Batiea,¹
dhe të pavdekshmit Varr i Mirinës truphedhurës,²
atje atëherë u rreshtuan trojanët dhe besëtarët. 815
Trojanëve u printe Hektori³ i madh përkrenaretundës,⁴
bir i Priamit, bashkë me të popull i panumërt
e më të mirët armatoseshin të etur të ndeshen me heshta.
Dardanëve⁵ prapë u printe i biri i ndritshëm i Ankizit,
Enea,⁶ që Ankizit ia lindi Afërdita hyjnore, 820
mes grykave të Idës, një hyjneshë fjeti me një vdekatarr,
jo vetëm, bashkë me të dy bijtë e Antenorit,⁷
Arkelokun dhe Akamantin, mjeshtra në çdo luftim.
Ata që banonin në Zelean e largët, rrëzës së fundit të Idës,

¹ 813. Apollodori 12-5: Nga Elektra, bijë e Atlantit (Elektra ishte një nga Plejadat; nënë e saj ishte Pleioni, vajzë e Oqeanit), dhe Zeusi lindën dy djem, Iasoni dhe Dardani. Iasoni u dashurua me hyjneshë Demetrën dhe deshi ta turpëronte, prandaj u qëllua me rufe. *Dardani*, i brengosur nga vdekja e të vëllait, braktisi Samotrakën ku banonin dhe shkoi në bregun përballë ku mbretëronte Teukri, bir i Skamandrit dhe i nimfës Idea, prandaj dhe banorët e krahinës quheshin teukër. Mbreti e mirëpriti Dardanin dhe i dha për grua të bijën, Batia. Kur vdiq Teukri, vendi u emërua *Dardania*. Dardani dhe Batea bënë dy djem, Ilon dhe Eriktonin.

² 813-814. Mbi problemin e përgjithshëm të gjuhës së hyjnive dhe të njerëzve, shih më sipër te shënimi I, 403-404. Lidhur me këtë rast të veçantë, *Batieia* do të thotë “kodra e manaferrave” (βᾶτος = manaferrë); *Mirina*, sipas komenteve antike ishte një nga amazonat që shkelën Frigjinë (shih III, 189 dhe shënimin përkatës). Është eponim (*personazh historik a mitik që i jep emrin një qyteti, fisi* etj.) i qytetit me të njëjtin emër të Lemnos; në mënyrë analoge edhe qytetet Kuma dhe Smirna njihnin te dy Amazonat eponimet e tyre.

³ 816. Fillon *katalogu trojan* renditur kështu: Forcat trojane në kuptimin e ngushtë, dmth. banorët e Trojës-Ilion komanduar nga Hektori; dardanët komanduar nga Enea (v. 819 etj.), aleatët e Troadës (824 etj.) dhe aleatët e tjerë nga Evropa dhe Azia (v. 844 etj.).

⁴ 816. κορυθαίολος “Εκτωρ, *Hektori me përkrenaren valëzuese*: formulë e përbërë nga emri dhe epiteti, që përmendet herë pa fund tek *Iliada*. Epiteti aludon te valëzimi i jeles së kalit që vihej në kreshtë të helmetës kur luftëtari është në aksion: kuptimi i saj është ilustruar shumë mirë nga pjesë si XV, 608-610 dhe XIX, 382 etj.

⁵ 819-820. Ankizi dhe Enea përfaqësojnë degën e vogël të shtëpisë së Dardanit. Janë pasadhës të Asarakut, vëlla i Ilos (themelues i Ilios-Troja) dhe banojnë ende në Dardani rrëzë malit Ida (shih rrëfimin gjenealogjik bërë nga vetë Enea Akilit, XX, 215 etj.). *Dardanët*, Δαρδανίων, rrëfen banorët e Dardanisë.

⁶ 820. *Enea* ishte bir i Afërditës dhe i Ankizit. Afërdita kishte marrë mollën e artë nga Pari, duke i premtuar atij si shpërblim Helenën argite, gruan e Menelaut. Siç thotë Herodoti, *Afërdita Uranian*, me emrin Alila, e adhuronin fiset arabe.

⁷ 822. *Antenori* në rendin e Trojës ishte i dyti pas Priamit. Kishte për grua Teanonë, bijë e Kiseut, e cila ishte priftëreshë në tempullin e Athinasë, që gjendej në Akropolin e Trojës (shih: *Iliada*, VI, 297).

- të pasur, që pinin ujin e zi të Esepit, 825
trojanë, atyre u printe i biri patëmetë i Likaonit,
Pandari,¹ të cilit edhe hark i dha vetë Apolloni.
Ata që kishin Adrastean dhe vendin e Apesit,
dhe Pitiean kishin dhe malin greminëthellë² të Tereas,
atyre u printe Adrasti dhe Amfi, thurak liri, 830
të dy bij të Merop Perkosiut, i cili mbi të gjithë
njihte profecitë dhe as nuk i linte të bijtë
të shkonin në luftën popullrrënuese; por ata
nuk iu bindën; se Keret i zvarritën në vdekjen e zezë.
Ata që rrinin përreth Perkotit dhe Praktit, 835
dhe Sestin e Abidin kishin dhe hyjnoren Arisbi,
atyre prapë Irtakidi u printe, Asi, prijës burrash,
Asi Irtakidi, që nga Arisbi solli kuaj
të vrullshëm, të mëdhenj, nga lumi Selleent.
Ipotou u printe fiseve heshtarë të pellazgëve, 840
që banonin në Larisën pjellore;
këtyre në krye ishin Ipotou dhe Pileu, filiz i Aresit,
të dy bij të Leto Teutamidit pellazg.
Akamanti dhe heroi Pirou u printe trakasve,
gjithë sa Helesponti me dallgët e fuqishme mbyll në vetvete. 845
Eufemi ishte në krye të kikonëve armatosur me heshtë,
bir i Trezen Keadit hyjnimëkuar.

Ngaqë ai mikpritri Menelaun dhe Odisenë, kur kishin shkuar në Trojë për të marrë Helenën në mënyrë paqësore, gjatë luftës trojane, nuk e prekën shtëpinë e tyre, duke respektuar ritin e “ksenias” (mikpritjes), që i lidhte. Antenori dhe Teanoi, bashkë me familjen e tyre, pas luftës së Trojës, u lanë të lirë nga grekët. Udhëtari Pausania, në librin X, Fokika, Kap. 27, 4, duke përshkruar pikturën e Polignotit, që ekzistonte në Delf dhe pasqyronte pushtimin e Trojës, përmend se ishte paraqitur edhe familja e Teanosë dhe Antenorit, duke ngarkuar gjërat e domosdoshme në një gomar dhe të përgatiteshin për të ikur në Trakë (ku gjendej i ati i Teanosë, Kiseu).

¹ 827. Në librin IV, 93-96, pas dyluftimit, që ishin vendosur për t'i dhënë fund luftës, mes *Aleksandrit* (Parit) dhe *Menelaut*; dhe ndërsa në fakt kishte fituar Menelau, hyneshë Athinaja, në trajtë të trojanit Laodok Antenoridi, iu afrua Pandarit dhe e bindi të qëllonte me hark kundër Menelaut, i cili priste i qetë me akejtë e tjerë që të gjykohej përfundimi i dyluftimit.

Shih: IV, 116-121: Pandari pas “këshillës” së Athinasë, përpiqet me harkun dhe shigjetat e tij të vrasë Menelaun. Ky veprim është fillimi i betejës së madhe akej-trojanë. Shigjetat e Pandarit duket se janë të zhytura në helm. Apolloni, që i dha harkun, ishte Apollon Likigenis (Likias), i Likisë.

840. *Pellazgët që banonin në Larisa* ishin në anën e trojanëve. Krahina e tyre ishte mes Trakës dhe Sisto-Abidos. Pothuaj mbi Helespont.

² 829. ... *greminëthellë*: i rrëpirtë, me hone.

Piraikmi prapë u printe peonëve harklakuar,
 larg nga Amidoni, nga Aksi rrjedhëmadhështor,
 nga Aksi, uji i bukur i të cilit shpërndahet përmbi tokë. 850
 Paflagonët i printe Pilemeni zemërburrërori,
 nga vendi i enetëve ku është fara e mushkave të egra,
 ata që kishin Kitorin dhe rrinin rreth Sesamit,
 dhe shtëpitë e dëgjua kishin qark lumit Parteni,
 dhe në Kromni e Agialò dhe në Eritinin e lartë. 855
 Alizonëve¹ prapë u prinin Odiu dhe Epistrofi,
 nga Alibi² i largët, vendi ku lind argjendi.
 Mísët në krye kishin Kronin dhe Enomin falltar zogjsh;
 por me profecinë e shpendëve s'i iku fatit të tij të zi,
 dhe ra nën duart e Eakidit këmbëshpejtë 860
 në lumë, ku vrau dhe kaq trojanë të tjerë.
 Forki u printe frigëve dhe Askani pamjehyjnori,
 nga Askania larg, që paduronin të luftonin trup me trup.
 Meonëve³ prapë ishin prijës Mestli dhe Antifi,

¹ 856. *Alizonë*. Bitinët, ngaqë vendi i tyre ishte rrethuar nga deti, si gadishull, nga Eukseini dhe Propontida. U quajtën kështu për krenarinë që kishin për pasurinë e tyre, me ndërrimin e a-së në i (mbase quheshin Alazonë). Sipas Iskios Alizonos = istëm.

² 857. Me të dhënë e vargut 857 se në krahinën fqinje të enetëve, *Alibin*, vendoset “vendlindja” e argjendit, nga mund të nxjerrim përfundimin se enetët dhe paflagonët ishin teknikë të mirë të arit e të argjendit, si duhet të jenë dhe alizonët (alizonos: lagur përreth nga deti).

Në Kapadoki ekziston qyteza Abeni (Αβενος, Avenos). Është e dëgjuar për qeramikën e saj që përgatitej me argjilë të kuqe, e cila gjendet në brigjet e lumit. Straboni përmend dherat Semiramide. Duhet të jetë e njëjta lëndë. Abeni gjendet afër qytetit Nebsehir, kryevend i Kapadokisë. Ekzistonin gjurmë njerëzore atje që para vitit 3000 p.e.s. Emri më i vjetër i Nebsehirit ishte Nissa. Në periudhën otomane u quajt Muskara. Abeni emërtohet dhe Venessa. Është në lindje të Ikonit në juglindje të Ankarasë. Pranë saj kalon Lumi i Kuq, Kizilirmak. Shumë afër është qyteti Derinkuyu, ku më 1968 u zbulua një bodrum i tërë me sistem banimi, që sot është me rëndësi për t'u parë. I përmendin si katakombe të të krishterëve, që rrinin atje për t'u mbrojtur nga romakët.

Kjo është krahina nga erdhën paflagonët si aleatë të trojanëve. E vërteton dhe qyteti që përmend Homeri në vargun 855 (libri II) ‘Erithinus’ (Ἐριθίνους), se eritheno (ερυθίνω) = skuq, përskuqet (shih libri XXI, 21).

³ 864. *Meonët* ishin ata që më vonë u emëruan lidë. Banonin në krahinën rreth Sardit, që në vitet homerike quhej Ida (XX, 385).

të dy bijtë e Talemenit, që i lindi liqeni Gigea,¹ 865
 ata u prinin meonëve, lindur nën Tmol.
 Nasti prapë u printe kariasve gjuhëbarbarë,²
 ata Miletin³ kishin dhe malin Ftiró shumëgjethesh,
 dhe ujërat e Meandrit dhe majat e rrëpirëta të Mikalit;
 Amfimaku dhe Nasti ishin në krye të tyre, 870
 Nasti e Amfimaku, bij të lavdishëm të Nomionit,
 që shkonte në luftë stolisur me ar porsi vajzë,
 i pamendi, se ai nuk arriti ta shpëtonte nga fundi i hidhur,
 por ra nën duart e Eakidit⁴ këmbëshpejtë
 në lumë, dhe floririn ia mori Akili trim. 875
 Sarpedoni u printe likiasve dhe Glauku i paqortueshëm,
 nga larg, prej Likisë, dhe nga Ksanti me shumë vorbulla.⁵

¹ 865. *Lindur të dy nga liqeni Gigea*: që lumenj, moçale e burime, ishin hyjni, qenkish një konceptim i përhapur gjerësisht në poezinë dhe ceremonialin e lashtë. Jo rrallë kishte rrethana që hyjni të tilla bashkoheshin me qenie të vdekshme dhe rrjedhimisht lindnin fëmijë vdekatarë. Përkthimet në italisht, të cituara në literaturë, shkruajnë: “palude”, moçal, kënetë. Ne preferuam variantin grek dhe të Gjon Shllakut: *liqen*.

² 867. *Καρῶν ἡγήσατο βαρβαροφύωνων*, *kariasët gjuhëbarbarë*: kjo është dëshmia më e lashtë e një koncepti të shumëpërhapur në kulturën e grekëve, pra që t’i cilësonin si “barbarë” të gjithë ata që flisnin një gjuhë të ndryshme nga gjuha e tyre.

³ 867-869. Miletin, në epokën historike ishte më i famshmi ndër qytetet jonike të Azisë së Vogël, në kohën e luftës së Trojës (1194-1184 p.e.r.) duket se banohej nga populli i kariasve, aleatë të trojanëve kundër akejeve. Sipas traditës, kolonizatorët jonikë, nën prijën e Neleut, e pushtuan më 1044, duke ia shkëputur kariasve dhe duke u martuar me gratë (Herodoti, I, 142 etj.; Straboni, 14, 1-6). Miletin lëvdohej me një kolonizim kretas më të lashtë (Apollodori, *Bibl.*, 3, 5), që rrjedhimisht është konfirmuar nga shtresa të populluara minoike dhe mikenase.

Straboni në *Gjeografikat* thotë: *Melitin* e ndërtoi Neleu nga fisi i Pilos (Efori thotë se ndërtimi i parë atje ishte kretas. Sarpedoni nga Me(i)liti kretas, bashkë me banorët). Me(i)liti ekzistonte dhe në Kretë (shih libri II, 647).

⁴ 874. *Αιακίδαο*, e *Eakidit*, e Akilit, pasardhës i Eakut: Akilin e quan kështu, Eakid, edhe këtu (si dhe në v. 860), se gjysh i tij ishte Eaku (i ati i Peleut), mbret i Salaminës. Ndoshta ka rëndësi që në këto vargje e emëron kështu se kanë të bëjnë me hakmarrjen e vrasjes së Patroklit. Edhe Eaku ishte njëri nga gjykatësit, bashkë me Minosin dhe Radamantin.

⁵ 877. Numri i përgjithshëm i luftëtarëve, që i përkisnin ushtrisë trojane, ishte llogaritur në 50.000, nga të cilët rreth 1.200 duhej të ishin trojanë mirëfilli, të tjerët aleatë (besëtarë).



Libri i tretë Γ

Betime dhe dyluftimi i Aleksandrit me Menelaun

Dhe kur u rreshtuan secili me prijësit,¹
trojanët shkonin me britma dhe thirrje porsì zogj,
siç vërtiten nën qiell klithmat e lejlekëve,
që kur i ikin dimrit dhe rrebesheve pafund,
me britma fluturojnë në rrjedhat e Oqeanit,²
masakër e vdekje duke u sjellë burrave pigmej,
dhe kur gdhin, luftë të pamëshirshme nisin.
Por të tjerët heshtur shkonin, akejtë që frymonin furi
me dëshirë në zemër të ndihmojnë njëri-tjetrin.

5

¹ 1. Nga ky cak gjer në fund të librit VII, premtimi i bërë *Tetit* nga Zeusi është harruar. Në origjinë, episodet që përmban ky libër, duhet të kenë qenë të pavarur nga plani i poemës; dhe pjesërisht duken t'i referohen fillimit të luftës, si përpjekja për të zgjidhur konfliktin me një dyluftim ndërmjet Menelaut dhe Paridit, apo skena në të cilën Helena i rrëfen Priamit krerët grekë, që sidoqoftë nuk i ka parë kurrë më parë.

² 5-6. Rrjedhat e Oqeanit përfaqësojnë kufijtë e tokës, ngaqë për Homerin Oqeani është një lumë, që e rrethon të gjithën. Lufta mes lejlekëve dhe pigmejve nuk është përmendur gjetkë te Homeri, por është mjaft e pranishme në artet figurative e në letërsi duke filluar qysh në shek. VI p.e.s. Bëhet fjalë për një përrallë, që ka ardhur duke u pasuruar në kohë, duke u ndeshur më në fund me një realitet me të cilin është identifikuar pjesërisht. Shih: P. Janni, *Etnografia e mito. La storia dei Pigmei*. Roma 1978.

Autorë të mëvonshëm grekë shpjegonin se *pigmejtë*, vendndodhja gjeografike e të cilëve mbetej shumë e mjegullt, të maskuar si deshë ose duke hipur mbi deshë dhe dhi, luftonin kundër lejlekëve për të mbrojtur fushat e tyre.

Ashtu si në maja malesh Juga derdh mjegullën, 10
 që barinj të s'e duan, po më e mirë se nata për kusarin,
 dhe dikujt i arrin shikimi aq larg sa shtie gurin,
 kështu nën këmbë ngrihej një re pluhuri
 kur vinin; dhe shumë shpejt kapërcyen fushën.
 E kur ishin afër, tek shkonin njëri kundër tjetrit, 15
 para trojanëve doli Aleksandri¹ pamjehyjnori,
 me lëkurë pantere² mbi supe, me harqe të përkulur
 e shpatë, dhe dy heshta me majë bronzi,³
 duke i shkundur, dhe ftonde më trimat e gjithë argejve
 të ndesheshin me të në përleshjen e tmerrshme. 20
 Atë sapo e pa Menelau⁴ i dashur nga Aresi
 të dilte në ballë të rreshtave me hapa të mëdha,
 u gëzua si luan, që ra në një pre të madhe,
 kur ndesh një dre me brirë apo dhi të egër,
 i uritur; e gëlltit me lakmi edhe pse atë 25
 qen të shpejtë dhe të rinj të fuqishëm e ndjekin;
 kështu Menelau iu gëzua Aleksandër pamjehyjnorit
 duke e parë me sy; shpresonte hakmarrje mbi fajtorin,
 menjëherë nga qerrja, me gjithë armë, kërceu përdhe.
 Por kur e shqoi Aleksandri pamjehyjnori, 30
 të shfaqet para rreshtave të para, iu tmerrua zemra,
 prapa, mes shokëve humbi, duke i ikur vdekjes.

¹ 16. *Aleksandri*, është emër tjetër i Paridit; si rrëmbyes i Helenës është përgjegjësi i parë i luftës.

² 17. *Lëkurë laramane*, pantere a leopardi.

³ 18. *δοῦρε δὴν κεκοροθμένα χαλκῶ*, *dy shtiza me majë bronzi* (it. *due giavellotti con la punta di bronzo*): folja *κοροσσομαι* do të thotë 'armatosem me përkrenare', pra në përgjithësi 'armatosem', zakonisht, referuar luftëtarëve (p.sh. V, 562), pjesorja e kryer, edhe pa shoqërimin e *χαλκῶ*, 'të bronzit' (shih XVI, 802), është përdorur për armë, si *δόρυ* dhe *έγχος*, ndërtuar nga një shtizë druri me majë bronzi. Të vendosësh një dallim mes *δόρυ* dhe *έγχος* nuk është e lehtë; në disa pjesë duket që *έγχος* është heshta e rëndë për t'u mbajtur në luftime në distanca të afërta, ndërsa *δόρυ* më i lehtë, "shtiza" ('giavellotto') për t'u flakur; shih te XVI, 138-144, ku thuhet se Patrokli armatosem me dy shtiza (*δοῦρε*), por nuk merr *έγχος* të Akilit, shumë e rëndë për të. Në përgjithësi të dy termat duken të ndër-këmbyeshëm dhe qoftë *δόρυ* edhe *έγχος* janë më shumë të përdorur si armë për t'u hedhur.

⁴ 21. Është me interes sesi kur shikoi Parin, *Menelau* ndjeu (kuptoi nga lëvizjet e tij) se çfarë donte t'i thoshte. Ndofta ngaqë ishte larg, apo ndofta ngaqë nuk fliste të njëjtën gjuhë. Dhe më poshtë, kur Pari dëshiron të dyluftojë me Menelaun, i kërkon Hektorit që t'u flasë akejve.

Ashtu si dikush, kur sheh një dragua,¹ i frikësuar kërcen pas,
mes grykave të maleve, dhe tmerri i mbërthen gjunjët,
e vihet në ikje dhe të zbehtët i vërshon nëpër faqe, 35
kështu prapë u krodh mes turmës së trojanëve krenarë,
Aleksandër pamjehynori i trembur nga biri i Atreut.
Por Hektori që e pa, iu sul me fjalë turpëruese:
“Pari i mallkuar, në pamje bukurosh, guar dhe mashtrues,
më mirë të mbeteshe pa fëmijë a të vdisje i pamartuar!² 40
Këtë do të dëshiroja, kjo do të ishte më e mirë,
sesa kështu të jesh, turpi dhe shëmtia për të tjerë.
Ah, diku do të qesëndisin akejtë flokëgjatë,
që besonin se i parë burrëror ishe, me bukurinë
në pamje, por nuk paske as forcë as zemër aspak. 45
Dhe i tillë siç je, mbi anije që shkojnë përmbi det,
qysh lundrove nëpër det pasi mblodhe shokë besnikë,
e me të huaj u takove dhe rrëmbeve një grua të bukur
nga një tokë e largët, nuse burrash heshtëmprehtë,
e keqe e madhe për tët atë, për qytetin e gjithë popullin, 50
për armiqtë hare dhe për ty vetë turpërim.
Dhe s’do të përballësh Menelaun e dashur nga Aresi?
Atëherë do të njihje të cilit burrë gruan lule mban!
Dhe s’do të të vlejnjë kitara dhe dhuratat e Afërditës,³
flokët dhe bukuria jote, kur të rrokullisesh në pluhur. 55
Por janë shumë të frikësuar trojanët, se prej kohësh,
do të vishje kiton të gurtë për gjithë të keqen që ke bërë!”⁴
Dhe iu përgjigj Aleksandri pamjehynori:

¹ 16. Në *original* δρῶκλοντα: dragua. Përkthyesit (grekë, italianë etj.) e shkruajnë: gjarpër. Është hera e dytë që akejtë përngjasojnë me *dragonj* (gjarpër). Shih dhe *Iliada*, II, 380 etj.

² 40. Gjëma më e madhe për mentalitetin patriarkal është pasqyruar me fundin e γένοϋς “fisit” dhe të harrësës së tij. Në kontekstin e vargut është e qartë që ἄγονός do të thotë pa fëmijë, jo “kurrë i palindur”, siç është kuptuar ndonjëherë.

³ 54-55. Dhuratë e Afërditës, veç dashurisë është dhe bukuria, që është mjeti për ta ngjallur. Ngaqë Paridi nuk është pasqyruar kurrë në aktin e rënies së qestes, ndër kritikët antikë kishte që e korrigjonin κίθαρις, “qeste (it. cetra)” në një të pangjarë κίθαρις, “tiarë, kësulë (tiana)”, mbulesë koke e tipit oriental. Iluzioni për t’i rënë qestes, për të intonuar këngë me të, shton pa dyshim një çikje të mëtejme në magjinë e Paridit, që me këtë kontekst (si dhe në pjesë të tjera të *Iliadës*) merr një ngjyrim tërësisht negativ, sepse bukurisë në pamje nuk i korrespondon forcë dhe kurajë (v. 44 etj.).

⁴ 57. *Do të mbaje kiton të gurtë*, do të të vrisnin (qëllonin) me gurë; domethënë do të ishte vradë me gurë nga populli, apo do të ishte varrosur nën një grumbull me gurë, pra “vdekur e varrosur”.

“Hektor, pasi me të drejtë më qorton, jo pa të drejtë,
 zemra jote është gjithmonë e paepur si sëpata 60
 që hyn në dru, në dorë burri, që mjeshtërisht
 pret trupa për anije, rrit dhe vrullin e burrit;
 ashtu të patundur ke zemrën përbrenda në gjoks;
 mos më përplas në fytyrë dhuratat e Afërditës së artë,¹
 për t’u hedhur s’janë dhuratat e ndritshme të hyjnive, 65
 gjithë ç’japin ata askush vetë nuk mund t’i zgjedhë.
 Tani prapë, nëse do, të ndeshem dhe të luftoj,
 bëj të ulen trojanët e tjerë dhe të gjithë akejtë;
 dhe në mes mua me Menelaun e dashur nga Aresi
 na vini të luftojmë për Helenën dhe gjithë thesaret.² 70
 Kush do të fitojë nga të dy, e më i mirë të duket,
 të marrë thesaret dhe gruan ta shpjerë në shtëpi.
 Të tjerët për miqësi dhe betime me besë të bëni fli,
 e të rroni në Trojën pjellore dhe ata le të kthehen 75
 në Argosin³ kuajrritës, në Akaian me gratë e bukura”.
 Ashtu foli e Hektori shumë u gëzua me fjalët që dëgjoi,
 ndërmjet trojanëve shkoi e i ndali falangat,
 duke mbajtur heshtën nga mesi;⁴ të gjithë qëndruan.
 Përballë tij tendosnin harqet akejtë flokëgjatë,
 shënonin me shigjeta dhe gurë për ta qëlluar; 80
 atëherë thirri fort mbreti i burrave, Agamemnoni:
 “Ndaloni argej, mos qëlloni bij të akejve,
 se diçka do të thotë Hektori përkrenaretundës!”.

¹ 64. χρυσέης Αφροδίτης, e Afërditës së artë. χρύσεος/χρύσειος, e artë. është atribuar shpesh objekteve, që u përkasin hyjnive dhe banesave të tyre (shih p.sh. IV, 2 etj.; VIII, 442; XIX, 383); si epitet hyjnisht, në poemat homerike dhe te Hesiodi, i referohet vetëm Afërditës. Në këtë pjesë dhe në të tjera të epikës arkaike, duket se është përdorur në kuptim të mirëfilltë me aludimin për një shtatore të artë, të pruarur apo të stolitur me gjerdanë ari.

² 70. Bëhet fjalë për të mirat pajë të Helenës që dy të dashurit (Paridi e Helena) morën me vete kur u arratisën nga Sparta, të cilat kujtohen shpesh tek *Iliada*. Shih v. 285: “... të kthejnë Helenën me gjithë thesaret e saj”. Mbi “dhurëtitë” që nusja merrte dhuratë nga i ati në çastin e martesës, shih IX, 146-148 dhe shënimin përkatës.

³ 75. Për kuptimet e ndryshme të toponimit *Argos*, shih shënimin te II, 108; në këtë varg duket se rrefen mbretërinë e Agamemnonit dhe pjesën tjetër të Peloponezitet. *Akaia*, emër grek për të shënuar gjithë Greqinë, këtu duket se i referohet në veçanti Greqisë Veriore.

⁴ 78. Hektori përdor një heshtë si një barrierë, prandaj e mbërthen duke e mbajtur në mes horizontalisht.

Kështu foli e ata ndërprejnë luftën, ndenjën heshtur
menjëherë; Hektori i foli njëres palë dhe tjetres: 85
“Dëgjoni nga unë trojanë dhe akej këmborefortë,
fjalën e Aleksandrit, për shkak të të cilit lindi grindja.
Nga trojanët e tjerë kërkon dhe nga gjithë akejtë,
armët e mira të mbështetin në tokën që ushqen shumë njerëz,
dhe në mes ai dhe Menelau i dashur nga Aresi, 90
vetëm, të luftojnë për Helenën dhe gjithë thesaret.
Kush do të fitojë nga të dy, e më i mirë të duket,
të marrë thesaret dhe gruan ta shpjerë në shtëpi.
Ne të tjerët për miqësi dhe betime me besë të bëjmë fli”.
Kështu tha dhe të gjithë mbetën pa zë, në heshtje, 95
dhe mes tyre foli Menelau zëgjëmimi:
“Tani dëgjomëni dhe mua, se dhimbja arrin
më shumë shpirtin tim, por dëshiroj që të ndaheni
arkej dhe trojanë, se shumë të këqija pësuar
për grindjen time, që e ndezi i pari Aleksandri. 100
Për cilin nga ne të dy e ka shkruar vdekja, Moira,¹
le të vdesë, por ju të tjerët ndahuni shpejt!²
Sillni dy qengja, një të bardhë e një të zi,³
për Gean dhe për Helion⁴ dhe ne një tjetër për Zeusin,
sillni dhe Priamin trim, të bëjë flinë e betimit 105
ai, se djemtë e tij janë fodullë e të pabesë,
e mos dikush shkel betimin e Zeusit dhe e prish.
Gjithmonë më të rinjve mendja u merr erë,
por kur me ta është plaku, ç’është para e ç’vjen prapa

¹ 101. *Moira* (në origjinal: μοῖρα), fati, - i mirë, fatitë; hyjneshat e vdekjes, vdekja.

² 102. *Menelau* ndërmerret një nismë, e cila gjendet në të kundërt me këshillën e Nestorit (shih II, 434), i cili propozon që akejtë të fillojnë shpejt sulmin, diçka që e pranoi Agamemnoni. Bën një përpjekje të fundit që të zgjidhte me dyluftim mosmarrëveshjen akej-trojanë. Dhe pranon të dyluftojë ai vetë me Parin, domethënë të dy drejtpërdrejt të interesuarit, që të mos kenë humbje të tjera të dy popujt, por të pranojnë përfundimin e dyluftimit dhe të ndahen si miq. Ky veprim tregon karakterin e Menelaut, të cilin Homerit e quan “Menelau i virtytshëm” (zemërmirë, v. 96).

³ 103-104. *Toka* (Gea), *Dielli* (Helios) dhe *Zeus Horkios* (Zeus ‘garant i betimeve’) thirren gjithmonë për të vulosur marrëveshje dhe për të formuluar betime (shih v. 276-278; XIX, 258-265; e Burkert 1984, f.362-67). Viktimat flijuese nuk zgjidhen kurrë rastësisht, por në bazë të cilësive korresponduese të hyjnive, që u ofrohen: qengji i bardhë Diellit, qengji i zi Tokës. Ngjyrë të zezë detyrohej të kishin kafshët (flitë) kushtuar hyjnive të Botës së Poshtme.

⁴ 104. *Gea* dhe *Helios*, Toka dhe Dielli.

vëren, ç'është më e mira për njëren dhe tjetrën palë". 110
 Kështu foli dhe u gëzuan akej dhe trojanë,
 me shpresë t'i jepnin fund luftës kobzezë.
 Kuajt i ndalën në rresht dhe ata poshtë kërcyen,
 zhveshën armët, i mbështetën përtokë
 njëri pranë tjetrit, i pakët vendi që i ndante. 115
 Hektori drejt qytetit dy kasnecë dërgoi
 me shpejtësi, të sjellin qengjat dhe të ftojnë Priamin;
 dhe Agamemnoni i fuqishëm dërgoi Taltibin
 të shkonte tek anijet e lugëta e të sillte qengjin
 e urdhëroi; dhe ai ia dëgjoi fjalën Agamemnonit hyjnor. 120
 Por Iri te Helena llërëbardhë erdhi lajmëtare,
 përngjarë së kunatës, gruas së Antenoritit,
 e kishte i biri i Antenorit, i fuqishmi Likaon,
 Laodikën, më e bukura ndër vajzat e Priamit.
 E gjeti në sallë, po endte një pëlhurë të madhe, 125
 dyfishë e të purpurt, brenda saj qëndiste shumë bëma
 që trojanët kuajzbutës dhe akejtë kitonëbronztë
 kryen për të, duke hequr kaq shumë në pëllëmbët e Aresit.
 I qëndroi pranë Irida këmbëshpejtë dhe i tha:
 "Eja këtu, nuse e dashur, të shohësh punët e çuditshme 130
 të trojanëve kuajzbutës dhe të akejve kitonëbronztë,
 që më parë njëri-tjetrit i sillnin luftën me shumë lot
 në rrafshirë, të etur për përleshjen shfarosëse,
 tani në heshtje rrinë ata, dhe lufta ka ndaluar,
 ulur mbi mburoja, pranë tyre ngulur heshtat e gjata. 135
 Por Aleksandri dhe Menelau nga Aresi i dashur
 me heshta të gjata do të ndeshen për ty
 dhe nuse e shtrenjtë do të jesh e atij që do të fitojë".
 Foli hyjnesha dhe i shtiu në zemër një dëshirë të ëmbël
 për të shoqin e parë dhe qytetin dhe prindërit e saj;¹ 140
 shpejt, pasi u mbulua me vel të bardhë,
 brof nga dhoma duke derdhur lot të nxehtë,
 jo vetëm, bashkë me të dy shkonin dy shërbestare,
 Etra, bijë e Piteut dhe Klimeni symëshqerra;²

¹ 140. τοῦ φίλου, *prindërit e saj*. Leda dhe Tindari, që është ati i supozuar e njerëzor i Helenës, ndërsa ati natyral dhe hyjnor është Zeusi, bashkuar në dashuri me Ledën në formë mjellme. Gjetkë Helena quhet "bijë e Zeusit"; shih dhe v. 199, 426; *Odisea*, IV, 184). Shih dhe shënimin në v. 236-244.

² 144. Κλυμένη τε βοῶπις, *Klimeni me sy të mëdhenj. Etra, bijë e Piteut dhe Klimeni symëshqerra*: një referim tjetër në epokën e Tezeut, e cila është shumë pranë me të shkuarën e afërt. Etra ishte nënë e Tezeut, bijë e Piteut, bir i Pelopit dhe Ipodamias dhe mbret i Trezinës. Βοῶπις, pra βοῖδομάτα, me sy si të kaut, apo me sy të mëdhenj. Shih shënimin te I, 551.

pastaj me ngut arritën atje ku ishin portat Skee.¹ 145
 Priami dhe rreth tij Pantou² dhe Timeti,
 dhe Lambi e Klitiu dhe Iketaoni pinjoll i Aresit,
 Ukalegonti dhe Antenori, që të dy fjalëmençur,
 pranë portave Skee rrinin pleqtë e popullit,
 nuk luftonin më nga pleqëria, por gojëtarë 150
 fisnikë ishin, përngjarë me gjinkalla, që në pyje
 ndenjor mbi pemë derdhin zërin e ëmbël,
 kështu rrinin krerët e trojanëve përmbi kullë.³
 Ata kur panë Helenën që drejt kullës po vinte,
 me zë të ulët njëri-tjetrit i thoshnin fjalë fluturake: 155
 “Të mos mërrihen trojanët dhe akejtë këmborefortë
 që për një grua të tillë për shumë kohë dhimbje pësojnë;
 tmerresisht në pamje me hyjneshat e pavdekshme ngjan.
 Por edhe kështu, e tillë siç është në anije le të kthehet,
 as te ne as te fëmijët tanë fat të zi të mos lërë pas”. 160
 Kështu thoshnin dhe Priami ftoi Helenën duke i thirrur:
 “Eja këtu përpara, bijë e dashur, ulu pranë meje,
 të shohësh burrin tënd të parë, të afërmit dhe miqtë,
 ti asnjë faj nuk më ke, hyjnitë janë shkaktarë,
 ata më ngritën luftën me shumë lot të akejve; 165
 eja e më thuaj emrin e këtij burri madhështor,
 cili është ky burrë akeas i bukur dhe i madh?
 Vërtet ka të tjerë me kokë më të lartë,
 por kurrë një kaq të bukur nuk kam parë me sy,
 as kaq të respektuar; se ngjan me një burrë mbret!”. 170

¹ 145. Σικαιὴ πύλαι, *Portat Skee*: në shumës se πύλαι do të thotë pikërisht “me dy kanata”. Kjo portë gjendej në anën e fushës së luftimit, në drejtimin veri-lindje. Veç kësaj tek *Iliada* përmenden dhe “Portat Dardane”, që do të ishte e logjikshme të mendoheshin në drejtim të lindjes, për nga Dardania. Kritiku antik Aristarku i Samotrakës (shek. II p.e.s.) mendonte përkundër që bëhej fjalë për një emër tjetër për vetë portat Skee.

² 146. Për *Pantoun* thuhet se ishte prift i Apollonit në Delf. Bir i Otriti, at i Euforbit dhe Polidamantit. Për shkak të bukurisë së tij, e rrëmbeu Antenori, i cili e solli në Trojë dhe atje u bë prift i Apollonit. Euforbi qëllon i pari për vdekje Patroklin (shih: *Iliada*, XVI, 806 dhe XVII, 59, ku Menelau vret Euforbin).

Për *Polidamantin*, shih *Iliada* XI, 57; XVII, 600 etj. dhe XVIII, 249 etj.

Pitagora e konsideronte veten ritrupëzim (rimishërim) të Euforbit.

³ 153. Qartësisht bëhet fjalë për një kullë (përg) që gjendej në krah të portave Skee, nga shihej kampi akeas.

Dhe Helena iu përgjigj, gruaja hyjnore:

“Nderim dhe frikë të kam, vjehërr i dashur,
më mirë vdekje e keqe të më kishte gjetur kur këtu
djalin tënd ndoqa e lashë shtratin nusëror, miqtë,
dhe vajzën e njomë dhe bashkëmoshataret e ëmbla. 175

Veç s’ndodhi kështu, prandaj qaj dhe tremem.

Por tani do të të them atë që pyet dhe kërkon:
Ai është Atridi, shumë i fuqishmi Agamemnon,
njëherësh mbret fisnik, po dhe luftëtar burrëror,
ishte kunati im, i syqenes, nëse ka qenë ndonjëherë”.¹ 180

Kështu tha dhe plaku e admiroi dhe foli:

“Atrid ditëbardhë, lindur fatmirë, i lumtur,
vërtet shumë djem akeas ishin nën mbretërimin tënd.²
Isha njëherë në Frigji me shumë vreshta,
ku pashë frigjas³ të shumtë, burra me kuaj të shpejtë, 185

popuj⁴ të Otretut e të Migdonit të ngjashëm me hyjnitë,
që rrinin në fushim në brigjet e Sangarit,
se dhe unë besëtar u bashkova me ta
ditën që erdhën amazonat të forta si burrat,⁵

por nuk ishin ata aq sa akejtë me sytë e zinj”.⁶ 190

Të dytin prapë duke parë Odisenë, plaku pyeti:

“Më thuaj tani dhe për këtë, bijë e dashur, kush është?”

¹ 180. εἴ ποτ’ ἔην γε, *nëse ka qenë ndonjëherë*: keqardhja dhe nostalgia e jetës së shkuar në Spartë, si grua e Menelaut marrin formën e dyshimit mbi vetë realitetin e përvojës së shkuar.

² 183. εἴ ποτ’ ἔην γε, *ishin nën mbretërimin tënd*: përdorimi i kohës së shkuar shpjegohet duke hamendësuar një artikullim më të gjerë të mendimit të Priamit, brenda frazës, shumë konçiz, të shqiptuar realisht; një vargua i tipit: “shumë bij të akejve ishin nën mbretërimin tënd, si kisha dëgjuar të thuhet për famën dhe tani mund ta konstatoj me sytë e mi, duke parë rradhën e pafund të së cilës je në krye”.

³ 184. *Frigjet* nga Askania i gjejmë të luftojnë në anën e trojanëve tek *Iliada*, II, 862-863.

⁴ 186. Këtu e gjetkë, fjala *popull*, *popuj* ka kuptimin e *usbtisë*.

⁵ 189. *Amazonat të forta si burrat*: Grekët i përfytyronin amazonat si një popullsi grash luftëtare, të vendosura në kufijtë e botës së njohur. Ato bëjnë pjesë në shumë mite greke: u ndeshën me Herakliun, me Zezeun dhe me hyun Dionis. Do të ndërhyjnë në luftën e Trojës pas vdekjes së Hektorit, prirë nga mbretëresha e tyre Pentisilea, që do të vritet nga Akili. Këto ndodhi ishin rrëfyer në një poemë të “Ciklit epik”, tek *Etiopida* e Arkunit dhe janë pasqyruar gjerësisht në artet figurative.

⁶ 190. ... *sytë e zezë*, në origjinal: elikopes (ἐλικωπες), ata që kanë sy të shkathët, shikim të zgjuar; sy të rrumbullakët; sytë e zezë.

Më i vogël nga koka e Agamemnon Atridit,
por më i gjerë në shpatulla e në gjoks, në të parë.
Armët e tij prehen mbi tokën që ushqen shumë njerëz, 195
por ai si një dash përçor vërtitet mes radhëve të burrave,
me një dash leshdendur unë e përngjasoj,
që shkon e vjen mes një kopeje të madhe delesh të bardha”.
Atëherë atij iu përgjigj Helena, bijë e Zeusit:
“Ai është Laertiadi, Odisea mendjeshumë, 200
që u rrit mes popullit të Itakës shkëmbore,
që njeh çdo lloj dredhie dhe mejtimi të mprehtë”.
Dhe Antenori i mençur iu përgjigj e i tha:
“Grua, shumë e vërtetë është kjo fjalë që the,
se dhe këtu erdhi dikur Odisea i lavdishëm, 205
dërgatë për ty me Menelaun i dashur nga Aresi,
dhe unë i mikprita dhe i bujta brenda në pallat,
dhe njëherësh u njoha dukjen dhe mendimet e holla.
Por kur u ndodhën mes trojanëve të mbledhur në kuvend,
rrinin në këmbë, Menelau ia kalonte me shpatullat e gjera, 210
e kur rrinin ulur të dy, më i respektuar ishte Odisea.
Por kur këshilla dhe fjalë mes të gjithëve thurnin,
vërtet Menelau shpenguar fliste,
pak gjëra po me zë kumbues, se s’ ishte fjalëshumë,
as dhe fjalë pa mend, ndonëse më i ri në moshë. 215
Por sa herë ngrihej Odisea mendjemprehtë
në këmbë, shikonte poshtë me sytë mbërthyer përtokë,
dhe skeptrin s’ e tundte as përpara as prapa,
e mbante palëvizur, përngjarë një burrë i paditur,
do të thoshje se ishte i zemëruar a i marrë gjithsej. 220
Por kur zërin kumbues nxirrte nga gjoksi
dhe fjalë që ngjanin me flokët e borës në dimër,
atëherë asnjë vdekatar tjetër s’ matej dot me Odisenë,
atëherë nuk mendonim më për pamjen e Odisesë!”.
Për herë të tretë duke parë Ajaksin¹ plaku pyeti: 225
“Kush është ai burri tjetër akeas, i pashëm e shtatmadh,
një kokë më lart mes akejve, me shpatullat e gjera?”.

¹ 225. Sigurisht bëhet fjalë për Ajaks Telamonin, si gjithnjë, kur nuk përcaktohet shkoqur që bëhet fjalë për Ajaks Oileun.

Dhe Helena pepëlgjatë¹ iu përgjigj, gruaja hyjnore:
 “Ai është Ajaks gjiganti, kulla e akejve;
 nga ana tjetër Idomeneu, mes kretasve si një hy 230
 qëndron, rreth tij mblidhen krerët e kretasve,
 shpesh e mikpriste Menelau i dashur nga Aresi
 në shtëpinë tonë, kur vinte nga Kreta.
 Dhe tani të tjerët të gjithë i shoh, akejtë me sy të gjallë,
 që mirë i njoh dhe mund t’i përmend me emra. 235
 Por nuk arrij të shikoj të dy prijësit e popujve,²
 Kastorin kuajzbutës dhe Polideukun me grusht të fortë,
 vëllezër të një gjaku me mua, që një nënë na lindi.
 Vallë s’janë nisur nga Lakedemonia³ e bukur,
 apo kanë ardhur këtu me anije që shkojnë nëpër det, 240
 por tani s’duan të përzihen në përleshjen e burrave,
 nga frika e turpit dhe çnderimit të shumtë që kam unë”.
 Ashtu tha, por ato toka pjellore tashmë i mbulonte
 në Lakedemoni, në dheun e dashur atëror.
 Dhe kasnecët sollën përmes qytetit për betimet me besë 245
 dy qengja dhe verë ngazëlluese, fryt i tokës,
 në kacek të dhirtë: kraterin e ndritshëm e mbante
 kasneci Ide dhe kupat e arta;
 dhe, duke i shkuar pranë, plakun nxiti me fjalë:
 “Ngrihu Laomentiad, të ftojnë të parët 250
 e kuajzbutësve trojanë dhe akejve kitonëbronzte
 që të zbrësësh në fushë për betime besnike me fli;
 pastaj Aleksandri dhe Menelau i dashur nga Aresi

¹ 228. *Pepëlgjatë*, (it. lungo peplo; Kaz. Kakridi: μακρομαντοόσα Ελένη; Pulilas: μακρόπεπλη): në Greqinë antike, *pepli* veshje femërore prej leshi të bardhë, e përbërë nga një drejtkëndësh prej stofi të palosur disa herë, që zbret gjer në këmbë, e mbajtur nga dy karfica mbi shpatull dhe e shtrënguar në trup përmes një rripi (brezi).

² 236-244. Vëllezërit binjakë Kastori e Polluksi (më vonë të quajtur dhe Dioskurë, ‘bij të Zeusit’), duket këtu se kanë vdekur e janë varrosur, ndërsa tek *Odisea* (II, 304) në të kundërt ndajnë pavdekësinë, duke kaluar ditë këmbyerazi në përtejvarr e në tokë, që lind nga kulti atribuar atyre pjesërisht skëterror dhe heroik, pjesërisht hyjnor. Ky interpretim duket se konfirmohet nga varianti më i përgjithshëm i legjendës ilustruar nga Pindari (*Nem.* 10, 55-90): nga bijtë e Ledës, Poluksi ishte bir i Zeusit dhe Kastori i bashkëshortit Tide. Kur Kastori u vra, vëllai binjak i tij, Poluksi përfitoi nga Zeusi që t’i ofronte gjysmën e pavdekësisë së tij, duke u këmbyer me të në Olimp dhe në Ferr.

³ 239. *Lakedemonia*, Sparta.

me heshtat e gjata do të luftojnë për gruan;
fitimtarit do t'i përkasin gruaja dhe thesaret; 255
të tjerët, për miqësi e betime me besë pasi të bëjmë fli
do të banojmë në Trojën pjellore, e ata do të kthehen
në Argosin kuajrritës, në Akaian me gratë e bukura”.
Kështu tha dhe u ngjeth plaku, por urdhëroi shokët
të mbrehin kuajt dhe ata me zell e dëgjuan; 260
dhe Priami hipi e tërhiqte pas frerët,
pranë tij u ngjit Antenori në koçinë fort të bukur,
të dy, kaluan Skeet e drejt fushës nganë kuajt e shpejtë.
Por kur arritën mes trojanëve e akejve,
zbritën nga koçia mbi tokën që ushqen shumë njerëz, 265
mes trojanëve dhe akejve shkuan përpara.
U ngrit menjëherë mbreti i burrave Agamemnon
dhe Odisea mendjemprehtë; atëherë kasnecët e ndritshëm¹
sollën flitë e betimeve me besë të hyjnive, verën në krater
përzien dhe shtinë ujë mbi duart e mbretërve. 270
Dhe Atridi, duke zhveshur me dorë jashtë thikën
që i varej gjithnjë pranë millit të madh të shpatës
e nga kryet e qengjave këput një tufë qimesh;² pastaj
kasnecët ua japin të parëve trojanë dhe akej.
Mes tyre Atridi zëlartë duke ngritur duart u lut: 275
“Zeus at, që nga Ida mbretëron, lavdimadh, më i epërmi,

¹ 268-280. *Kasnecët* sjellin qengjat dhe verën, pra lëndën e flisë. Të habit shprehja ‘duke përzier verën’, se vera e përdorur për libacione nuk përzihej me ujë. Për këtë shkak Aristarku sugjeronte që kasnecët nuk përziën verën me ujë, por verën e trojanëve me atë të akejve. Pastrimi i duarve me ujë ishte një akt paraprak për çdo lloj flie.

² 273-309. Akti i prerjes së një cullufeje nga koka e viktimës përshkruhej “fillojmë flijimin duke ofruar qimet e viktimës”. Në flijimet e zakonshme, kjo cullufe qimesh hidhej në zjarr (shih *Odisea*, III, 446; XIV, 422). Në flijimet e kryera për të vulosur betime, në të cilat asnjë pjesë e viktimës nuk digjej (shih v. 310 dhe XIX, 267 etj.), ato ndaheshin mes palëve të marrëveshjes e pastaj shpërndaheshin nëpër tokë. Analogjikisht edhe vera e libacioneve derdhej përtokë, në vend që të derdhej në zjarr. Sipas historianëve të fesë, ky lloj flijimi, megjithëse ka të përbashkët një fli të një kafshe, në të vërtetë nuk paraqitet si ofertë hyjnine për të fituar mirësinë e tyre, as që presupozon një imazh të përcaktuar hyjnie, por i përgjigjet një rituali parahyjnor.

- Diell, që gjithçka shikon dhe gjithçka dëgjon,
dhe Lumenj e Tokë e ju të nëndheshmit që të vdekurit¹
njerëz ndëshkoni, cilindo që shkel betimet,
ju qofshi dëshmitarë dhe ruani betimet me besë: 280
- Nëse Menelaun do ta vrasë Aleksandri,
atëherë Helenën të mbajë dhe gjithë thesaret,
e ne do të kthehemi me anijet që shkojnë përmbi det;
dhe nëse Aleksandrin do të vrasë flokëverdhi Menela,
atëherë trojanët të kthejnë Helenën me gjithë thesaret 285
dhe argejve t'u paguajnë një shpërblim siç u përket,
që dhe te njerëzit e ardhshëm të arrijë fama.
- Por nëse shpërblimin Priami dhe djemtë e Priamit
s'do të duan të ma japin kur të vdesë Aleksandri;
atëherë dhe pastaj do të luftoj për këtë shpërblim, 290
duke qëndruar këtu gjer të mbërrijë fundi i luftës”.
- Foli e me bronzin e pashpirt u preu fytin qengjave
dhe i shtriu përtokë të përpëliteshin
pa frymë, se bronzi ua mori fuqinë.
- E duke mbushur nga krateri verë me kupa 295
e derdhnin përtokë dhe u luteshin hyjnive të përjetshëm;
dhe kështu tha dikush nga akejtë dhe trojanët:
“Zeus lavdimadh, i epërm, e gjithë ju hyj të pavdekshëm,
ata prej nesh që do të dëmtojnë betimet,
ashtu si kjo verë trutë t'u derdhen përdhe, 300
dhe ato të fëmijëve, e gratë t'u nënshtrohen të tjerëve”.

¹ 278-279. Në një pjesë shumë të ngjashme me këtë (XIX, 258-260), bashkë me Zeusin, Tokën dhe Diellin, si hakmarrëse të shpërbetarëve (berrejšhëm), janë emëruar Erinitë. Por në këtë rast, forma dyjese e foljes: *ju të dy që... ndëshkoni*, ka bërë që Aristarku të hamendësojë se i referohet Hadit dhe Persefonit, sovranët e mbretërisë të të vdekurve, të bashkëpërcaktuar si garantë të betimeve edhe në IX, 457. Një problem tjetër shtrohet nga *καμόντας, të vdekurit*; në fakt duket e huaj për mentalitetin homerik idea e ndëshkimit pas vdekjes për mëkatet e kryera gjatë jetës. Por disa studiues korigjojnë numrin nga dyjese të foljes në shumës (τινυσθε) dhe mirëpresin interpretimin *καμόντες* (emëror), përcjellë nga disa kodikë si “all the word of spirits” (Leaf). Sipas kësaj pamjeje, pra, janë thirrur si garantë të betimit edhe shpirtrat e të vdekurve: “dhe ju të vdekur të përtejvarrit, që ndëshkoni kë ka kryer shpërbe”. Të tjerë propozojnë korrektime të ndryshme në tekst (shih diskutimin e Kirk në këtë rast).

Kështu thanë, por lutjen s'ua përmbushi Kronioni.
 Atëherë Priam Dardanidi¹ mes tyre foli këto fjalë:
 “Dëgjomëni mua trojanë dhe akej këmborefortë,
 unë do të kthehem në Ilionin erërrahur 305
 shpejt, se nuk do të duroj të shikoj me sy
 tim bir të shtrenjtë të luftoj me Menelaun e dashur nga Aresi;
 Zeusi patjetër e di, dhe të pavdekshmit e tjerë,
 se kujt nga të dy fundi i vdekjes i është shkruar”.
 Foli dhe qengjat i vuri në koçi burri baras hyjni,² 310
 u ngjit dhe ai e frerët tërhoqi nga pas;
 pranë tij hipi dhe Antenori në koçinë shumë të bukur.
 Dhe të dy prapa për në Ilion ikën.
 Por Hektori bir i Priamit dhe Odisea hyjnori,
 në fillim matën vendin dhe pastaj 315
 tundën shortet në një përkrenare të bronzte, të zgjidhnin
 kush do të lëshonte i pari heshtën e bronzte.
 Popujt faleshin me duar shtrirë hyjnive,
 e kështu thoshte secili nga akejtë dhe trojanët:
 “Zeus at, që nga Ida mbretëron, lavdimadhi, më i epërmi, 320
 kush nga të dy këto pësime shkaktoi mes nesh,
 bëj që të zbresë jetëhumbur në banesën e Hadit
 e të lindin prapë mes nesh miqësi dhe betime me besë”.
 Folën e Hektori i madh përkrenaretundës kaskën tundi
 me vështrimin pas, dhe menjëherë kërceu shorti i Paridit. 325
 Të tjerët u ulën në rresht, afër secilit rrinin
 kuajt këmbëlehtë dhe armët larmistolitura;
 atëherë në supe veshi armët e hijshme
 Aleksandri hyjnor, i shoqi i Helenë gërshetbukurës.

¹ 303. *Priam Dardanidi*: Priami merr atërorin Dardanid nga Dardani, themeluesi (i pari fisit) i shtëpisë mbretërore trojane.

² 310. Komentet antike të kësaj pjese (shënime të Eustazios) na japin të dhëna me interes të shënuar mbi viktimat e flijuara në rastin e betimeve: 1) ishte ndaluar të haheshin; 2) ishte zakon që vendasit t'i varrosnin nën tokë, përkundër, të huajt i flaknin në det. Në këtë pohim është i qartë referimi te XIX, 267 etj., ku hidhet në det shpeza e flijuar me rastin e betimit të Agamemnonit; por nga të dy pjesët bashkë, mund të kuptohet se pas flijimit të viktimave nuk vijonte gostia ceremoniale si te flijimet kushtuar hyjnive (shih sipër I, 458-468, si dhe Pausania, 5, 24, 10).

Në fillim rreth këmbëve vuri këmboret,¹ 330
 të bukura, me kopsa argjendi ujdísur në kyçe,
 e më pas rreth gjoksit veshi parzmoren²
 e vëllait të tij Likaon, që i shkonte për shtat;
 mbi sup vari shpatën me tokëza argjendi,
 të bronztë, pastaj mburojën e madhe e të rëndë; 335
 mbi kokën e fuqishme vuri një përkrenare të punuar mirë
 me bisht kali dhe tmerrshëm dallgëzonte tufa sipër;
 mori dhe një heshtë të fortë, që i përputhej në pëllëmbë.
 Porsi ai dhe Menelau i dashur nga Aresi ngjishte armët.
 Kur jashtë turmës, andej e kënde, ata u armatosën, 340
 mes trojanëve e akejve bënë përpara
 me vështrim të egër; dhe mahnitëshin kur i shihnin
 trojanët kuajzbutës dhe akejtë këmborefortë.
 Dhe të dy qëndruan afër në vendin e matur
 duke i tundur frikshëm heshtat njëri-tjetrit. 345
 I pari Aleksandri flaku heshtën hijegjatë
 dhe goditi mburojën gjithë rrethore³ të Atridit,
 por bronzi s'e përshkoi, vetëm u lakua maja
 mbi mburojën e fortë; atëherë u vërsul me bronz
 Menela Atridi duke lutur Zeusin at: 350
 "Zeus mbret, bëj të shpaguaj atë që keq më bëri i pari,⁴
 Aleksandër hyjnorin dhe me dorën time mposhte,
 që secili të ngjethet dhe nga njerëzit e ardhshëm
 mikpritësit t'i bëjë keq, atij që i shfaq miqësi".

¹ 330-338. Bëhet fjalë për një skenë armatosjeje të një heroi homerik. Skenat e tjera kanë të bëjnë me Agamemnonin (XI, 17-44), Patroklin (XVI, 131-139) dhe Akilin (XIX, 369-391). Përshkrimi ndjek gjithnjë të njëjtin rend duke u dalluar vetëm për ndonjë detaj.

² 332-333. Paridi nuk zotëron personalisht një koracë ngaqë është një harkëtar, madje harkëtar për antonomazi (një figurë retorike që përdoret për të përcaktuar një person me një emër të përgjithshëm, që tregon një karakteristikë kryesore, dhe jo emrin e tij). Do të jetë pikërisht një shigjetë lëshuar nga Paridi që do t'i shkaktojë vdekjen Akilit: ngjarje rrëfyer tek Etiopida, një poemë e "Ciklit" atribuar Arktinit.

³ 347. κατ' ἀσπίδα πάντοσε ἴσθην: në mburojën e mirekuilibruar, të barabartë në çdo drejtim, pra e rrumbullakët. Për tipat e ndryshme të mburojave të Homeri, shih shënimin të VI, 117-118; VII, 219-223.

⁴ 351-354. Paridi kishte rrëmbyer Helenën gjatë qëndrimit të tij në Spartë, kur ishte mysafir në shtëpinë e Menelaut; faji i tij duket më i rëndë po të mbahet parasysh se te grekët, raporti i mikpritjes kishte karakter të shenjtë: shih VI, 215 dhe shënimin përkatës.